Zekerija IDRIZI

VEPRIMTARIA UNIVERSALE E IMAMIT NË KURBET

(Evokim mbresash nga aktivitetet e mia)

Editor
Azam Dauti

Recensent
Azam Dauti

Zekerija IDRIZI

VEPRIMTARIA UNIVERSALE E IMAMIT NË KURBET

(Evokim mbresash nga aktivitetet e mia)

Shkupi
Shkup, 2O15

Bismil-lahir-Rahmanir-Rahim

Këtë vepër ia kushtoj nga shpirti vëllezëve të mij: Muharemit (Haxhi Lalës - tashmë i ndjerë-All-llahu xh.sh. e mëshiroftë!), Sahitit, Sabedinit dhe Fadilit, të cilët nuk kursyen nga djersa e tyre për shkollimin tim, si dhe motrave të mija: Samijes dhe Ibadetes.

Autori

VEPRIMTARIA UNIVERSALE
E IMAMIT NË KURBET

Pas një mërzie të madhe që përjetova teksa u ndajta në aeroportin e Shkupit me anëtarët më të ngushtë të familjes: me vëllezërit, motrat, bashkëshorten dhe vajzën e vetme timen, Amrën (loçkën e zemrës sime), më në fund, më 22 korrik të vitit 1997 mbërrita në Berlin, këtë metropol evropian, tashmë kryeqendër e Gjermanisë. Këtu u vendosa për të ushtruar detyrën e imamit në qendrën islame të mërgimtarëve shqiptarë, në xhaminë "Isa Beu".

Më kujtohet fare mirë kur që në ditën e parë, me të kryer të lutjes së përshpirtshme - namazit, pyeta xhematlinjt e pranishëm vallë ka klub shqiptarësh në Berlin?

"Ka kohë që këtu funksionon klubi "Bajram Curri" - m'u përgjigjën si me gjysëm zëri, disi neveritshëm.

"Për çfarë klubi po pyet hoxhë, pashë Perëndinë?" - ndërhyri me ironi një haxhi plak.

Çfarë koinçidence! Me t'u përmendur të emrit "Bajram Curr" sakaq, ashtu vetëtimthi, m'u parafytyrua në imagjinatë klubi "Bajram Curri" i mërgimtarëve tanë në Sarajevë. M'u parafytyruan takimet e çdoditshme në këtë lokalitet me kryetarin Muharem Zejnullahu, me punëtorët tanë mërgimtarë, me studentët shqiptarë të Universitetit të Sarajevës dhe me bashkëstudjuesit e mi të teologjisë. Në këtë klub patëm përjetuar çaste lumturie të papërshkrueshme. Aty u mblodhën ndihma gjithëfarëshe

për varfënjakët dhe fëmijët bonjakë të Kosovës sonë martire.
Një ditë Muharemi (njëherësh edhe kryetar i LDK-së - dega në Bosnje) më luti që t'i ndihmojmë në gjetjen e një lokaliteti më të përshtatshëm për të mbajtur një tribunë në temën "Kosova dje dhe sot", në të cilën do të ligjërojë dr. Fehmi Agani. Në këtë kontekst i ndihmuam duke e liruar sallën e Amfiteatrit në Fakultetin e Shkencave Islame (kuptohet me lejen e dekanit dr. Omer Nakiçeviq), ku u tubuan qindra mërgimtarë shqiptarë të Sarajevës me rrethinë. Këtë tribunë e moderova unë duke e hapur me dy versete kur'anore me domethënie luftarake në kuptim të vetëmbrojtjes së vlerave më të shenjta të kombit dhe fesë. Pas përfundimit të ligjëratës së akademik Aganit, nga dëgjuesit e pranishëm më së shumti dominoi pyetja: "Vallë ekziston (funksionon) Ministria e Mbrojtjes në kuadër të Qeverisë së Kosovës?"
Me të evokuar të këtyre ngjarjeve dhe të shumë të tjerave, për ca momente ndjeva kënaqësi në shpirt, por ama ajo nisi disi të venitet me të hetuar të gjithë atij aversioni e animoziteti të përçudshëm që kishin ndaj klubit xhematlinjt (besimtarët - vizitorët e xhamisë) e xhamisë së Berlinit. Në pse-në time, për t'i rënë në gjurmë këtij aversioni, ca prej tyre m'u përgjigjën me nervozizëm:
"Hoxhë, allahile, ata janë të dalë faresh dhe s'kanë haber me fe dhe xhami! Aty, madje, servohet dhe konsumohet alkooli!"

O Zot - thash më vete - po këta besimtarë vërtet s'kanë ama kurrfarë haberi nga mësimet e historisë islame, se lëre më nga filozofia e historisë së saj! Po vetë profeti ynë fisnik, Muhammedi a.s., pothuaj për çdo ditë ishte në kontakt me njerëz alkoolikë. Ai tregohej zemërgjerë, i butë e i përzemërt me këta njerëz. Kur shokët e tij e fyenin të dehurin, ai me dhembshuri thoshte: "Është mëkat të flitet ashtu. Mos e nënçmoni atë, ngaqë ai e don Zotin dhe Profetin e Tij!"
Në këtë mënyrë profeti fisnik, dalëngadalë, jo në formën e sjelljes së një polici me kriminelin, por në formën e sjelljes humane të një mjeku me pacientin e vet, i largonte njerëzit nga kjo dhe dukuri të tjera negative sociale.
Në jetën time më së shumti mëninë ua kam pasur atyre myslimanëve që me të dalë në pension bëheshin "më katolikë se Papa"! Siç thuhet edhe në atë proverbin françez: "Edhe djalli kur të plaket dëshiron të bëhet engjëll-profet".
Ata për çdo ditë, pas lutjeve fetare, frekuentonin një kafe-çajtore turke që gjendej në afërsi të xhamisë. Ata harronin se edhe aty servohej alkooli dhe interpretoheshin këngë turke. Një ditë u thash: "Më mirë është të shkoni në klubin e shqiptarëve, se sa të qëndroni në atë kafene turke. Mos u bëni, pash Zotin, "tyrkbilmezë"! Në klubin tonë, të paktën, takohesh me vëllezërit e një gjaku, kuvendon me ta shqiptarçe për fatet e Atëdheut dhe ke mundësinë të përcjellësh lajmet shqip".

Por, dorën në zemër, në këtë kontekst më së shumti fajin ua zë disa hoxhallarëve shkurtpamës e konservativë, të cilët besimtarëve u predikojnë dofarë dokrrash fetare të llojit "binladenian"! Në vërejtjen time se për çfarë arsye nuk frekuenton klubin e shqiptarëve, një koleg imi, imam xhamie në një qytet në jug të Gjermanisë, m'u përgjigj me prepotencë: "Jo, jo, nuk vjen në shprehje! Shyqyr Zotit që këmba ime nuk ka shkelur kurrë aty!" Atëherë thash vetëmevete: "O Zot, po në ç'deregje skëterrore e shpiejnë popullin tonë "mulla çarçafë të këtillë?!"

S'duhet të heqim kurrë nga mendja faktin historik që hoxhallarët më famëmëdhenj nga periudha e Rilindjes Kombëtare, të cilët kaluan jetë mërgimtari në Stamboll, si Hoxhë Hasan Tahsini, Imer ef. Prizreni, Mulla Kadri Prishtina, Haxhi Zeka, Hoxhë Rexhep Voka i Shipkovicës etj., pas kryerjes së ritualeve fetare pjesën më të madhe të kohës ata e kalonin në Klubin shqiptar, respektivisht në Shoqërinë patriotike të Stambollit. Aty ata kuvenduan dhe shkruan shqip për fatet e Shqipërisë etnike.

Mandej kudo që të vesh xhamive të turqëve ata t'i nxjerrin sytë me flamujt dhe stemat e tyre kombëtare, të varura gjithandej mureve të zyrave të tyre. Ata, përveç xhamive të shumta, kanë edhe qindra shoqata, shkolla e klube të tyret kombëtare. Po ngjashëm janë të organizuar edhe fqinjët tanë sllavo-ortodoksë: serbët, malazezët, maqedonasit, bullgarët dhe grekët. Thjesht në të gjitha liturgjitë e tyre religjioze kishtare prioritare është çështja e tyre kombëtare.

Xhamitë e diasporës duhet të marrin për shembull xhaminë pitoreske të mërgimtarëve shqiptarë në Osllo të Norvegjisë. Në objektin e tyre grandioz (kur e pata vizituar në vitin 2002) veç faltores kishin edhe kabinetin për seanca kuvenduese, klasat për mësim të gjuhës, kulturës dhe historisë shqiptare, mejtepin, klasën për kurs kompjuterësh dhe restorantin e tyre. Aktivitetet e tyre aty i ushtronin edhe klubi, edhe shoqata kulturo-artistike, edhe klubi futbollistik etj. Të gjithë vepronin nën një ombrellë, në shtëpinë e Perëndisë.

Myslimanë, sufinj e katolikë shqiptarë të bashkuar në veprimtari kombëtare

Gjatë gjithë veprimtarisë sime prej imami kam bashkëvepruar ngushtë me të gjithë vëllezërit e mi sufijë (dervishë), pjesëtarë këta të tarikateve të ndryshme, të cilët kryesisht vijnë nga Hasi i Prizrenit dhe komuna e Gjakovës. Në të gjitha ceremonitë fetare: në muajt e Ramazanit, nëpër festat e Bajrameve dhe të Sulltan Nevruzit (Lindjes së Imam Alisë) kemi këmbyer vizita në xhaminë "Isa Beu" dhe në teqenë "Yjet e Ehli Bejtit" (në të cilën vepron kleriku Sheh Musa Karavidaj), duke ia uruar njëri tjetrit. Sheh Musa Karavidaj ka vizituar shpesh xhaminë ku veproja. Nuk ka aktivitet kombëtar e fetar në të cilin nuk kemi marrë pjesë bashkërisht. Njëkështu kam bashkëvepruar edhe me Sheh Sulejman Sadikun dhe Sheh Bedri Osmanollajn, të cilët rregullisht merrnin pjesë

të xhumave në xhami në falje dhe dëgjonin me respekt ligjëratat e mija.
Për jetë e mot nuk do të harroj burrin më të fismë të rrafshin të Dugagjinit, bacën Ismet Nivokazi, i cili, si dervish i rryer që ishte, falë kredibilitetit të tij të lartë moral, fetar dhe kombëtar që gëzonte në gjirin e komunitetit tonë, ishte në gjendje që t'i bashkojë të gjithë shqiptarët nën një ombrellë, pa dallime fetare, regjionale, ideologjiko-partiake a fisnore. Apo, madje, do të bëja mëkat të pafalshëm po qe se s'do të përmendja dervishin brilant, të ndjerin bacën Shyqeri (Shyqeri Akçigoz, nga Shkodra - Zoti e mëshiroftë!), i cili posedonte një diapazon dhe një kulturë të gjerë mbi sufizmin apo misticizmin islamik. Ai i ndiqte rregullisht ligjëratat e mia në xhami dhe debatonim me orë të tëra me të për çështje religjioze, në veçanti për kokat kolosale të sufizmit: Abdul-Kadër Gjejlaniun, Imam Gazaliun, Mevlana Xhelaluddin Rumiun, Muhjuddin Arabiun, Hallaxhin, Xhunejd Bagdadiun e shumë të tjerë.
Në këtë drejtim nuk do lë pa përmendur me theks të veçantë mikun tim të ngushtë - **dostin tim**, **Abedin Sadiku** (Dërvish), të cilin e kam pasur dhe akoma e kam krah të djathtë të të gjitha aktiviteteve të mija fetaro-kombëtare. Në Berlin nuk kam takuar njeri me njohuri aq të thella për sufizmin burimor islam si dërvishin Abedin Sadiku. Në çdo takim tonin ka dominuar tema rreth dashurisë ndaj Allahut të Gjithëmëshirshëm dhe fese Islame në përgjithësi. Sheriati dhe Hakikati, ilmi dhe

ma'rifeti, Dhahiri dhe Batini, tefsiri dhe te'vili (egzegjeza dhe hermeneutika), egzoterizmi dhe ezoterizmi... ishin binom - elementë të pandashëm në diskursin tonë religjioz. Ndër të tjerash, madje, Abedinin e kisha personin numër një për çështje sigurie në gjitha aktivitetet kombëtare përgjatë zhvillimit të luftimeve në atëdhe dhe pas tyre. Punë kjo së cilës ai nuk i përtonte fare dhe ishte gjithnjë në lartësinë e detyrës. Me këtë rast për herë të parë do e bëj publike një besëlidhje (besatim-zotim) që bëmë një ditë unë dhe Abedini: ***"Jemi besatuar që nëse unë vdes i pari, ai të më pastrojë-lajë kufomën (guslin e xhenazes) dhe anasjelltas, nëse vdes ai unë marrë përsipër t'ia kryejë të njëjtën detyrë fisnike"***.

Thjeshtë me vëllezërit e proveniencës sufisto-dervishe jemi inkuadruar bashkërisht në të gjitha aktivitetet fetare e kombëtare. Në luftë dhe në paqe, në gëzim dhe në hidhërim, në kamje dhe në mjerim, po edhe në vdekje kemi qenë gjithnjë bashkë.

Thënë të vërtetën, unë edhe më parë në jetën time kam patur takime të shumta me dervishë tarikatesh të ndryshme. Gjatë viteve të medresesë shpesh herë kam vizituar teqenë Rifai në Gazibabë të Shkupit, ku kam zhvilluar diskutime të numërta me sheh Hajdarin dhe djalin e tij sheh Erollin, përkatës këta të tarikatit Rifaij. Pastaj dy vite të plota në Sarajevë kam pasur cimer sheh Muhamed Aliun e Halepit të Sirisë, i cili ushtronte paralelisht edhe detyrën e imamit në një xhami të Sarajevës edhe detyrën e mjekut në një spital të po këtij

qyteti. Nga edukata dhe dija e tij kam përfituar shumë. Dhe, e dini se përse i potencoj të gjitha këto? Sepse dëshiroj t'ju vë në dijeni një fakt substancial të Fesë Islame: "Sufizmi paraqet ajkën, bërthamën, respektivisht ai paraqet dimensionin shpitëror të Islamit". Sot, aktualisht në botën perëndimore qindra-mijëra njerëz të feve e sekteve të tjera religjioze kalojnë në Fenë Islame, ndër të tjerash falë edhe mësimeve magjepsëse të sufizmit ose misticizmit islamik. Kjo bëhet nga motive të thella psikologjike. Prandaj edhe librat më të lexuar, "bestseller", ndër njerëzit perëndimorë janë ato libra që flasin për vlerat shpirtërore, për dallim, ta zëmë, nga njerëzit e Orientit (e Lindjes), tek të cilët libra më të lexuar, "bestseller" janë ato që flasin për vlerat materiale, industriale e tekniko-teknologjike.

Kjo sepse perëndimorët tashmë janë skajshëm të ngopur nga mësimet dhe jetesa e skajshme materialiste e kapitalizmit modern dhe në vetvete, për ditë e më shumë ndjejnë një shpraztirë të madhe emocionale e shpirtërore. Së këndejmi edhe nevoja e madhe e tyre për ushqim shpirtëror, për Zot e për religjion.

Kështu ne në Berlin kemi çrrënjosur në mënyrë të suksesshme të gjitha çarjet, fragmentarizmat dhe hasmëritë që aty-këtu janë shpërfaqur nga besimtarë fanatikë e të pandërgjegjshëm dhe nga hoxhallarë e shehlerë të pa kredibilitet shkencor e moral.

Po kështu kemi vepruar edhe me vëllezërit tanë shqiptarë të konfesionit kristian, të ritit katolik. Kurrën e kurrës

nuk do t'i harroj takimet e ndejat tona miqësore dhe vëllazërore me miqt e mi katolikë: Ernest Lucajn, Mark Lekajn, Gjokë Nikollën, Shtjefën Përdedajn, Tomë Sokolin e të tjerë. Miku im, Ernesti (22 vjetë i burgosur politik në regjimin totalitar komunist të xhaxhait) vizitonte rregullisht tribunat e mia në xhami dhe kuvendonim me të me orë të tëra lidhur me ardhmërinë e Shqipërisë etnike. Marku, ndërkaq, kurrë nuk ndahej nga vëllezërit e vetë myslimanë nëpër kremta fetare. Ai tok me ne jepte rregullisht "fitrat" e Ramazanit dhe ka dhënë, njëherësh, kontribut të madh në çështjen kombëtare. Gjithashtu edhe vëllai ynë Shtjefni, ky njeri më i fisëm që kam takuar në jetë. Ai thjesht në asnjë aktivitet, i çfarëdolloji qoftë, nuk është ndarë nga vëllezërit e vet shqiptarë të konfesionit islamik, duke dhënë kështu një kontribut të madh në rrafshin kombëtar.

S'do të harroj kurrë pjesëmarrjen time në festën e "Krishtlindjes", që qe organizuar në lokalet e klubit "Bajram Curri" në vitin 1998. Në telefonatën që më bëri kësokohe kryetari i shoqatës për kulturë, arsim dhe sport "Dituria", Kadri Mulaj, për t'më ftuar në këtë festë kristiane, për habinë time më kërkoi ndjesë se mos vallë bënte farë mëkati që po më ftonte (si hoxhë) në një festë të tillë! I thash se nuk bënte kurrfarë mëkati dhe se me gjithë qejf do të merrja pjesë në atë festë. Në këtë manifestim mbajta një ligjëratë ku potencova me theks të veçantë vlerën e madhe që kanë në fenë islame dhe atë kristiane profeti Isa (Jezu Krishti) dhe e ëma e tij fisnike,

Merjemeja (Shën Mëria). Në mënyrë të veçantë apelova tek të rinjt që të mos blasfemojnë, që të mos nëpërkëmbin autoritetin e tyre të pakontestueshëm moral dhe shpirtëror.
Në të këtilla festa kam marrë pjesë shumë herë edhe më herët në jetën time, sepse e ëma ime e ndjerë, Zarifeja (dada Zarë-sikundër e thërrisnin me pietet nipërit dhe mbesat) rrjedh nga fshati Debollde i komunës së Vitisë, e unë gjithnjë për të shkuar atje është dashur detyrimisht të kaloj mespërmes Binçës, kësaj qendreje madhore të katolicizmit në Kosovë. S'e kam lëshur asnjëherë rastin pa u futur brenda kishës së saj pitoreske, ku me orë të tëra, në një atmosferë jashtëzakonisht tolerante dhe vëllazërore, kam diskutuar me priftërit shqiptarë. Mandej rregullisht, qysh në vitet kur ndiqja mësimet në medresenë "Isa Beu" të Shkupit, kam vizituar edhe kishat monumentale të Letnicës dhe të Stubllës (në po këtë komunë), si edhe kishën impozante "Shën Pjetri" në Prishtinë, ku kam zhvilluar debate të numërta me imzot Dom Zef Gashin.
Një herë, edhe përkundër gjithë argumentimeve të mia që ia parashtrova një myslimani fanatik e të pabindur lidhur me sufizmin burimor islamik dhe me vëllezërit tanë shqiptarë sufijë e katolikë, më në fund i thash shkoqur: "I dua ata sepse thjesht jemi vëllezër të një Vatani, të një gjuhe dhe të një gjaku, kemi një Zot dhe, para së gjithash, (i thash zëshëm) i dua për inat të shkjeve! Kjo për arsye se shkjetë e përtejkarpateve

gjithnjë janë munduar të fusin pykat e ndasisë, të përçarjes dhe të hasmërisë fetare në mes shqiptarëve".
Detyrë e shenjtë e mërgimtarit tonë është që mbi të gjitha të ruaj dhe të kultivojë traditat sublime kombëtare dhe fetare, duke shndërruar kështu xhaminë në vatër të të gjithë shqiptarëve, pa kurrfarë dallimesh. Ose, thënë ndryshe, ne duhet medoemos ***në xhamitë tona të fusim frymën hoxhëtahsiniane; në teqetë tona të fusim frymën shehmaliane (të Seh Hilmi Maliqit nga Rahoveci, i teqesë Melami-tarikati i Melamive, i cili ishte një patriot i madh, sheh i shkolluar, myderiz medreseje dhe arsimtar shkolle njëkohësisht); në kishat katolike shqiptare të fusim frymën fishtiane a gjeqoviane; ndërkaq në ato ortodokse të fusim frymën noliane.***

INTELEKTUALËT
E HIJESHOJNË XHAMINË

Nën çatinë e faltores së vogël, e xhamisë "Isa Beu" të Berlinit, dhe nën çatinë e klubit „Bajram Curri" mblidheshim kokë më kokë dhe gjunj më gjunj, po sikur një LOBI i mirëfilltë, të gjithë intelektualët e komunitetit shqiptar të Berlinit. Në vijim, me një respekt të veçant, do të përmendi, ashtu shkarrazi, ata më kyesorët, respektivisht veprimtarët më të dalluar:

- Sali Sefa (nga Prishtina), mjek, ish-i burgosur politik, kryetar i klubit "Bajram Curri", figura emblematike e organizimit tonë kombëtar, përndryshe bashkëpunëtori im më i ngushtë përgjatë zhvillimit të luftës në Kosovë.
- Bujar Aliu (nga Tetova), mjek, veprimtar i dalluar, në veçanti punoi shumë në senzibilizimin e opinionit gjerman rreth kauzës sonë kombëtare. Përndryshe bashkëpunëtori im më i ngushtë përgjatë zhvillimit të luftës në Maqedoni.
- Nebi Selmani (nga Podujeva), sociolog, nënkryetar i klubit, veprimtar i dalluar, në veçanti u shqua si zëdhënës i UÇK-së në Berlin dhe më gjerë në diasporë.
- Haxhi Mejdi Osmani (nga Radusha), aktivisti më i dalluar e më i palodhshëm. Përndryshe themeluesi i parë i xhamisë "Isa Beu" në Berlin dhe kryetar i saj me vite. Në

çdo aktivitet e kam patur krah të djathtë dhe në krye të detyrës, si në çështje fetare, ashtu edhe në ato kombëtare.
- Abedin Sadiku (nga komuna e Gjakovës), dërvish i devotshëm, dosti im më i ngushtë, krah i djatht imi në gjitha aktivitetet fetaro-kombëtare. Përndryshe pjesëmarrës aktiv në luftë si ushtar i UÇK-së në Kosovë.
- Sefer Abdiu (nga Tetova), mjek përmasash evropiane, veprimtar i dalluar.
- Hajriz Mamaj (nga Suhareka), albanolog, një kohë kryetar i klubit, përndryshe koka brilante e artit dhe kulturës shqiptare.
- Ismet Nivokazi (nga Gjakova), personalitet me pedigre, një kohë kryetar i Shoqatës për Arsim, Kulturë dhe Sport "Dituria", veprimtar i dalluar kombëtar, përndryshe "kryeplaku" i shehlerëve, i intelektualëve dhe i rinisë shqiptare.
- Avdyl Zendeli (nga Shkupi), inxhinier, kryetar i LPK-së-nëndega e Berlinit, veprimtar i dalluar, përndryshe "krahu i hekurt" i ushtrive çlirimtare kombëtare.
- Rexhep Kasumaj (nga Gjakova), jurist, gazetar, përndryshe koka gjeniale e komunitetit tonë.
- Sali Beadini (nga Sllatina e Tetovës), gastronom, aktivist i dalluar në gjitha aktivitetet kombëtare.
- Nazmi Limani (nga Radusha), jurist e gastronom, aktivist i dalluar.
- Selam Jonuzi (nga Shemshova - Tetovë), një punëtor ky jashtëzakonisht i dalluar në mesin tonë. Përgjatë luftës ka dhënë kontribut të madh.

- Imer Duraku (nga Hasi i Prizrenit), jurist, një kohë anëtar i kryesisë së klubit, përndryshe veprimtar i dalluar.
- Zejnulla Jakupi (nga Bujanoci), gazetar, korrespondent i disa gazetave, aktualisht i gazetës "Zëri i ditës", përndryshe pena ndriçuese e aktiviteteve tona kombëtare.
- Sheh Sulejman Sadiku (nga komuna e Gjakovës), veprimtar i dalluar fetar dhe kombëtar.
- Sheh Musa Karavidaj (nga Hasi i Prizrenit), klerik i teqesë "Yjet e Ehli Bejtit" në Berlin, bashkëpunëtor imi i ngushtë në aktivitete kombëtare dhe fetare.
- Sheh Bedri Osmanollaj (nga Hasi i Prizrenit), veprimtar i dalluar fetar dhe kombëtar.
- Vjollca Hajdari (nga Mitrovica), zhurnaliste dhe politologe, korrespondente e RTK-së nga Berlini, përndryshe veprimtare e spikatur në senzibilizimin e opinionit gjerman dhe atij evropian rreth situatës dramatike në Atëdhe.
- Xhemshi Berisha, albanolog, veprimtar i dalluar, përndryshe krahu im i djathtë në organizimet e ndryshme fetare dhe kombëtare.
- Sali Nezaj (nga Hasi i Prizrenit), arsimtar, ish-ushtar i UÇK-së në Kosovë, mësues shkolle në Berlin dhe aktivist i dalluar.
- Kadri Mulaj (nga Mitrovica), ish-kryetar i Shoqatës për Arsim, Kulturë dhe Sport "Dituria", aktivist i dalluar.

- Musa Mulaj (nga Mitrovica), përgjegjës kryesor i emisioneve në gjuhën shqipe në "Offener Kanal Berlin", aktivist i palodhshëm.
- Nuhi Demiri (nga Radusha), gastronom, përndryshe kontribuuesi më i madh materialisht në klubin Bajram Curri, në klubin e sportit "Liria" dhe përgjithësisht për luftërat në atëdhe dhe çështjen kombëtare.
- Kamber Kamberi (nga Radusha e Shkupit), albanolog, veprimtar i dalluar i kauzës sonë kombëtare.
- Musa Aliu (nga Mitrovica), piktor i spikatur, profesor i artit, njeriu që u jepte imazh artistiko-estetik të gjitha aktiviteteve tona.
- Sali Demaj (nga Hasi i Prizrenit), mësues shkolle në vendlindje dhe në Berlin, përndryshe, thënë me sinqeritetin më të thellë, argati më i madh në mesin tonë për çështjen tonë kombëtare.
- Emin Tmava (nga Mitrovica), jurist, bën punë avokature, ish-kryetar i Unionit të Studentëve Shqiptarë në Berlin, përndryshe jashtëzakonisht i urtë, fjalëpakë e punëshumë.
- Gazmend Rushiti (nga Tetova), ekonomist, përkthyes zyrtar (shtetëror) dhe veprimtar i dalluar.
- Sadik Murseli, ish-arkëtar i klubit "Bajram Curri", njëherësh ish-kryetar i klubit futbollistik "Liria", aktivist i palodhshëm.
- Avdi Tafilaj (nga Deqani), biznesmen, kryetar i Shoqatës për Arsim "Shkëndija", përndryshe veprimtar i

dalluar dhe njëri ndër humanistët më të mëdhenj për çështjen tonë kombëtare.
- Murat dhe Taip Dërvishi (nga Radusha), që të dy kanë dhën kontribut të madh në rrafshin kombëtar. Murati kohë të gjatë ka kryer me ndërgjegje të madhe detyrën e arkëtarit të klubeve, kurse Taipi ka qenë në lartësinë e detyrës si kryetar i Odës Shqiptare në Berlin.
- Naser Visoka (nga Podujeva), inxhinier, përndryshe atdhetar i devotshëm.
- Semi Hebibi (nga Tetova) kontribuues i madh në rrafshin kombëtar dhe pjesëmarrës i drejtpërdrejtë në luftë si ushtar i UÇK-së në Maqedoni - invalid lufte (plagoset rëndë gjatë luftimeve).
- Ilir Halilaj (nga Tirana), konsul i Ambasadës së Shqipërisë, veprimtar i dalluar.
- Ramadan Nazifi (nga Radusha e Shkupit), konsul i Ambasadës së Maqedonisë, gjithashtu veprimtar i dalluar.
Këta dy konsuj në mënyrë permanente kanë qenë në kontakt me mërgimtarët tanë dhe me udhëheqësitë e asociacioneve të tyre arsimore, kulturo-artistike, sportive e fetare, për dallim nga shumë punëtorë të tjerë zyrtarë të cilët janë skajshëm statikë dhe byrokratë të vërtetë, që vetizolohen në "kullat" e tyre të fildishta apo në "rrethet e tyre kabinetike burokratike" dhe nuk komunikojnë dot me masën e gjerë.

Këtu bën pjesë dhe një tjetër, mik imi i ngushtë, për të cilin do të them pak fjalë më pastaj.
Që të gjithë kemi bashkëpunuar ngushtë në organizimin e komunitetit shqiptar të Berlinit në të gjitha sferat e jetës. Bashkërisht organizuam aktivitetet vijuese: mbajtjen e demonstratave për senzibilimin e opinionit gjerman dhe atij evropian rreth situatës dramatike në Atëdhe, hartimin e peticioneve drejtuar organizmave politikë gjermanë, evropianë dhe botërorë, mbajtjen e tubimeve informative lidhur me zhvillimin e luftërave në Atëdhe, grumbullimin e mjeteve materiale, të medikamenteve dhe mjeteve sanitare për ushtritë tona çlirimtare kombëtare (UÇK-në në Kosovë, UÇPBM-në në Kosovën Lindore dhe UÇK-në në Maqedoni), për fëmijët bonjakë dhe për invalidët e luftës, organizimin e vajtjes në Atëdhe të luftëtarëve vullnetarë nga Berlini dhe rrethina, organizimin e të gjithë përvjetorëve historikë kombëtarë, organizimin e tribunave dhe tryezave të rrumbullakëta me tema nga më të ndryshmet shkencore, filozofike dhe fetare, organizimin e punkteve shkollore me mësim plotësues në gjuhën shqipe për fëmijët tanë, si dhe shumë aktivitete të tjera me relevancë kombëtare.
Për çdo çështje me relevancë, respektivisht për çdo rast emergjent ishim në gjendje të mblidhemi brenda 15 minutave për të kuvenduar shtruar, me tolerancë dhe shqiptarçe. Shi për këtë na e kishin gjelozinë edhe të gjitha klubet dhe xhamitë e tjera të diasporës shqiptare.

Parasëgjithash dhe mbi të gjitha ne në mënyrë të sukseshme kemi çrrënjosur të gjitha barrierat e një provincializmi a krahinarizmi të përçudshëm, sëmundje e vrragë këto që krijonin jaze e hendeqe ndarjesh në mes vëllezërve tanë të të gjitha trojeve tona ILIRO-DARDANO-SHQIPTARE. Kjo brengë, zatën, na ka nxitur që të punojmë palodhshëm dhe në mënyrë sistematike në zhdukjen e kësaj dukurie negative. Dhe kjo, mos të harrojmë, nuk është bërë me shkop magjik, me fraza okultiste apo me "amin". Por, ne, që të gjithë, me një bashkërendim të thellë, kemi qenë bashkë me komunitetin gjithëshqiptar në luftë dhe në paqe, në gëzim dhe në mërzi, në kamje dhe në mjerim, thjesht në çdo aktivitet. Ndërkaq, ne, klerikët e konfesionit islamik, kësokohe kemi medituar kësisoji:

"Zot, të qofshim falë, po kur edhe popat antikrishtë satanë serbo-ortodoksë tok me kishat e tyre obskure svetisaviane dhe shkollat e "bogosllovjes" vehen në shërbim të luftës së tyre të fëlliqur e ekspIloatuese dhe të megaloidesë së tyre për Kosovën "si tokë e shenjtë serbe" ose "si Jerusalem serb", atëherë përse vallë ne, hoxhallarë, priftër e shehlerë tok me xhamitë, kishat dhe teqetë tona të mos vehemi në shërbim të luftës sonë të drejtë dhe të pastër! Ne nuk manipulojmë me shenjtëritë tona, ndërkohë që ata manipulojnë në mënyrë perverse me shenjtëritë e tyre fetare sllavo-shkinore".

Një mik im teolog, me të parë të bombardimeve të para të forcave ushtarake të NATO-së mbi caqet ushtarako-policore serbe, klithi (buqiti) zëshëm:

"Kosovë kreshnike! Mbi ty është shtrirë dora e Zotit. Gjaku i shehidëve, pushka dhe baruti i trimave zemërluaj e i shqiponjave sypatrembura, si dhe djersa e mundi i politikanëve të mençur vaditi ARDHMËRINË TËNDE, Kosovë martire!"

XHAMITË E DIASPORËS NË MBROJTJE TË IDENTITETIT SHQIPTARË

Nëpër xhamitë e shqiptarëve të diasporës, krahas kryerjes në to të detyrimeve fetare (namazeve dhe ibadeteve të tjera përcjellëse) nga xhemati, krahas përpjekjeve për të krijuar vetëdije të mirëfilltë islame në xhemate, diskutohet dhe punohet parreshtur edhe në drejtim të ngritjes së vetëdijes kombëtare. Në veçanti ky paralelizëm në relacionin FE-KOMB gjen shprehje praktike nëpër xhamitë tona në diasporë, që janë të numërta gjithandej ku shtrihen mërgimtarët tanë shqiptarë.

Këto xhami, madje, për nga përbërja e strukturës nacionale të anëtarësisë së tyre, janë kryesisht kombëtare. Nisur nga ky fakt, diaspora shqiptare me të drejtë i quan ato "QENDRA ISLAME SHQIPTARE". Kjo, thjesht, për arsye se në to, ligjëratat, mësim-besimi fetar dhe aktivitetet tjera përcjellëse, të karakterit fetar dhe kombëtar, organizohen ekskluzivisht në gjuhën amtare shqipe dhe frekuentohen kryesisht nga xhematlinj shqiptarë.

Funksionimi i qindra qendrave fetare islame shqiptare në mbarë diasporën, shqiptarëve i solli, madje edhe akoma po u sjell dobi të shumënumërta. Në vijim do të përmendi radhazi ca më kryesoret prej tyre.

Xhamitë digë e fuqishme
në mbrojtjen e islamit të shqiptarëve

Siç dimë, përgjithësisht në diasporë ka shumë shqiptarë. Veçmas rrugën e mërgatës e ka marrë një numër jo i vogël i pjesës më vitale të popullit tonë – rinisë, e cila për çdo ditë përballet me rreziqe të nduarta të një jetese skajshëm të vesternizuar të botës perëndimore, ku rrjedhimisht i kanoset rreziku i tjetërsimit, si në planin kombëtar, ashtu edhe në atë fetar.
Së këndejmi, do theksuar faktin se këtu , pra në Perëndim, bota kristiane, përfshirë këtu të gjitha grupimet sektare të saj, vepron palodhshëm në rrafshin e misionarizmit fetar. Ajo nëpërmes të kampanjës së vet misionare mëton të ushtrojë ndikim në kristianizimin e pjesëtarëve të Fesë Islame, në përgjithësi, dhe të shqiptarëve të proviniencës muslimane, në veçanti. Thënë të drejtën, ajo në këtë rrafsh ka korrur sukses jo të paktë, veçanërisht tek ata shqiptarë muslimanë që nuk kanë njohuri të bollshme, për të mos thënë fare, lidhur me mësimet bazë të fesë vetanake.
Na ndodhë jo rrallë herë (në banesën time private më ka ndodhur disa herë; shih ironinë, ata, si aktivë që janë në rrugën e tyre misionare, edhe prijësit fetarë të Islamit nuk i kursejnë !) të jemi dëshmitarë të aksioneve të parreshtura të një numri misionarësh kristianë, veçan të atyre që janë përkatës të sektit të ashtuquajtur

"Dëshmitarët e Jehovait". Këta të fundit, të armatosur me literaturë të bollshme nga thesari i doktrinës së tyre religjioze (natyrisht të përkthyer në gjuhë të ndryshme të botës), s'përtojnë fare të trokasin në dyert e familjeve muslimane, duke u imponuar me stilin veçmë të njohur për ne. Mjerisht, në saje të dëshmive që disponoj ose, thënë më thuktë, në saje të dëshmive që mi rrëfeu një mik imi, ta zëmë, vetëm në Berlin kemi 46 familje shqiptarësh muslimanë që kanë konvertuar, disa anëtarë të tyre pjesërisht e disa tërësisht, nga muslimanë në jehovistë.
Duke qenë se edhe në trojet e atdheut tonë, veçanërisht në Republikën e Kosovës, vepron në mënyrë të institucionalizuar Qendra e Dëshmitarëve të Jehovasë, si edhe mbi 300 shoqata e asociacione të tjera kristiane nga të gjitha anët e botës, të cilat veprojnë lirshëm nën petkun transparent të "humanitetit", e kemi për detyrë që me vigjilencën më të lartë të mbrohemi nga fushata e saj propagandistike, e cila po helmon rininë tonë. Natyrisht, pjesën më të madhe të kësaj detyre duhet ta vërë mbi supet e saj elita fetare islame, respektivisht të gjitha organet e Bashkësive Islame Shqiptare në vend dhe në botë.
Nga ana tjetër, jo më pak e rrezikshme, mbase edhe më fatale, është edhe propaganda këtu në Perëndim e disa sekteve të ashtuquajtura islame ose, thënë më drejtë, antiislamike, siç janë kadianizmi, ahmedizmi dhe behaizmi. Pre e fushatës së tyre propagandistike është bërë, mjerisht, një numër jo i vogël i vëllezërve dhe

motrave tona muslimane.
Andaj, duke i pasur parasysh të gjitha këto fakte nga sa u shtruan më sipër, funksionimi i qindra xhamive dhe qendrave Islame shqiptare në mërgatë, predikimi i mirëfilltë islamik në to nga ana e hoxhëve shqiptarë-prijës të shëndoshë islamikë, dhe nga ana e motrave tona teologe, madje zhvillimi i mësim-besimit fetar nëpër mektebe (mësojtoret islamike të themeluara pranë xhamive) si edhe frekuentimi i tij nga fëmijë grupmoshash të ndryshme dhe dygjinish, distribuimi i literaturës burimore islame në gjuhën shqipe, si edhe organizimi i një vistër aktivitetesh përcjellëse me qëllim të informimit sa më të drejtë dhe burimor të opinionit të gjerë musliman lidhur me çështjet themelore të Fesë sonë madhore (këtu kam fjalën , ta zëmë, për organizimin e tribunave debative, tryezave të rrumbullakëta, kuizeve, seminareve, simpoziumeve, shtypit fetar islam etj.), paraqesin digë të fuqishme në mbrojtjen e mërgimtarëve tanë nga rreziqet e sipërtheksuara.

Xhamitë e mërgatës si faktorë integrues gjithëshqiptar

Kudo në xhamitë e mërgatës i sheh të gjithë shqiptarët e trojeve tona etnike, pa dallime fisnore, krahinore, dialektore a bindjesh partiake, tek rreshtohen krah për krahë në safë për t' iu përkulur me devocion të thellë All-llahut të Madhërishëm, i qofshim falë, përgjatë zbatimit të lutjeve të përditshme fetare. Thjesht kudo, në

cilën do kryesi dhe kuvend të xhemateve të të gjitha xhamive dhe qendrave islamike në mërgatën shqiptare, qoftë në ato të organizuara në nivel qyteti, qoftë në ato në nivel shteti, janë të inkuadruar anëtarë prej vëllezërve tanë shqiptarë nga të gjitha trojet tona, pa kurrfarë dallimi. Po, doemos të jetë kështu, për arsye se vetë natyra e koncepcionit të Fesë sonë madhore, si besim mazhoritar yni, në parim nuk duron kurrfarë ndarjeje, kurrfarë segregacioni racor, ta zëmë, të tipit amerikan apo të atij antisemitist të tipit nacist hitlerian midis njerëzve të botës, porse, përkundrazi, të gjithë njerëzit në mbarë botën i trajton si krijesa të barabarta para një të vetmit Krijues të Gjithëpushtetshëm.
Nisur nga ky fakt, në raportet e përditshme vëllazërore të atyre mërgimtarëve që frekuentojnë shtëpitë e All-llahut të Madhërishëm nuk zë vend sindromi i provincializmit, i cili gjetkë, aty-këtu ndër disa shqiptarë shpirtligë, për fat të keq, ndodhë të shprehet në ato trajtat tejet primitive, duke klasifikuar njëri tjetrin në ata të kësaj apo asaj krahine, të këtij apo atij fisi etj.
Nga ana tjetër kur të kihet parasysh edhe përbërja heterogjene e mërgimtarëve tanë për
nga aspekti fetar (muslimanë dhe kristianë të të dy riteve), të gëzon pa masë toleranca
shembullore ndërfetare midis shqiptarëve, si jashtë në mërgatë, ashtu edhe në atdhe, tolerancë kjo e pashembullt në botë që ia kanë zili të gjitha kombet e botës.Në këtë drejtim për çdo lëvdatë është

bashkëveprimi në mërgatë i klerit fetar ndër shqiptarët në nivel komunitetesh, si në planin fetar, ashtu edhe në atë kombëtar. Kështu që jo rrallë herë të ndodhë të shohësh klerin shqiptar-hoxhën, priftin dhe shejhun, tek këmbejnë vizita mes vedi në raste kremtash fetare, tek marrin pjesë bashkërisht në të gjitha tryezat ku për objekt diskutimi është ndërgjegjësimi, arsimimi, edukimi, pajtimi dhe uniteti midis shqiptarëve, si edhe ajo më fundamentalja-zgjidhja e drejtë e kauzës sonë gjithëkombëtare.

Kështu nuk është vetëm sot. Kështu ka qenë denbabaden ndërmjet shqiptarëve konfesionesh të ndryshëm. Në veçanti në periudhën e Rilindjes Kombëtare Shqiptare fenomeni i tolerancës fetare ndër shqiptarët do të bëhet tipar kombëtar dhe ndër hallkat e fuqishme në integrimin e ruajtjen e njësisë së kombit shqiptar në kushte të ekzistimit të dy feve. Këtë e konfirmon edhe rilindasi ynë, Pashko Vasa, i cili në veprën e tij "E vërteta për Shqipërinë dhe shqiptarët" ndër të tjerash thekson: "Ndërmjet shqiptarëve muslimanë dhe kristianë nuk ka pasur kurrë urrejtje të rrënjosura, as armiqësi shekullore. Ndryshimi në fe nuk ka qenë kurrë arsye që t' i shtynte në ndarje; muslimanë e kristianë kanë jetuar gjithnjë në një rrafsh barazie, duke gëzuar të njejtat të drejta dhe duke përmbushur të njejtat detyra...". Këtë, për më tepër, e kanë konfirmuar edhe studjues të huaj, njohës këta të botës shqiptare, si Edit Durham, Thomas W.Arnold, Hahn, Noel Malcolm etj. Fjala bie, historiani i shquar

Thomas Arnold në kapitullin "Përhapja e Islamit në Shqipëri" të librit të tij "Historia e Islamit" veç të tjerash thekson: "Shqiptarët muslimanë dhe të krishterë flasin gjuhë të njëjtë, kultivojnë tradita të njëjta dha kanë mendime e zakone të njëjta. Krenaria e përbashkët kombëtare është aq e fuqishme, sa që nuk i ka lënë vend ndikimit të ndasive fetare te pjesëtarët e këtij populli".
Kjo është porosia e Hafiz Ibrahim Dalliut, këtij burri të madh shqiptar: "Ne shqiptarët, të cilës do fe qofshim, jemi që të gjithë vëllezër të një gjaku dhe të një vatani. Do të shkojmë mbarë e mirë, ashtu sikundër jemi duke shkuar, si vëllai me të vëllanë e vet dhe do të punojmë si prore së bashku për lulëzimin e atdheut tonë dhe, po që e kërkon nevoja, do ta mbrojmë atë me gjakun tonë".
Ky është amaneti i Patër Anton Harapit, këtij apostulli të bashkimit politik shqiptar, sikundër me të drejtë do ta quaj historiani ynë, dr. Muhamet Pirraku,: "Intolerancë dogmatike. Tolerancë shoqërore qytetare dhe tolerancë shoqërore politike !". Animin e njërit kundër fesë së tjetrit Patër Anton Harapi e quante "zekth i egoizmit", sëmundje kjo të cilën ai e luftonte me shpirt: "...por fakti është ky, se ne jemi pra muslimanë, katolikë e ortodoksë, dhe si të tillë duam të rrojmë në një harmoni vëllazërore !".
Dhe kjo, njëherazi, është detyrë madhore kombëtare për të gjitha gjeneratat shqiptare nga Mulla Idrizi i Gjilanit, këtij heroi shqiptar: "Kemi tri fe, por kemi një Atdhe të përbashkët, një gjak vëllazëror, një gjuhë, një diell dhe,

mbi të gjitha, një Zot. Detyrë mbi detyrat kemi bashkimin dhe mbrojtjen e Atdheut... !“

Xhamitë e mërgatës – shembull atdhetarizmi

Bashkësitë Islame Shqiptare në diasporë tok me të gjitha xhamitë dhe qendrat ose organizmat tjerë fetarë-që veprojnë brendapërbrenda tyre, prore ndihmuan dhe akoma vazhdojnë të ndihmojnë luftën e përgjithshme që po bën populli ynë në atdhe për paqe, liri dhe pavarësi nga thundrra e armiqëve tanë shekullorë.
Në tempujt fetarë të diasporës, ku shqiptarët me devocion dhe përkushtim të thellë shpirtëror i përkulen të Madhit Zot, viteve të fundit janë mbledhur ndihma të shumta gjithëfarëshe me destinim për nevojat e gjithëmbarshme në atdhe, si: në të holla, veshëmbathje dhe mjete të ndryshme sanitare. Madje, në këtë destinim janë derdhur edhe të gjitha mjetet e mbledhura materiale të detyruara fetarisht, si, për shembull, të dhënat materiale nga fondi i zeqatit dhe sadakatu-l-fitrit, si edhe aksionet e kurbanëve me rastin e festave të Bajramit të Kurbanit, institucione këto gjigante socio-ekonomike të përfshira në korpusin juridik të legjislacionit islamik (Sheriatit).
Besimtarët tanë mërgimtarë, duke dëshmuar në vepër atë devizën tonë të shenjtë programatike “PËR FE DHE ATDHE“, nuk ngurruan dot të ndihmojnë nga djersa e tyre fitoren e demokracisë dhe thyerjen e bastionit të

murtajës së kuqe (komunizmit) në Shqipërinë londineze (pikërisht në këtë kohë, pra në vitin 1992, duke qenë se ushtroja detyrën e imamit në Qendrën Islame Shqiptare në Cyrih të Zvicrës, isha dëshmitar okular i mbledhjes së mjeteve të mëdha materiale nëpër xhamitë e Zvicrës e të Gjermanisë për të ndihmuar fitoren e demokracisë përballë regjimit totalitar komunisto-ateist në zgjedhjet parlamentare dhe presidenciale që, asokohe, mbaheshin në Shqipëri). Madje, në vazhdën e këtyre aktiviteteve, ata pa rezervë ndihmuan në çdo mënyrë rezistencën luftarake të drenicakëve atdhetarë, në veçanti, dhe luftën heroike të pjesës më të moralshme të popullit tonë – USHTRITË ÇLIRIMTARE SHQIPTARE: Ushtrinë Çlirimtare të Kosovës, Ushtrinë Çlirimtare të Preshevës, Bujanocit dhe Medvegjës dhe Ushtrinë Çlirimtare Kombëtare në Maqedoni, madje të dëbuarit tanë nga lufta makabrale shkinore, tempujt e shenjtë universitarë në Prishtinë e Tetovë, shtresën e rrezikuar sociale në atdhe - veçanërisht fëmijët jetimë e të traumatizuar dhe invalidët e luftës, më pastaj një numër të konsiderueshëm të shkollave e xhamive tona të rrënuara nga dora barbare shkinore dhe përgjithësisht Bashkësitë Islame Shqiptare në Shqipëri, në Kosovë dhe në Maqedoni.

Të gjithë shqiptarët e Berlinit dhe më gjerë, ta zëmë, nuk e harrojnë dot kontributin e pashoq të Qendrës së këtushme Islame Shqiptare, Xhamisë "Isa Beu", e cila, pikërisht atëherë kur krisi pushka e parë çlirimtare në trevat e Drenicës martire, fill pas mbylljes së Klubit

“Bajram Curri“, u shndërrua në çerdhe të nacionalizmit shqiptar. Në çastet më dramatike për kombin, ajo liroi lokalet e saja për tubimin e të gjithë mërgimtarëve tanë, pa dallime fisnore, krahinore a fetare, ku ditë e natë rresht u mbajtën tubimet informative lidhur me situatën jashtëzakonisht tendosëse në Kosovë dhe, njëkohësisht, në të u mblodhën me qindra mija marka gjermane për njerëzit e sakrificës, për trimat e UÇK-së. Po kështu ndodhi edhe përgjatë luftës sonë në Preshevë, Bujanoc e Medvegjë, si edhe në atë të fundit në trojet iliro-shqiptare nën Maqedoni.

Njëkështu vepruan, mbase akoma vazhdojnë të veprojnë edhe të gjitha qendrat tjera islame shqiptare, thjesht të gjitha xhamitë e diasporës, të cilat, në çastet më të liga për kombin dhe atdheun, ditën të shndërrohen në vatra atdhedashurie, në vatra humaniteti e solidariteti gjithëshqiptar, ndërkohë që shërbenin për ushtrim të shërbesave e liturgjive fetare nga ana e mërgimtarëve tanë fetarë e atdhetarë.

Në këto aksione, përveç qendrave tona fetare, qenë kyçur, si prore, edhe të gjitha organizmat e tjerë kombëtarë të diasporës: klubet, bashkësitë, shoqatat e nduarnduarta humanitare, kulturo-arsimore dhe sportive, ose, thënë me një fjalë, shqiptarët e të gjitha viseve të Shqipërisë etnike, që gjenden me banim dhe punë përkohësisht në gurbet. Natyrisht, kështu, të gjithë së bashku, në mënyrë unike, duke ndjekur gjurmët e të parëve tanë, përkatësisht gjurmët e shoqërive, klubeve e

komiteteve kombëtare të kolonive shqiptare në mërgim nga periudha e Rilindjes Kombëtare. Konkretisht kam fjalën për këto komitete, klube e shoqëri më të dalluara:

Komiteti kombëtar shqiptar me emrin "Komiteti Qendror për mbrojtjen e të drejtave të kombësisë shqiptare", alias Komiteti i Stambollit, si organ i parë shqiptar në mërgim, u formua në Stamboll në dhjetor të vitit 1877. Në të, si organizatorë kryesorë, bënin pjesë rilindasit më me famë të kohës, si: Abdul Frashëri (kryetar), Imer efendi Prizreni, vëllezërit Sami dhe Naim Frashëri, Pashko Vasa, Zija Prishtina, Jani Vreto, Abedin Pashë Dino, Zejnel Abedin Prishtina, Mehmet Ali Vrioni, Ahmet Koronica etj. Ky Komitet do t'i paraprijë formimit të Lidhjes Shqiptare të Prizrenit, anëtarët e të cilit do të bëhen udhëheqës kryesor të kësaj lidhjeje të famshme. Në konferencën e organizuar me iniciativën e tyre po në Stamboll më 12 tetor 1879, ku u përfaqësuan shqiptarët e të tri besimeve fetare dhe të krahinave të ndryshme, u themelua shoqëria kulturore shqiptare me emrin "Shoqëria e të shtypurit shkronja shqip", ose shkurtimisht Shoqëria e Stambollit me në krye rilindasin e shquar, ideologun kryesor të Lëvizjes Kombëtare Shqiptare, dijetarin, shkrimtarin dhe publicistin famëmadh Sami Frashëri. Shoqëri kjo e cila do të marrë në dorë organizimin dhe drejtimin e gjithë lëvizjes kulturore kombëtare. Pas shtypjes së qëndresës luftarake të forcave ushtarake të qeverisë së përkohshme të Lidhjes së Prizrenit nga forcat e ekspeditës osmane më 23 prill

1881 (pikërisht këtë ditë-sikundër rrëfejnë faktet historike- qendra e qeverisë së përkohshme dhe vatra kryesore e Lidhjes Shqiptare, Prizreni, u gjend në shtetrrethim të plotë) dhe, si rrjedhojë, kalimit në arrati të Abdul Frashërit, Imer Prizrenit dhe Sulejman Vokshit, Komiteti i Stambollit do të jetë i detyruar të veprojë në ilegalitet dhe në kushte të vështira ekonomike. Në të tilla rrethana, një rol të veçantë brenda Komitetit, kanë luajtur Samiu dhe Naimi, të cilët, ndonëse jetonin në Stamboll, vazhduan së intensifikuari aktivitetet e tyre kombëtare, duke krijuar lidhje me patriotë shqiptarë brenda e jashtë atdheut, si dhe duke përgatitur e botuar tekste shkollore, vepra letrare e politike dhe organe shtypi në gjuhën shqipe. Ndër të tjerash, rrugën e këtij Komiteti do ta ndjekin si shembull edhe kolonitë tjera shqiptare në vijim. (Për më gjerësisht shih në: "Historia...për shkollat e mesme", fq. 98; Iljaz Rexha, Komiteti i Stambollit dhe aktiviteti i tij, kumtesë shkencore e mbajtur me rastin e 100 vjetorit të Lidhjes së Prizrenit, botuar në "Edukata Islame", revistë fetare tremujore e Kryesisë së Shoqatës së Ulemave në Prishtinë, nr. 53/54, 1990, fq. 43)

Në fund të vitit 1884 shqiptarët e Bukureshtit (Rumani), në vend të Degës së Shoqërisë së Stambollit, formuan shoqërinë kombëtare "Drita". Kjo shoqëri iu përmbajt programit të Shoqërisë së Stambollit. Në vitin 1887 nga gjiri i shoqërisë "Drita" u formuan dy shoqëri të veçanta, njëra me emrin e mëparshëm dhe tjetra me emrin "Dituria", të cilat tek më 1906 do të shkrihen në një

shoqëri të vetme të njohur me emrin "Bashkimi" në të cilat rol të veçantë luajtën Nikolla Naçoja, Pandeli Evangjeli, Asdreni etj. ("Historia...", nëntema Shoqëritë patriotike të mërgimit, fq. 114)

Shoqëria kombëtare "Dëshira" e shqiptarëve të mërguar në Sofje (Bullgari), është themeluar më 01 janar 1893. Themelues dhe përfaqësues më eminent i saj ishte poeti dhe publicisti i shquar Josif Bagieri, i cili bashkëpunoi ngushtë me kryetarin e saj-Ligor Borova, sekretarin-Dhimitër Mole dhe anëtarët e kryesisë- Adham Shkaba dhe i riu Spiro Garo, i cili përpiloi tekstin e një kënge që-kësokohe-pati jehonë të fuqishme në të katër anët e Shqipërisë-këngë kjo nëpërmjet së cilës ai, duke qenë se fetarisht i përkiste ritit ortodoks të besimit kristian, vuri në dukje qartazi njërën nga devizat më sublime të Lëvizjes Kombëtare Shqiptare, atë të ruajtjes me çdo kusht të identitetit dhe gjenit kombëtar shqiptar pavarësisht nga përkatësia fetare, sidomos aty kur thotë: "S'jemi grekër, as bullgarë, Turq as serbë nuku jemi, Jemi vetëm shqipëtarë, Këtë emër nder e kemi!". Edhe kjo shoqëri ndoqi rrugën e shoqërive të Stambollit e të Bukureshtit. (Shih më gjerësisht librin: Ruzhdi Mata, Josif Bageri, Tiranë, 1983)

Shoqëritë kombëtare të Komunitetit Shqiptar në Egjipt (Misir) janë të numërta.

Shoqërinë e parë kombëtare "Vëllazëria e parë" mërgimtarët shqiptarë e formuan në vitin 1875. Shoqërinë "Vëllazëria e Shqiptarëve" e themeluan

rilindasit e shquar Thimi Mitko dhe Jani Vreto, i ardhur nga Shoqëria e Stambollit, në Kajro më 1894. Shoqëria "Vëllazëria shqiptare" u formua në Aleksandri po në vitin 1894, kryetar i së cilës u zgjodh publicisti Milo Duçi. Pas kësaj, më 1910 organizimi kulturor i shqiptarëve arriti nivel të lartë me themelimin e "Vëllazërij e shqiptarëve të Misirit-Bashkimi", me qendër në Aleksandri, e shtrirë përmes degëve në disa qytete të Egjiptit. Më 1918 nga gjiu i kësaj shoqërie, respektivisht nga dega e saj e Kajros, u themelua "Komiteti i shqiptarëve të Misirit". Po këtë vit në Kajro u themelua edhe një shoqëri e re me emrin "Vëllazëria" me kryetar Loni Kotën. Organizata tjetër "Klubi i Shqiptarëve" është formuar më 1920 në Misir Xhedide, një lagje kjo e re e Kajros. "Bashkësia shqiptare në Egjipt", ndërkaq, është shoqëria e fundit shqiptare në këtë shtet, e cila u themelua më 1929. Kontribut të madh në organizimin e këtyre shoqërive e klubeve, përveç të sipërpërmendurve, dhanë edhe rilindas të tjerë intelektualë, krijues e atdhetarë të flaktë, si Thoma Kreji, Spiro Dine, Thanas Tashko, Jani Vruho, Loni Logori, Andon Zako Çajupi-alias autori i Memorandumit të kolonisë Shqiptare të Misirit, dërguar Konferencës së Paqes në Paris më 1919, Filip Shiroka-alias "poeti i mërgimit", Aleksandër Xhuvani etj. (Për më gjerësisht shih librat: Emin Azemi-Shkëlzen Halimi, Shqiptarët e Egjiptit, shtëpia botuese "Logos-A", Shkup, 1993; Dr. Muhamed Mufaku, Shqiptarët në botën arabe, botoi ndërmarrja botuese

Rilindja, Prishtinë, 1990)
Shoqëria "Kombi Shqiptar" i arbëreshëve të Italisë me në krye përfaqësuesin më të shquar, letrarin zulmëmadh Jeronim de Rada.
Edhe në SHBA, madje, janë të numërta klubet dhe shoqëritë e mërgimtarëve shqiptarë, si klubi "Malli i Mëmëdheut" në Bufallo (1906), ai "Koha e Lirisë" në Nju Jork (1906), "Besa-Besë" në Boston (1907) me kryetar Fan S. Nolin, "Lidhja" në Shën Luis po më 1907. Kontribut të veçantë rreth formimit të këtyre shoqërive kanë dhanë Fan S.Noli, Petro Nini Luarasi dhe Sotir Peci. Nga ana tjetër shoqërinë "Lidhja Shqiptare" të themeluar në Buenos-Aires të Argjentinës (1907) dhe atë "Përlindja" në Odese (1908), si dhe ca shoqëri të tjera. Në prag të Luftërave ballkanike, të cilat sollën ndryshime të mëdha politike dhe territoriale në Ballkan, me angazhimin e Fan Nolit, të Faik Konicës, të Kristo Dakos dhe të atdhetarëve të tjerë, mërgata shqiptare e SHBA-ve në prill të vitit 1912 formoi prej 13 shoqërive patriotike Federatën Panshqiptare "Vatra", me seli në Boston. (Më gjerësisht shih veprën: Dr.Masar Kodra, Çështja shqiptare në analet diplomatike amerikane (1918-1945), shtëpia botuese "Logos-A", Shkup, 1997)
Këto shoqëri, klube e komitete kombëtare shqiptare, asokohe, në ato momente të rëndësishme e vendimtare për kauzën tonë të pazgjidhur kombëtare, mbajtën gjallë dashurinë për atdheun, ndihmuan në të gjitha mënyrat zhvillimin e arsimit, të letërsisë e të kulturës sonë

kombëtare në përgjithësi, fuqizuan luftën për çlirimin e vendit dhe mbrojtën të drejtat e kombit shqiptar me një varg aktivitetesh kruciale politiko-diplomatike në arenën ndërkombëtare.

Pra, mërgimtarët shqiptarë, si në të kaluarën, ashtu edhe sot, vehen me të gjitha mënyrat e mundshme në shërbim të MËMËDHEUT. Të gjithë nisen nga ajo motoja sublime e Rilindjes Kombëtare: "SKAMNOR MË TË MADH NUK KA SE NJERIU PA ATDHE". Mbase edhe nga motoja pejgamberike e Muhammedit a.s., që të bën të meditosh:

"PAS ÇLIRIMIT S'KA MË SHPËRNGULJE (MIGRIM), POR KA VETËMSE LUFTË DHE VENDOSSHMËRI. E, KUR TË SHPALLET KUSHTRIMI PËR LUFTË, PËRGJIGJJUNI !"

XHAMITË E MËRGATËS
SI VATRA TË EDUKIMIT SHPIRTËROR

Krahas rolit që duhet të kenë xhamitë në diasporë në rrafshin e ruajtjes dhe kultivimit të identitetit fetar dhe kombëtar tek shqiptarët, ato paralelisht duhet të lozin edhe rolin e qendrave edukative. Nëpërmes të mesazheve shpirtërore dhe etiko-religjioze, që burojnë nga koncepcioni i Fesë sonë madhore, e që parreshtur predikohen edhe nëpër xhamitë e diasporës sonë, shqiptarët, dhashtë Zoti i Madhërishëm, do të këndellen nga antivlerat e botës satanike, që kanë vërshuar gjithandej rrugët e botës perëndimore, si, ta zëmë, nga narkomafia, konsumimi i narkotikëve, prostitucioni, pedofilia, bixhozi, vjedhja, alkoolizmi dhe nga të gjitha veprat tjera kriminale e joqytetëruese në përgjithësi. Këtu duhet bërë dallim në mes Evropës së zvetënuar që prodhon drogën, prostitucionin, homoseksualizmin etj., dhe Evropës së qytetëruar që prodhon Dekarta, Ajnshtajna, Njutna, Pikaso, Kanta, Hegela etj.

S'do mend se kultivimi në permanencë i ndjenjave religjioze dhe të vënët në jetë të parimeve fetare lozin rol jashtëzakonisht pozitiv në fisnikërimin shpirtëror dhe në rimëkëmbjen morale të popullit tonë, e veçmas të rinisë sonë. Kjo për arsye se, ndonëse Perëndimi na mahnitë për nga pikëpamja e të arriturave të tij në planin shkencor, ekonomik, industrial e tekniko-teknologjik,

por, nga ana tjetër, këtu na ndodhë të pëballemi edhe me hendeqe të shumënumërta në planin etik shpirtëror, d.t.th. kam fjalën për ato antivlerat që i theksova pak më parë. Thënë ndryshe, bota perëndimore, në segmentet që i zëmë ngoje, i përngjan rrjetit të merimangës në të cilën bëhet fare lehtë gjah cilido insekt i llojit tjetër që mëton t'i afrohet atij.

Thënë të drejtën, kur bëhet fjalë për praktikën religjioze të shqiptarëve të diasporës ose, thënë më thuktë, për çështjen sa shqiptarët praktikisht ushtrojnë praktikën e të frekuentuarit të xhamive, të dhënat faktike nga terreni janë mjaft dëshpëruese. Unë personalisht, ta zëmë, këtu në Berlin – ku ushtroj detyrën e imamit, nuk jam i kënaqur shumë me pjesëmarrjen e bashkatdhetarëve tanë në xhami. Këtë përshtypje e kam thjesht nga fakti se nga afro njëzet mijë shqiptarë sa, siç pandehim, aktualisht janë në këtë metropol, prej tyre vetëm 530 janë të anëtarësuar në xhami. Po të njëjtën situatë, siç marr vesh nga kolegët e mi, e kemi edhe në xhamitë tjera kudo në diasporë. Madje, aq më tepër, nga kontaktet e shpeshta që kam edhe me kryesitë e klubeve, shoqatave e asociacioneve të ndryshme kulturo-arsimore, që aktualisht veprojnë këtu, marr vesh, mbase më ndodhë të bindem edhe vetë, se numri i anëtarësimit të mërgimtarëve tanë në to është tejet deficitar.

Pyes, vallë prej nga e tërë kjo indolencë e jona karshi kulturës dhe arsimit tonë kombëtar ? Përse tregohemi kaq indiferentë karshi kulturës sonë fetare ?

Kam bindjen, për çka do të kisha dashur të jem i zhgënjyer, sikur tek shumëkush prej nesh lufta për ekzistencë më të mirë, lakmimi pas bukës së bardhë të Perëndimit, është shndërruar në qëllim parësor të jetës në vend të mjetit për të, ose thënë me gjuhën e filozofisë "kur njeriu dalldiset tejmase pas një aksioni, kalon në vetëharresë", d.t.th. katandiset si më keq në vorbullën e tjetërsimit fetar dhe kombëtar. Shi për këtë, një pjesë jo e vogël e rinisë sonë është bërë dhe, për fat të keq tonin, akoma vazhdon të bëhet pre e skizofrenisë fatale, pre e përdhosjes së përgjithshme morale që mbretëron në shumë kënde a rrugë të Perëndimit. Jo rrallë herë na ndodhë t'i gjejmë në punët më të ndyta e më të thjeshta, duke injoruar me këtë rast ngritjen intelektuale e arsimore. Ca prej tyre, që kanë prindërit me stazh më të gjatë në mërgim dhe që kanë standard më të lartë, i shohim tek bredhin rrugëve të parrugë me vetura luksoze, ndërkohë që etërit e tyre nuk qajnë kokën fare për fatin dhe ardhmërinë e tyre. Për pasojë, ata ndodhë të kenë epilog tragjik. Duke u shndërruar në gjermanë a françezë, në norvegjezë a anglezë, dhe çka jo tjetër, ata ndodhë të tjetërsohen skajshmërisht nga traditat vetanake fetare dhe kombëtare.

Vërtet është për të ardhur keq kur sheh vëllanë dhe motrën tonë tek vuajnë nga sindromi i snobizmit, tek vuajnë nga kompleksi i inferioritetit i të qenit shqiptar dhe musliman. Snobizmi – sikundër sqarohet kjo shprehje e huaj në Fjalorin e gjuhës së sotme shqipe, është

një prirje e sëmurë për të ndjekur mënyrën e jetesës, sjelljet dhe modën e një klase, të një shtrese a të një grupi që mendohet si më i lartë e më i zgjedhur në një shoqëri, përkatësisht është një shije e sëmurë për t'i pëlqyer gjërat vetëm pse janë të huaja, të jashtëzakonshme e të stërholluara, pa shikuar vlerën e vërtetë të tyre. Këta, sipas Faik Konicës, përfaqësojnë grupin e levantinëve të sotëm (levantinë F. Konica i ka quajtur ata shqiptarë që kujtonin se bëheshin perëndimorë duke zëvendësuar qeleshen me kapelën, brekushet me pantallona dhe brezin tradicional të shqiptarit me një rryp europian). Dhe, si rrjedhojë e këtyre prirjeve të sëmura, ndër meshkujt, tifozë këta të lëvizjes së ashtuquajtur hipike, ka filluar të praktikohet me të madhe tatuazhi i lëkurës, ngjyrosja e flokëve, bartja e gërshetëve, vathave dhe zinxhirëve prej ari në qafë e në dorë, ndërkohë që femrat - tifoze këto të lëvizjes feministe, të viktimizuara nga kompleksi i inferioritetit i të qenit "gjini e butë", për ditë e më shumë po imitojnë stilet e një jetese karakteristike për "gjininë e fortë", për "krijesën muskuloze". "Ç'të bësh, tanimë gjendemi në mes të Evropës !", "Kjo është shenjë e bashkëkohësisë, shenjë e kulturës dhe qytetërimit perëndimor (!!?) " – si rëndomë kështu arsyetohen , i bëjnë qejf vetes të rinjtë tanë. Ç'mjerim ! Ç'varfëri shpirtërore, o Zot !

Teksa po përsias rreth njeriut snobist, teksa zura ngojë shqiptarët levantinë, pashmangshëm mu kujtuan fjalët shumë domethënëse të Reiner Maria Rilke: "Për gjyshërit

tanë, shtëpia, kroi publik, kulla e njohur, madje edhe rrobat e tyre, palltoja e tyre, ende kishin rëndësi tejet të madhe, ishin larg më autentik; gati në çdo objekt gjendej një pjesëz e personalitetit të caktuar, në çdonjërën ruhej diçka njerëzore. Sot prej Amerike na vijnë dhe na grumbullohen gjëra të parëndësishme, sende që krijojnë iluzionin e jetës ... Shtëpia në kuptimin amerikan, rrobat e modës amerikane, molla amerikane ose rrushi i atjeshëm s'kanë asgjë të përbashkët me shtëpinë, rrobat, frutin, me rrushin që ngjallë në vete shpresën dhe meditimet e stërgjyshërve tanë ...".

Nga ana tjetër, papunësinë e madhe të shumë mërgimtarëve tanë po e zëvendëson, mjerisht, shferci, bixhozi dhe narkodilerizmi. Tani dëgjojmë se si me të madhe po transportohen këto dukuri të fëlliqta edhe nëpër tregjet e zeza të vendlindjes sonë. Vallë, athua pyeten prindërit tanë se prej nga i gjithë ai kapital që po ua sjellin bijtë e tyre nga gurbeti.

Madje, aq më keq, konfliktet fizike dhe vrasjet ndërvëllazërore janë bërë dukuri fare normale. Jo rrallë herë na ndodhë të dëgjojmë se si i vëllai ngre dorën e krimit mbi të vëllanë e vet shqiptar. Burgjet janë të mbushura përplot shqiptarë... Dhe një varg anomalish të tjera.

Rinia jonë duhet ta dijë se fuqia e botës perëndimore nuk është në atë si jeton, veç në atë si punon ajo, dhe se fuqia e saj nuk është në mosbesim, klube të natës, brezin e ri të degjeneruar moralisht etj., por në punën, zellshmërinë,

diturinë dhe përgjegjësinë e jashtëzakontë të njerëzve të saj. Së këndejmi, ne, shqiptarët, duhet t'i vemë vetes për detyrë fetare dhe kombëtare që nga qytetërimi perëndimor të marrim vetëm atë që është në dobinë tonë, duke ruajtur kështu me fanatizëm kulturën vetanake fetare dhe kombëtare.

Shumë mërgimtarë tanë, të vetëdijshëm për të gjitha këto anomali që mund t'ua shkaktojë jeta e gurbetit dhe, si të thuash, të prirë nga kritere të çiltërta islamike e atdhetare, organizohen në qindëra mija forma për të ruajtur vlerat më thelbësore të fesë dhe kombit mu në zemër të botës perëndimore. Për këtë dëshmon funksionimi i qindra xhamive e organizmave të tjerë kulturo-arsimorë islamikë, si dhe funksionimi i po aq organizmave kulturo-arsimorë e politikë kombëtarë në gjithë diasporën shqiptare. Për këtë dëshmon mbajtja e tubimeve, e tryezave të rrumbullakta dhe e tribunave të numërta nëpër xhami e klube, organizuar nga intelektualët tanë të të gjitha profesioneve (hoxhët, mjekët, pedagogët, psikologët, gazetarët, letrarët...), ku për objekt diskutimi shtrohen problemet më aktuale nga rrafshi i religjionit, shëndetësisë dhe etikës. Për këtë, madje, dëshmojnë përpjekjet permanente dhe punët kolosale të shumë prindërve dinjitozë nga mesi ynë për t'ju dhënë fëmijëve të tyre edukatë të shëndoshë fetare dhe kombëtare.

Prandaj, vëlla dhe motra ime e dashur, ju rini ejani që të gjithë së bashku, krah për krah, të vemë në shtëpinë e

Perëndisë, që t'i përkulemi devotshmërisht Krijuesit tonë të Madhërishëm, i qofshim falë, duke e lutur përunjtësisht të na i falë mëkatet e të na shpëtojë nga kjo hata e madhe që na ka pllakosur. Sepse qytetërimi kolosal i Perëndimit i përbërë nga materialet më impozante ndërtimore e intelektuale, sakaq, gjendet në çastet e agonisë. Radiot dhe TV-të u bien kambanave për kushtrim. Mjekët, poetët, psikologët, teologët, futuristët, thjesht njerëzit e të gjitha profileve shkencore, i ka pllakosur lemeria. Kjo lemeri i nxit ata që të rebelohen, që të kundërshtojnë, që të ngrenë zërin e protestës, që të tërheqin vëmendjen nga "ÇASTI I FUNDIT", nga "APOKALIPSA" apo, thënë me gjuhën kur'anore, nga "KIJAMETI", të cilin e paralajmëroi Zoti i Madhërishëm në Librat e shenjtë. Le të lexojmë disa nga këta zëra protestues:

"Bota njerëzore, sot, e ngujuar në kthetrat e një civilizimi të vrazhdtë, të pashpirt e skajshëm sekularist, po vdes dalëngadalë në mënyrë "elegante" – tërhoqi vërejtjen Papa në mesazhin e tij ceremonial dedikuar botës katolike dhe njerëzimit në përgjithësi. "Vetëm "kthimi Zotit" mund ta shpëtojë botën perëndimore nga kataklizma e një jetese skajshëm materialiste" – apeloi me të drejtë filozofi i shquar gjerman M. Hajdeger (Heidegger). "Njerëzit nga njëri-tjetri janë ndarë me mur betoni, që pengon çdo rrjedhë të dashurisë. Natyra po gulçitet, e njeriu gjithnjë e më shumë po ndjehet i vetmuar në botën grandioze të qytetërimit të sotëm" –

pohoi fituesi i Çmimit Nobël për letërsi (1968) dhe njëri nga personalitetet më të shquara të letërsisë së sotme botërore, Josunarij Kavabata, shkrimtar ky japonez i cili, në pamundësinë që t'i bëjë ballë mynxyrërave të vetmisë, në rrethana të një gjendje të rëndë psikike, bëri vetëvrasje më 1971(madje, veç të tjerash, ai ka pohuar edhe këtë: "Përkundër dinamikës së jashtme iluzore, në të vërtetë dinamikës së jetës shoqërore e politike, civilizimi karakterizohet me ritmin e ngadalësuar të brendshëm të jetesës. Dramat e absurdit janë pamje autentike të jetës së njerëzve në shoqëritë më të zhvilluara bashkëkohore. Konfori është dukja e jashtme e jetës në civilizim, kurse absurdi dukja e brendshme, me dialektikën "sa më tepër konfor e pasuri", do të ketë aq më shumë ndjenjë absurdi e dezorientimi. Përfundimisht, bota e civilizuar vetëm në skenën e teatrit zbulon "tragjedinë e vet njerëzore"). "Falë kushteve bashkëkohore, jeta e njeriut do të zgjatet për afro tri dekada, mirëpo kjo do të jetë e mërzitshme dhe e zbrazët" – deklaroi përpara komitetit të Senatit amerikan për studimin e ndikimit të teknologjisë tek njeriu dhe shoqëria, Roger Rawel, drejtor i Qendrës për Hulumtime Sociologjike në Harvard. Njerëz që kanë filluar të ngjiten lart si Zoti, që t'i ngjajnë Atij, kanë filluar ta mohojnë Atë, atëherë botën do ta mbulojë gjaku dhe urrejtja, urrejtja e madhe e tyre!" – thoshte personazhi Tom Pejn në librin biografik të Hanard Fast. "Për herë të parë pas tre milion vitesh të epokës njerëzore teknikisht u bë e mundur që të shfaroset çdo gjurmë njerëzore në

tokë. Garat e dy blloqeve superfuqi për t'u pajisur me armë sa më të fuqishme bërthamore, paraqesin sot industrinë më rentabile. Qytetërimi perëndimor është në dekadencë, në qoftë se nuk lirohemi nga mashtrimet e saj, do të na shpie deri te vetëvrasja planetare" – konstatoi shkencëtari dhe filozofi i shquar francez, Rozhe Garodi (Roger Garaudy). "Zhvillimi i shpejtuar çdokund në botën perëndimore është i ngarkuar me fenomene të atilla përcjellëse, siç janë: despotizmi, korrupsioni, shkapërderdhja e familjes, pasurimi i shpejtë dhe i paarsyeshëm, dalja në plan të parë e individëve matrapazë e të paskrupullt, urbanizimi i shpejtë me heqjen e traditave, vullgarizimi i marrëdhënieve shoqërore me përhapjen e alkoolizmit, drogës dhe prostitucionit. Pendë kundër këtij vërshimi të jokulturës dhe primitivizmit mund të jetë besimi i pastër dhe i fortë në Zotin dhe praktikimi i dispozitave fetare nga ana e të gjitha shtresave të popullit. Vetëm feja mund të sigurojë që qytetërimi të mos zhdukë kulturën. Progresi i thatë material dhe teknik, sikur që këtë disa raste qartë e vërtetojnë, mund të shndërrohet në kthim të hapur në barbarizëm" - nënvizoi politikani dhe mendimtari bashkëkohor Alija Izetbegoviq në librin e tij "Deklarata Islame". Lëkunden kodrat exhelore nga fjalët e mëdha që premtojnë shpëtim e "qytetërimi i madh perëndimor , si e nga po venë, do të shkatërrohet e tretet" – parashikoi filozofi dhe shkencëtari i shquar gjerman, Osvald Spengler, në librin e tij katërvëllimësh "Shkatërrimi i

Perëndimit". "Si në spektrin natyror të botës, i cli rrënjësisht është ndryshuar nga qytetërimi modern, ashtu edhe në të gjitha fushat e veprimtarisë njerëzore "shkretëtira" gradualisht po shkon duke u rritur" – konstatoi John R. Snyder (Gianni Vattimo, "Fundi i modernizmit"). Pra, thënë shkoqur, "gjërat kanë arritur një pikë ku është koha e fundit të reagohet domosdo" (Rene Guenon, Kriza e botës bashkëkohore).....

Fundja, mos të harrojmë kurrë se, "një ditë gjithçka do të shkatërrohet përveç Zotit të Madhërishëm" – konstatoi i Gjithëpushtetshmi, i Gjithëdijshmi, i Urti, Krijuesi ynë në Kur'anin e Shenjtë.

Pra, vëlla dhe motra ime e dashur, ejani të vemë së bashku në xhami sepse fabrikat, uzinat, të cilat janë faltore të "fesë" pozitiviste, janë duke vjellë helm vdekjeprurës për shumë lloje shpezësh, shtazësh, bimësh, por edhe për vetë njeriun. Në përmirësimin e gjendjes nuk mund të ndihmojnë as shoqatat e ndryshme ekologjike, Green-Peace, të gjelbërit politikë e as fondacionet e asociacionet e ndryshme shtetërore e as ato të iniciativës së lirë-qytetare. Varret e destruktivitetit janë aq të thella, sa që është rëndë të shërohen me veprimtari shekullariste, ato mund t'i shërojë vetëm një revolucion ose transformim shpirtëror-religjioz, përmes logosit të mirëfilltë, i cili do t'i prekë telat e ndërgjegjës sonë njerëzore.

E, vëlla dhe motra ime e dashur, ne, me të hyrët në shtëpinë e Zotit, në xhami, në fakt nuk futemi në botën e

misticizmit për të braktisur përgjithmonë botën reale, për të ikur nga ballafaqimi me sfidat e saj, duke u vetëizoluar kështu në botën spirituoze plot egoizëm. Jo. Përkundrazi. Ne vetëm përgjatë kohëve të parapara fetarisht për ushtrim lutjesh e liturgjish do të ikim sakaq nga kjo botë e sotme skajshëm e djallëzuar, skajshëm materialiste, në botën e përtejme të prehjes shpirtërore, ku, shpirti ynë i ndotur do të akumulonte energji nga DRITA HYJNORE. E, me t'u akumular të kësaj energjie, me t'u çelnikosur të shpirtit tonë të përvuajtur, do të dilnim jashtë xhamisë për të ndezur flakadanin e këndelljes, të mbijetesës dhe të rimëkëmbjes morale e shpirtërore ndër vëllezërit dhe motrat tona në këtë botë përplot terr. Sepse, sikundër kërkojnë rregullat e logjikës së shëndoshë, "nuk është mençuri vetëm të mallkojmë terrin, por mençuri është që secili prej nesh të ndezë nga një çiri për t'i bërë një grimë dritë botës". Sepse "nëse nuk digjem unë, nëse nuk digjesh ti, nëse nuk digjemi të gjithë nga pak, vallë si mundet errësira të bëhet dritë!". Sepse, për më tepër, të kalisim në shpirtërat tanë një kësi fryme altruiste në raport me rrethin dhe botën në të cilën jetojmë, është nga detyrat prioritare që Zoti i Madhërishëm i përcaktoi secilit individ veç e veç.

E, revolucioni ynë vazhdon bashkëbesimtarë të nderuar; revolucionin nuk e bën dot një njeri, as një mijë, as një ushtri dhe parti; revolucioni bëhet nga populli kur ky merr RRUGËN e ZOTIT dhe kur në secilin njeri ka diçka të perëndishme që nuk harrohet. Kështu kemi

revolucionin kur skllevërit thyejnë zinxhirët e tyre dhe kemi revolucionin kur një njeri i fuqishëm-i çelnikosur me DRITËN e ALL-LLAHUT përkulet me mëshirë drejt të pafuqishmëve dhe thotë: "Vëllezër dhe motra të nderuara, mbahuni pas krahut tim!": "Ejani të ju furnizoj me pjesë nga DRITA e ZOTIT!"

Dhe, tekembramja, mos të keqkuptohemi, kur unë dhe filozofë, shkencëtarë e mendimtarë të mëdhenj kritikojmë CIVILIZIMIN e kohës, ne, në të vërtetë, nuk kërkojmë që ai të flaket. Kjo për arsye se, edhe sikur të donim ne, civilizimi nuk mund të flaket. Ajo që duhet bërë dhe që mund të bëhet, po qe se kemi vullnet për këtë, është të rrënohet miti për të. S'do mend, rrënimi i këtij miti është kusht për humanizimin e mëtejmë të botës dhe detyra më e madhe e kulturës. Vizioni i shëndoshë teist religjioz është alternativë e vetme që çliron njeriun nga kthetrat e mitit kundruall civilizimit. Ky vizion është shprehje e rezistencës, e kundërshtimit, e rebelimit të njeriut ndaj një bote që zhvillohet dhe rritet njëdimensionalisht, përkatësisht kundër botës njëdimensionale të civilizimit modern. Ky vizion mbi njeriun dhe civilizimin, kuptohet, s'ka gjë të përbashkët me vizionin nihilist dhe filozofinë e absurdit të protagonistëve të ekzistencializmit (Albert Camus: I huaji dhe Njeriu i revoltuar; Jan P. Sartr, Backett, H. Markuze: Njeriu i një dimensioni etj.) të cilët vetëmse ngrenë zërin e protestës përse s'ka njeri, përse s'ka Zot, ndonëse bëjnë përpjekje për "ta gjetur", por nga mossuksesi në këtë rrafsh ata të zhgënjyer e thellësisht të

revoltuar konstatojnë: "Çdo gjë është e lejuar do me thënë çdo gjë është e kotë dhe absurde meqë në gjithësi nuk ka Zot dhe meqë njeriu vdes", "Në një botë në të cilën zhduket sakaq iluzioni dhe dritat, njeriu ndjehet si i huaj. Ky është dëbim pa dalje, pa shpresë", "Njeriu është synim i kotë", ose "Kemi ardhur nga bota e hiçit, për hiçin, rreth hiçit dhe vetëmse rrotullohemi kotsëkoti dhe sërish kthehemi në botën e hiçit" (këtë tezë e kam parafrazuar nga libri i Sterjo Spases "Nga jeta në jetë – Pse?" – Z.I.). Ky vizion (teist religjioz), madje, s'ka kurrfarë lidhje as me vizionin e protagonistëve të filozofisë materialiste, të cilët, të çliruar nga rreziku i absurdit dhe i kotësisë, besojnë se bota dhe njeriu kanë vetëm cak praktik utilitarist, kanë funksion, qoftë ky edhe zoologjik. Vizioni religjioz, në veçanti ai islamik, botën dhe njeriun, materien dhe shpirtin, kulturën dhe civilizimin i kundron në ekuilibër, i kundron si binom. Pra është vizion dydimensional kundrejt njeriut dhe kosmosit në përgjithësi. Ndërkaq, kur kishim fjalën për protestën ose rebelimin, ai më qartazi shfaqet në atë devizën programatike të një besimtari të mirëfilltë, në KELIMEI SHEHADETIN e shqiptuar zëshëm, nga thellësitë e shpirtit:

"S'KA MIT, S'KA KULT, S'KA HYJNI TJETËR PËRVEÇ ZOTIT TË LARTËMADHËRISHËM, TË GJITHËPUSHTETSHËM, I QOFSHA FALË"

I NDERUARI PROFESOR,
I TËRË RRUZULLI TOKËSOR ËSHTË XHAMI!

Në orët e vona të natës ik shpejt e shpejtë nga bota e vetmisë që të takohem me mikun tim të ngushtë podujevas, Bislim Selmani. Po, po, pikërisht natën. Vallë s'e krijoi Zoti natën para ditës (konfirmim kur'anor)? Vallë nuk zbritën natën të gjitha relevatat hyjnore (shpalljet e Zotit: Zeburi, Tevrati, Inxhili dhe Kur'ani)? Vallë nuk kërrusej gjatë në sexhde, në "salatul-lejl" (lutjen e natës) profeti Muhammed (Zoti e bekoftë!)? Vallë s'meditonte natën babai i profetëve, Ibrahimi, mbi krijimtarinë e Zotit, mbi diellin, hënën dhe yjet? …
Mistiku i madh mysliman, Hasani thoshte: "*Një orë meditim është më e mirë se sa një vit ibadet (adhurim)*". Ndërkaq Omer bin Abdul-Azizi thoshte: " *Meditimi është vepra më e mirë ose ajka e adhurimit*". Madje, vallë, nuk meditoi vetë profeti ynë fisnik, Muhammedi a.s., dhjetë vjetë para shpalljes së Kur'anit famëlartë në shpellën Hira të Mekës së bekuar? Edhe atë kryesisht në orët e vona të natës. E, natën nuk pipëtinë asgjësend për të të dekoncentruar: as zhurma shurdhuese e njerëzve, e makinave dhe e uzinave, as shumëllojshmëria e ngjyrërave, as rrezet përvëluese të diellit, as cicërrima e zogjëve … e as asgjësend tjetër. Në një këso qetësie të thellë, profeti Muhammed a.s. shndërrohej i tëri "në vesh" për të dëgjuar me vëmendjen më të thellë lajmet dhe

mesazhet e Perëndisë. Dhe, pikërisht nga atje lartë në kodër, nga shpella, për të soditur më mirë, më thellë dhe më qartë realitetet apo dramat e botës njerëzore poshtë në tokë.

Kam çka të përsias kur bisedoj me Bislimin, sepse ai ka diplomuar në Universitetin e Prishtinës - dega filozofi-sociologji, ku drejtpërdrejtë ka ndjekur ligjëratat nga profesorë të shquar të lëndëve të zëna ngojë, veçan nga i ndjeri, akademik Fehmi Agani, mr. Ukshin Hoti (i zhdukur pa gjurmë në kohën e luftës së fundit në Kosovë) dhe nga dr. Muhamedin Kullashi (ligjërues në Universitetin e Sorbonës), i cili lekcionet e filozofisë i ka dëgjuar drejtpërdrejtë nga filozofi botëror francez Zhan Pol Sartër.

Vetëm me Bislimin kaloj çaste të mrekullueshme, duke këmbyer mendime të llojllojshme. Thjesht kemi shumëçka të përbashkët. Vallë nuk janë simotra binjake teologjia dhe filozofia? Po teozofia dhe misticizmi, skepticizmi dhe racionalizmi, intuita dhe intelekti?……

Debatet maratonike që zhvilloj së bashku me të, pavarësisht kohëzgjatjes, për ne janë defakto disaminutëshe. Pikëtakimet tona zakonisht realizohen në vende neutrale, larg turmës, sepse thjesht nuk dëshirojmë që ndonjë i paftuar të na shkëpusë nga bota e meditimeve teozofiko-filozofike. Kjo s'do mend, ngaqë edhe klauzolat e shenjta ndalojnë kategorikisht t'u ndërhyhet, t'u kumtohet apo t'u pështpëritet diç atyre që veçmë gjenden në zbatim e sipër të ritualeve spirituoze.

Por kot u flet "të shurdhërve"! Mistiku përgjatë zbatimit të ritualeve religjioze, filozofi përgjatë meditimeve kontemplative, shkencëtari përgjatë hulumtimeve kimiko-fizike a astronomike në kabinetin a laboratorin e tij, myslimani përgjatë faljes së namazit, besimtari përderisa gjendet në xhami i zhytur në zikër, lutje e meditacion, myezini përderisa thërret ezanin për të lajmëruar kohën e namazit, dervishi përgjatë zhvillimit të***"sem'asë"*** (vallëzimit mistiko-sufist) në teqe etj., thjesht depersonifikohet, dematerializohet, apo thënë me gjuhën filozofiko-sufiste, "shkrihet në Zotin" (arabisht: ***"fena fil-lah"***), ndërkohë që shpirti dhe truri i tij nga bota fenomenale (nga ***"alemush-shehadeh"***) treten diku thellësive të botës së mistershme, treten në botën e përtejme (në ***"alemul-gajb"***). Kështu që në takimet tona ekzistojmë vetëm ne (unë dhe Bislimi). Pardon, s'jemi as ne! Është, në fakt, vetëmse bota e imagjinatave, respektivisht bota e meditimeve tona. Hmmm! Thënë më drejtë, s'janë as ato, mbi të gjitha është vetëm Zoti (i qofshim falë!): ***"Gjithçka do të tretet, do të zhduket përveç All-llahut të Madhërishëm"*** (konfirmim kur'anor). Në një rast e pata pyetur: "Din të më tregosh se ç'është dallimi qenësor midis filozofit dhe teologut?" M'u përgjigj: "Që të dy, në esencë, merren me "të Vërtetën Absolute". Ia ktheva: "Po, por dallojnë në format dhe mënyrat e të arriturit tek kjo "e Vërtetë". Si mendon? - ndërhyri ai me habi. "Nëse të jesh filozof do të thotë (sipas filozofit gjerman Karl Jaspers) të jesh gjithnjë në

rrugëtim për të kërkuar të Vërtetën e për të mos e gjetur dot, atëherë të jesh teolog do të thotë të kesh këtë "të Vërtetë", thënë figurativisht apo në metaforë, "në dorë". Do të thotë s' është detyrë e teologut të kërkojë sikurse filozofi "të Vërtetën Absolute", porse detyrë e tij është që të sqarojë atë. Kjo sepse vetë Zoti na "paraqitet" në kohë dhe në hapësirë nëpërmes të shpalljeve qiellore dhe të profetëve të Tij, duke na vënë në dijeni emrin, cilësitë, çfarësitë dhe veprat e Tij. Ai (qoftë lavdëruar!) këtë e bëri nga mëshira për robërit e Vet, sepse e dinte që ata nuk kanë mundësinë që nëpërmjet të trurit (shkencës dhe filozofisë) të depërtojnë në esencën ose në qenësinë e botës së***"gajbit"***, e botës së matanshme (metafizike-eskatologjike) …

"Për më tepër, i nderuari mik, kjo nuk nënkupton margjinalizimin e tërësishëm të paradigmave filozofikë për të arritur tek Hyu, porse, sikundër thash, kjo vetëm dëfton për pamundësinë e të kuptuarit tonë të qenësisë së Tij. Parasëgjithash, madje, Zoti i Madhërishëm, siç na mëson empirizmi teologjik - para se të jetë "objekt" i të perceptuarit tonë racional, Ai është "objekt" i ndjenjave më të ëmbla, i ekstazës religjioze dhe i satisfaksionit tonë të thellë shpirtëror. Kjo botë grandioze, ndërkaq, s'është tjetër veçse EMANACION i të Madhërishmit, i Krijuesit Absolut, i Lëvizësit të Palëvizshëm (sipas Aristotelit), i Parashkakut të shkaqeve dhe kauzaliteteve, i Njëshit të domosdoshëm përpara biliarda zerove të pavlerë (sipas Pitagorës) - i All-llahut xhel-le shanuhu".

Një herë tjetër më tha: "Kam përshtypjen sikur ju klerikët, thënë metaforikisht, po "e konzervoni" Zotin në tempull, në xhami, ndërkohë që pohoni se Ai është i gjithëfuqishëm dhe gjendet gjithkund!" "Megjithëkëtë kjo është keqkuptim - u përgjigja - sepse specifikë ekskluzive (par exellance) e legjislacionit tonë fetar është që jo vetëm tempujt por edhe mbarë rruzullin tokësor e konsideron për faltore, për xhami. Profeti ynë e konfirmoi këtë duke deklaruar botërisht: ***"Mbarë toka më është bërë MESXHID (xhami) dhe vend për t'u pastruar (tejemmum)"***. Do të thotë, sipas koncepcionit islamik, Zotit mund t'i lutemi e t'i përkulemi kudo në natyrë. Këtu shfaqet universaliteti i mësimeve të fesë sonë të ndritur, i ISLAMIT … Kurse unë dhe ti duhet t'ia mësyejmë xhamisë (vend-tubimit fetar) që shpirtërat tanë t'i furnizojmë me DRITËN HYJNORE. E, më pastaj, me të dalë nga xhamia, do t'i përvjelim mëngët dhe do t'i qepemi punës për të shpërndarë këtë dritë në këtë botë të sotmen përplot terr dhe mjegullnajë. Kjo, mbi të gjitha, është ajo ajka, apo, thënë më mirë, është ajo filozofia qenësore që feja Islame mëton ta sendërtojë, respektivisht ta mishërojë në trurin dhe shpirtin e njeriut, qoftë në raport me vetëveten, qoftë në raport me të tjerët, me rrethin, me ambientin natyror dhe me universumin në tërësi.

Më në fund i thash: "Çfarë mendon sikur të organizonim bashkë këtë të diele një tribunë në xhami në temën: "Besimi në Zot në dritë të argumenteve teologjike,

shkencore die filozofike". "Dakord!" - ma ktheu buzagazas.
Mirupafshim këtë të diele në xhami, filozof i nderuar!
Mirupafshim në shtëpinë e Hyut, hoxhë efendi!

P.S.: *Ka plot 12 vjetë që njihemi me Bislimin. Jemi miq të ngushtë. Kemi marrë pjesë bashkërisht në shumë veprimtari kombëtare. Ai realisht është një besimtar i devotshëm dhe i paluhatshëm, sikundër edhe shumë miq të tjerë intelektualë, por shumë pakë religjioz (në minimum i ushtron praktikat religjioze). Në fakt, për mendimin tim, edhe përkundër praktikës së dobët religjioze, ai, megjithatë, mbetet një mysliman i devotshëm në kuptimin esencial të fjalës: agjëron rregullisht muajin e Ramazanit, herë-herë e frekuenton xhaminë (i përkulet bashkë me mua Zotit të Madhërishëm) dhe, si njeri, posedon virtyte perfekte të edukatës dhe moralit islamik.*
Hmmm … ! Ka myslimanë të shumtë në këtë botë që për nga sasia dhe vëllimi janë praktikantë pedantë të ritualeve formalo-juridike fetare, ndërkohë që, për nga cilësia dhe substanca, janë besimtarë ose my'minë të dobët: nga njëra anë falen e luten pesë herë në ditë, kurse nga ana tjetër gënjejnë, shpifin, mashtrojnë, vjedhin, tradhëtojnë dhe çfarë jo tjetër (që vetëm "qoftëlargu"- satanai - mund t'u bjerë në fije!).

"EHLEN VE SEHLEN" NË XHAMINË TONË VËLLEZËR "XHEMA'ATU TEBLIGË"!

"Ehlen ve sehlen" – „Mirë se vini" në xhaminë tonë vëllezër të lëvizjes "xhema`atu tebligë"! - U them kështu zakonisht për çdo herë kur ndodhë të na vizitojnë misionarët e da`ves (thirrjes) islame. S`di, t`ua them të drejtën, kam një respekt të veçantë për ta, për arsye se posedojnë ca tipare të mrekullueshme të moralit dhe mirësjelljes islame sa, sakaq, të bëjnë për vete. Në fytyrat e tyre i vëren qartazi "gjurmët e sexhdes", që përndryshe janë konfirmim kur'anor, tevrator dhe inxhilor për shokët besimdrejtë të profetit Muhammed a.s. – as'habët.

Anëtarët e kësaj lëvizjeje kryesisht i karakterizon morali dhe edukata e Profetit tonë, Muhammedit a.s. Në spikamë do të kisha vënë ca tipare dalluese të moralit e edukatës së tyre:

- buzëqeshjen permanente vëllazërore
- butësinë në të shprehurit
- modestinë
- shpirtin universal
- moralin e përkryer
- devotshmërinë kulminante
- durimin e çeliktë
- përpikmërinë dhe kontinuitetin në rrugën e DA`VES ISLAME etj.

Ata, si të tillë, vërtet paraqesin pasqyrën ose shembëlltyrën e një myslimani ideal.

Në rrugën e da`ves ata veprojnë në mënyrë ekipore. Ekipet e tyre përbëhen kryesisht nga anëtarë myslimanë të të gjitha nacionaliteteve dhe, për më tepër, pa kurrfarë përtese, me ditë e me muaj të tërë, enden gjithandej nëpër botë, deri edhe ke skutat më të largëta e më të larta të saj, për të komunikuar e predikuar ndër njerëz MESAZHET ISLAME. Në këtë drejtim, madje, ata janë shembull i mirë për ne se si duhet pareshtur, pa përtesë dhe pa lodhje të punojmë në rrugën e da`ves islame. Ata punojnë me zell dhe me ngulm në drejtim të unjësimit të të gjitha forcave islame, duke çrrënjosur kështu me sukses zënkat, çarjet dhe fanatizmin ndërmedhëhebor në mes myslimanëve. Nëpër të gjitha xhamitë që i vizitojnë, ata nuk çojnë pluhur në praktikat tradicionale medhëhebore, duke mos ndërhyrë fare në to. Karshi formave e modaliteteve të ndryshme medhëhebore ata sillen me një takt, racionalitet e respekt të madh. Kjo sepse, thjesht, në DA`VEN e tyre ata përqëndrohen vetëm se në predikimin e kushteve e mësimeve më fundamentale të besimit (imanit), moralit e edukatës Kur`anore dhe Sunnetike.

Përshtypje të thellë më ka lënë një shembull prej mënyrave të tyre të da'ves, të komunikimit me njerëz. Në një takim rasti me një grup prej tyre në një xhami në Zvicër, më thanë: "Ne kur vizitojmë, ta zëmë, një fshat, fillimisht në qytet pyesim vendorët për veçoritë e njerëzve të atij fshati, hallet dhe problemet me të cilat ata ballafaqohen. Kështu për shembull, kur vendorët na

thonë për banorët e një fshati se hall të vetmin kanë alkoolin, të cilin e konsumojnë me të madhe, ne me të vajtur në shtëpitë e tyre, asnjëherë nuk e zëmë ngoje alkooolin në bisedat tona, por intensivisht e me takt flasim për rëndësinë e IMANIT, për dashurinë ndaj Allahut të Madhërishëm dhe të Dërguarit të Tij, Muhammedit a.s. Pse veprojmë kështu? Sepse thjesht po të ishte imani e dashuria ndaj Fese Islame në zemrat e tyre, ata nuk do konsumonin fare alkoolin e as nuk do mbanin në vitrinat e tyre shishet me pije të llojllojshme alkoolike. Me të depërtuarit e imanit - besimit të mirëfilltë në zemrat e tyre, ata, mandej, vetë, me duart e tyre, do largojnë pijet alkoolike nga raftet e vitrinave të tyre dhe kurrë nuk do e fusin në gojë".

XHAMIA DHE LITERATURA ISLAME NË FOKUS

Kemi apo nuk kemi përgjegjësi në punën tonë?

Kohëve të fundit, Këshilli i Bashkësisë Islame të Shkupit po ballafaqohet me një sërë problemesh përkitazi me aktivitetet e nduarnduarta që janë të parapara të ndërmirren në bazë të statutit të Bashkësisë Islame në Maqedoni.
Në vazhdën e problemeve të nduarta, problem numër një dhe aktualisht çështje akute për Këshillin tonë paraqet mënyra e shpërndarjes së literaturës fetare nëpër xhematet e xhamive tona: shpërndarja e një të vetmes gazetë kulturore informative islame – "Hëna e re" dhe njëherazi edhe shpërndarja e edicionit fetar, respektivisht librave të botuara nga Bashkësia Islame në Maqedoni.
Sot, në këto trende të reja bashkëkohore, kur dimë mirëfilli aktivitetet dhe veprimet kolosale të pjesëtarëve të religjioneve tjera (kryesisht të sekteve të ndryshme kristiane) që bëjnë përmes fushatës së tyre propagandistike në shpërndarjen efikase e me një platformë të larmishme programore të literaturës fetare, për ç'gjë jemi dëshmitarë okularë të aksioneve të parreshtura të një numri veprimtarësh të mirëfilltë nga mesi i tyre, të cilët, të armatosur gjer në dhëmbë me literaturë të bollshme nga thesari i doktrinave të tyre religjioze (edhe atë të përkthyera në shumë gjuhë të botës), pa përtesë enden kuloareve, qarqeve e

vendbanimeve, ku, kryesisht, jetojnë e veprojnë muslimanët, duke u imponuar kështu me sofizmat e tyre mistike të stilit veçmë të njohur për shumicën dërmuese të popullatës sonë, dhe, nga ana tjetër, kur kohëve të fundit po bëhet plasimi në mënyrë të jashtëzakonshme në mjediset tona i njëfarë literature të ashtuquajtur islame, ku bëjnë pjesë botime me tematikë kryesisht të dyshimtë e fraksioniste, nga dofarë rrymash të ashtuquajtura "shiite", "kadijaniste" ose "ahmediste", më pastaj "behaiste" dhe kushedi çka jo tjetër (këtyre vetëm qoftëlargu mund t'u bjerë në fije!), aktiviteti i të gjitha subjekteve tona fetare në këtë rrafsh, duke filluar nga nëpunësit administrativë të Këshillit tonë, imamët, muezinët, këshilltarët e xhamive e deri te xhematliu i rëndomtë, është tejet i amullt, deficitar dhe i pakënaqshëm.

Me siguri se, të gjithë jemi të vetëdijshëm për rëndësinë e madhe që ka fjala e shkruar, gazeta, revista dhe libri në orientimin dhe ngritjen e vetëdijes njerëzore, sidomos në këto kohë të pakohë e përplot mjegullnajash, por, me sa duket, të gjitha indikacionet të bëjnë të kuptosh se punët tona në këtë drejtim dëshmojnë për një pavetëdijësi dhe neglizhencë të madhe.

Kur kihet parasysh fakti se, një prej obligimeve parësore të çdo punonjësi fetar është që të shpërndajë literaturën islame dhe t'ua bëjë me dije besimtarëve në rrethin ku ai punon se muslimani duhet doemos të jetë i pajisur me dituri, se besimi dhe veprat e tij duhet t'i vë në ujdi me

konceptet burimore islame, atëherë realiteti praktik i punëve tona dëshmon për një situatë tejet të mjerueshme në këtë rrafsh dhe atë se veprimet tona në këtë kah po rrjedhin në mënyrë spontane e stihike.
Po t'u bënim një inspektim të shkurtër punëve se në ç'mënyrë dhe në ç'nivel bëhet shpërndarja e literaturës islame në terrenin tonë, do të shohim qartë kush si dhe sa e kryen me përgjegjësi këtë obligim kaq të rëndësishëm. Duke filluar që nga zyrat e administratës së Këshillit tonë e deri në xhaminë e fundit të qytetit a të fshatit më të thellë malor, para syve na eksponohen të tilla tablo që të bëjnë të rrëqethesh. Jo rrallë herë ndodh të shohësh se si grumbuj të tërë të gazetës "Hëna e re", e po aq edhe libra, broshura e revista, të vendosura diku qosheve të korridorit në selinë e Këshilli të Bashkësisë Islame, i ka mbuluar pluhuri i saharës së nënqiellit shkupjan, duke mos pasur fatin, prandaj, të freskojnë sytë e lexuesve tanë. Edhe jashtë kësaj kështjelle, nëpër xhamitë tona, fatkeqësisht, kemi po të njëjtën situatë. Literatura fetare nëpër disa xhami as që prezenton, po edhe në ato të paktat xhami ku prezenton, marketingu i nëpunësve tanë përkitazi me shpërndarjen në kohë të saj është nën çdo nivel, veçanërisht brengos fakti nëpër ato xhami ku kemi nga tre nëpunës fetarë (imamin, hatibin dhe muezinin). Kjo, kuptohet, është fund e krye rrjedhojë e mosangazhimit dhe pasivitetit total të organeve përgjegjëse në to. Kam fjalën këtu për imamët, muezinët dhe këshillat e xhamive përkatëse, të cilët, shih ironinë,

as vetë nuk lexojnë gjësend nga shtypi fetar i Bashkësisë Islame, e lëre më të marrin përsipër edhe barrën e shpërndarjes së tij nëpër xhematet e tyre ose të paktën të veprojnë palodhshëm në drejtim të ngulitjes së traditës së leximit në kokat e xhematlinjëve të tyre. Këtu, falë Zotit të Madhërishëm, bëjnë përjashtim disa xhami, çka do të bënim padrejtësi të madhe po qe se nuk do të theksonim punën kapitale dhe ekspeditive të organeve përgjegjëse të tyre në këtë rrafsh, edhe atë në xhamitë vijuese: (në qytet) Mustafë Pasha, xhamia në Shuto Orizarë, Xhedidi Isa Beu, Haxhi Junus, Haxhi Ballaban, Jahja Pashë etj, (në fshatrat) Studeniçan, Arnaqi e Epërme, Kondovë, Gllumovë, Haraqinë, Hasanbeg etj.. Vërtet të bëhet zemra mal kur të vizitosh bibliotekat pranë këtyre xhamive, që janë të furnizuara bollshëm me literaturë të larmishme fetaro-islame.

Lind pyetja: Kur dimë se leximi-dituria është faktor vendimtar i ngritjes dhe zhvillimit të një populli në çdo por të jetës, atëherë përse organet përgjegjëse të zëna ngojë shfaqin neglizhencë dhe papërgjegjësi të theksuar në shpërndarjen e literaturës fetare nëpër xhematet e tyre?

Pikësëpari do thënë se çdonjëri prej nesh nuk tregon sa duhet përgjegjësi në detyrën që ka marrë përsipër dhe punëve përgjithësisht nuk u rrekemi me seriozitetin e duhur. Nga ana tjetër, sa i përket aspektit organizativ kundruall shpërndarjes së literaturës, punët tona nuk janë sa duhet mirë të sinkronizuara në vijën e

ndërthurrur reciprokisht "KËSHILLI I BI – IMAMI - KËSHILLI I XHAMISË - XHEMATI", çka do të thotë se mungon aktiviteti dhe puna ekipore, e që, me siguri, është një ndër shkaqet themelore që puna të na çalojë në këtë rrafsh. Së këndejmi, mosplotësimi i punës organizative në atë rrjet koordinues nga ana e secilit prej nesh veç e veç, rezulton, qoftë drejtpërdrejtë, qoftë tërthorazi, me bojkotimin e literaturës sonë fetaro-islame. Pra, faji nuk është diku gjetkë, faji është mes nesh. Të gjithë ne së bashku duhet të përpiqemi që të gjejmë mekanizmat e duhur për të shpërndarë në mënyrë sa më efikase shtypin tonë fetar, gazetën, librin, sepse me të shfaqurit e respektit ndaj fjalës së shkruar ne, në radhë të parë, respektojmë vetveten. Kurrsesi nuk guxojmë t'i lejojmë vetes të ushqejmë qëndrime pasive prej pesimisti e defetisti e të themi si rëndomë: "Edhe po të përpiqemi, kot, populli ynë nuk lexon sa duhet!"; "Nuk e kemi të kultivuar fare traditën e leximit!" etj. Ose, o Zot, njëfarë alamet myderriz efendia, fill pas vërejtjes time se pse në xhaminë e tij nuk figuronte fare as një libër i vetëm në gjuhën shqipe me tematikë islame, m'u përgjigj duke bërë gafin më spektakular që më ka rënë të dëgjoj ndonjëherë: ***"Çka me boe, krejt qitopet qi po i qet "Vakafska Direkcija", asishne, m'fal, Miftidajrja ene kto hoxhallart e ri, po i qesin me guhën shipe "gramatiçki"*** (o Zot, e shqiptoi në trajtën sllave!), ***ashtuna qi xhemoti jem*** (harroi të përmendë edhe veten!) ***nuk e mer vesht***

guhën shipe me gramatik (shyqyr Zotit, herën e dytë mezi arriti ta shqiptojë drejtë të njëjtën fjalë)***...!!!"***
Sidoqoftë, urtësia e misionit tonë nuk qëndron në ate që thjesht vetëm të konstatojmë gjendjen ekzistuese. Përkundrazi, urtësia e misionit tonë qëndron në atë si ose në ç'mënyrë ta ndryshojmë ose avansojmë në mënyrë cilësore dhe sasiore gjendjen aq të mjerueshme moralisht, intelektualisht dhe ekonomikisht të popullit tonë në momentet e pikërishme. Dhe, s'ka dyshim, ne këto qëllime tejet sublime mund t'i vemë në jetë vetëm me organizim sa më cilësor dhe me unifikimin simbiotik të të gjitha potencialeve tona, pikërisht mu ashtu sikundër porosiste poeti:
"NËSE NUK DIGJEM UNË,
NËSE NUK DIGJESH TI,
NËSE NUK DIGJEMI TË GJITHË NE,
VALLË, SI MUNDET ERRËSIRA TË BËHET DRITË?"

Botuar në gazetën informative, kulturore, islame "Hëna e Re" - organ ky i BI në Maqedoni, 01 gusht 1993.

HOXHALLARËT DHE INSTITUCIONET ISLAME NË SHËRBIM TË ÇËSHTJES KOMBËTARE

Shumë kush ndodhë të pohojë se nuk shkon në xhami nga shkaku se nuk ditka të faleshka dhe se ditka shumë pakë përmendësh nga suret (kaptinat) dhe lutjet (duatë) e namazit. Unë jam i ndërgjegjshëm se një numër i konsiderueshëm i vizitorëve të xhamive posedojnë një fond "të varfër" suresh e lutjesh fetare, por megjithëkëtë i kanë qëllimet e pastërta dhe zemër të shëndoshë fetare.
Prandaj, vëlla dhe motër e dashur, mos ngurroni të vizitoni xhaminë e të faleni në të nga shkaku se pandehni se nuk keni njohuri të mjaftueshme për këtë. Fundja, askush s'ka lindur i dijshëm. Njeriu, për nga natyra, që në vitet e fëmijërisë fillon të mësojë gjithçka duke imituar të tjerët, më të mëdhenjt, më të diturit. Kështu edhe ne kemi filluar të falemi në xhami, duke imituar të tjerët. Por më vonë, falë Zotit, në mënyrë graduale jemi mësuar. Madje, për më keq, unë paradoksalisht fillet e para në xhami, si i papjekur e "axhami" që isha, i kam bërë si falës "i lazdruar". Mblidheshim me fëmijët e mëhallës së Dizhonit dhe shkonim për të falur "teravinë" në xhaminë e Jahja Pashës, ku tërë kohën, kur të tjerët faleshin seriozisht dhe në heshtje të thellë, ne krijonim rrëmujë duke u tallur me njëri-tjetrin dhe qesheshim me zë. Jo rrallë herë u iknim fët e fët shuplakave të nxehta të

kujdestarëve të xhamisë. Por tek më vonë, shyqyr, e kemi kuptuar seriozitetin e namazit dhe të xhamisë.
Mos ngurroni! Për çdo informacion të hollësishëm lidhur me praktikën religjioze, drejtohuni tek imami apo mual-limi i xhamisë më të afërt. Ata janë kompetentë dhe të gatshëm në çdo kohë të iu japin njohuritë e duhura për çdo gjë që ju intereson rreth fesë. Aty (në xhami pra) mund të hasni edhe në dhjetëra besimtarë të tjerë, që janë me dije dhe përvojë, që janë të gatshëm për t'ju ndihmuar në çdo rethanë. Aty madje mund të furnizoheni edhe me broshurat elementare fetare, të ashtuquajturit "ilmihallë", ku në mënyrë demonstrative dhe hollësisht sqarohen mësimet më thelbësore islame.
Shumë të tjerë, nga ana tjetër, ndodhë të pohojnë se kanë "zemra të pastërta" dhe nuk kanë nevojë për të shkuar në xhami. Jo, jo! Përkundrazi! Duke qenë se pikërisht jeni "zemërbardhë" duhet të shkoni në xhami për të falënderuar Zotin e Madhërishëm për këtë virtyt të shkëlqyeshëm, si edhe për të gjitha virtytet dhe begatitë e të mirat e tjera, duke u përkulur me devocion në sexhde dhe në ruku', i rreshtuar bashkë me vëllezërit e tjerë në safë.
Me të lexuar të librit tim, vëllezër dhe motra të nderuara, ne duhet të vemi bashkërisht në Shtëpitë e Zotit të Madhërishëm, nëpër xhami, që islamikisht paraqesin xhenete të kësobotshme, për t'iu lutur me devocion, me zemër dhe me shpirt All-llahut xh.sh. (i qofshim falë!)

Madje e dini ju çka? Ne nuk do të futemi aty (në xhami) për t'u vetizoluar, për t'u bërë mistikë egocentrikë, duke flakur kështu nevojat, detyrat dhe problemet e numërta të përditshmërisë. Jo, jo! Aty ne, në të vërtetë, vetëm që do t'i furnizojmë shpirtërat tanë me energjinë Hyjnore, do të mbështillemi me petkun e devotshmërisë dhe, njëherësh, do të çelnikosemi me DRITËN e Zotit të Madhërishëm. Dhe kjo, vëlla dhe motra ime e dashur, në këtë botë të sotmen skajshëm të satanizuar me përplot terr dhe mjegullnajë, paraqet domosdoshmëri. Dhe, fill më pas do të dalim jashta xhamisë për t'u përballur burrërisht me fortunat dhe krajatat gjithëfarëshe të jetës moderne dhe, njëkohësisht, do të shpërndajmë këtë DRITË ndër njerëz. Sepse, sikundër kërkojë rregullat e logjikës së shëndoshë: "nuk është mençuri të mallkojmë terrin, por mençuri e vërtet
ë është që të ndezim nga një çiri për t'i bërë një grimë dritë botës" ... Për më tepër, të kalisim një këso ndjenje altruiste në shpirtërat tanë është ndër detyrat prioritare që All-llahu i Madhërishëm ia ka bërë obligim secilit individ veç e veç.

"All-llahu është dritë (ndriques, udhëzues), e qiejve e i tokës. Shembulli i dritës së Tij i gjason kandilit të vendosur në një zgavër të errët ... (ajo dritë) Është në shtëpitë (xhamitë) që All-llahu lejoi të ngriten, e që në to të përmendet emri i Tij, t'i bëhet lutje Atij mengjes e mbrëmje... (En-Nurë, 35-37)

XHAMITË NË SHËNJESTËR
TË ISLAMOFOBËVE SHQIPTARË

Vërtet është për t'u çuditur kur të ndodhë të dëgjosh ndonjë shqiptar kokëkrisur që s'ka kurrfarë "kible", veçan ndonjë alamet intelektuali a gazetari mediokër, të pacipë e të disponuar skajshëm antifetarisht (lexo: islamofobë, alias "enverhoxhistë të balsamosur"), me një fjalë ata që i bëjnë argatinë pansllavizmit e panortodoksizmit allashkinor, tek shfaq mendime kuturu (heu, mendime u thënçin !!?) lidhur me ndërtimin e xhamive të reja apo me rekonstruktimin e atyre ekzistuese në trojet tona, qoftë kuloareve apo në mediat tona: "Xhamia është shenjë e "fundamentalizmit islamik"(!?)"; "Xhamitë janë vatra të obskurantizmit mesjetar (!?); "Ç'na duhen gjithë këto xhami, kur tashmë synojmë të integrohemi në Evropë?"; "Ata (me "ata" frikacakët e gjorë, shih ironinë, aludojnë në perëndimorët) këtë punë (pra, të ngriturit e Shtëpive të Zotit në tokat shqiptare) do të na e marrin për të keq (?!)"; "Të hyrët në xhami paraqet dalje nga binarët e "europeizmit"(?!)" ... dhe një varg dokrrash të tjera, recidiva këto të ish-sistemit komunisto-ateist.

Sa për digresion do të paraqes një nga rastet e shumënumërta që i dimë e që në mënyrë eklatante flasin për të frustruarit tanë nga sindromi i sipërtheksuar. Ky rast, të cilin e përvodha nga shtypi ditor në gjuhën shqipe, flet për kohën fill pas masakrimit nga dora gjakatare serbo-çetnike të familjes së Jasharajve

legjendarë në Prekaz të Drenicës. Fjalën e kam për një deklaratë "spektakulare", ta quaj pa ngurrim skandaloze, të një aktivisti partiak të kësaj ane, dhënë një gazetari të një mediumi të huaj informativ. Në konstatimin e gazetarit se në Kullën e Jasharajve, tashmë të rrënuar, është gjetur, ndër të tjerash, edhe literaturë me tematikë fetare islame, ai përshpejtoi në përgjigje duke bërë gaf: "Jo, jo ! Këta luftëtarë të lirisë nuk kanë ditur fare si duket xhamia përbrenda. Këmba e tyre s'ka shkelur kurrë në to !". Obobo, ç'përgjigje "diplomatike" na paskësh dhënë ky farë "aktivisti"! E shihni lexues të nderuar se ç'gaf, se ç'deklarata spektakulare, se ç'servilizëm politiko-diplomatik, se ç'kompleks të thellë inferioriteti përkitazi me kulturën vetanake fetare shfaqin ca mjeranë tanë kur gjenden në kontakte imediate me të huajt. Në rregull, secili ka të drejtën e mendimit, por ama s'mund të kuptoj se ç'hata paskësh bërë apo mundka të bëjë një luftëtar i atdheut ndaj vetes, kombit dhe, fundja, ndaj faktorit ndërkombëtar, po qe se, në sferën më intime të jetës private, paskësh pasë literaturë me tematikë fetare në bibliotekën personale apo se paskësh vizituar xhaminë etj. ! (Ç'ironi !). S'di ç'hata mund të jetë kjo (o Zot !) kur dimë mirëfilli se këto të drejta të pacenueshme, të përfshira në sferën e jetës private të çdo individua njerëzore, janë në harmoni me të gjitha konventat ndërkombëtare nga rrafshi i të drejtave të njeriut.

Në intervistën për "Panoramën" zagrebase, me titull "*Islamizmi shkatërron shqiptarët*", e cila

fragmentarisht u polemizua në "Zërin" e 4 nëntorit 1995, ndërsa në vend të përgjigjes së disa kundërpolemikave, si tekst integral u botua në "Zërin" e 25 nëntorit, ku dr. Zef Mirdita, i njohur ky për disponimin e tij skajshëm antiislamik, duke "filozofuar" mbi shkaqet e islamizimit të shqiptarëve dhe pasojat e tij negative, dezinformoi opinionin kroat mbase edhe atë shqiptar me llojlloj faktesh të trilluara dhe të paargumentuara. Ai, ndër të tjerash, shprehi edhe këtë rekomandim: "Shqiptarët, para së gjithash institucionalisht duhet të orientohen evropeisht, e jo të jetojnë sipas moralit të dyfishtë..." d.m.th. zyrtarisht evropeisht, e privatisht orientalisht. Në polemikën e tij lidhur me këtë interistë, z.Halil Matoshi (në "Zërin" e 4 nëntorit 1995) i përgjigjet në mënyrë meritore: "A thua ta ndjesh vetën evropian, pjesë e qytetërimit evroperëndimor, jo vetëm si përkatësi gjeografike, duhet që të marrësh në shpinë një kryq të madh dhe, kështu siç preferon Mirdita të nisesh sipas parullës "Me kryq në Evropë" dhe kështu ta përjetosh katarzën dhe të vetëdijësohesh se përkatësia e jote është kryqi! Fundja, as Krishti nuk ishte evropian dhe as katolicizmi fe burimore e shqiptarëve...".**(fusn:** Shih: Hajrullah Hoxha, "*Akuzat kundër Islamit dhe vlerësimet pozitive të disa shkencëtarëve jomuslimanë*", Takvimi i vitit 1996 (boton Kryesia e Shoqatës së Ulemave të Kosovës), Prishtinë**,** fq.89-90)

Këta snobë, këta kalemxhinj të mjerë e sharlatanë, po kujt, ore këta, i shesin dushk për gogla? Këta e dinë (e

dini boll mirë, por ja që janë të verbuar nga sindromi i islamofobisë) se këto pallavra e dokrra nuk ju "shiten" dot, edhe atë jo vetëm në "tregun" e Evropës, por edhe më gjerë? Po, si të "shiten" ore, kur (të gjorëve, haj medet, detyrohesh t'u flasësh edhe për gjëra veçmë të ditura botërisht, që, siç rëndomë themi, edhe një kalama i di!) gjithandej shteteve perëndimore veçmë funksionojnë (dhe që akoma pritet të themelohen një varg të tjerash në nismë e sipër) me qindra mijëra xhami, mektepe, qendra, komunitete, shoqata, fakultete dhe organizma të tjerë fetarë islamikë. Është për t'u theksuar, madje, se aty-këtu hasim edhe në faltore të atilla që janë mirëfilli xhami me minare, disa me historik të vonshëm, e disa me një historik mbi njëqindvjeçar, pra qysh nga periudha e sundimit të Perandorisë Osmane në disa shtete evropiane. Viteve të fundit, madje, në ca shtete Islami veçmë ka fituar statusin si "Fe zyrtare", duke inkorporuar edhe lëndën mbi religjionin islamik në sistemet e tyre shkollore (Gjermani, Austri, Holandë, Spanjë, Belgjikë etj.) e në ca të tjera pritet së shpejti një ndëmarrje e tillë. Në këtë kontekst, s'do mend, do përmendur edhe funksionimi i qindra xhamive, mektepeve dhe qendrave a komuniteteve ISLAME SHQIPTARE gjithandej nëpër botë, veçan në shtetet e Perëndimit, nëpër të cilat, shqiptarët mërgimtarë, përkatës të konfesionit islam, manifestojnë lirshëm religjiozitetin e tyre. Krejt kjo, kuptohet, falë të drejtës së të shfaqurit lirshëm të bindjeve a veprimtarive religjioze, falë lirive fetare, të

drejta këto të sankcionuara me ligj në cilindo shtet të Perëndimit që ka regjim të mirëfilltë demokratik. "*Kultura islame* – siç me të drejtë konstaton dr. Andrash Ridlmajer, profesor i artit islam pranë Universitetit të Harvardit në SHBA – *ashtu siç është pjesë e jetës së Botës Islame, është edhe pjesë e jetës evropiane. Evropa jetoi me Islamin dhe kulturën e tij për tetë shekuj në Andaluzinë e atëherëshme (711-1492) apo në Spanjën e sotme. Renesansa dhe humanizmi evropian i është mirënjohës kulturës islame. Islami është i pranishëm edhe sot në të gjitha vendet evropiane dhe në SHBA*". Pothuaj ngjashëm do të konstatojë edhe diplomati evropian Volfgang Petriq në "New York Times": "*Edhe Islami është pjesë integrale e traditës evropiane*".

Pra, historianët objektivë evropianë e pranojnë se Renesanca, si lëvizje më e ndritshme në historinë evropiane, kurrë nuk do të kishte filluar po të mos ishte kontributi multidisiplinar i shkencëtarëve myslimanë në zhvillimin e humanizmit dhe iluminizmit evropian, prandaj, mund të themi lirisht se Renesanca nuk ishte asgjë tjetër përveçse jehonë e civilizimit islam në Spanjë dhe Sicili, si dhe në pjesët e tjera të Azisë. Në mënyrë që të bindeni, lexoni , bie fjala, Sartonin, Brifoltin, Filip Hitin, Tomas Arnoldin, Drejperin, Gustav Lebonin, O'lirin, Bertrand Rasellin, etj. Prandaj Evropa është falënderuese ndaj qytetërimit islam, në krahasim me ca shqiptarë islamofobë, të cilët vuajnë nga kompleksi i vogëlsisë i të qenit mysliman.

Në kuptim të digresionit, madje, ja se ç'thotë lidhur me veprimtarinë e gjithëmbarshme fetare, përkatësisht ligjin për ushtrim lirshëm të riteve e veprimtarive fetare në SHBA, superfuqi kjo-vend ky të cilin ne shqiptarët sot e kemi marrë për "kible" politike, nëpunësi për çështje publike pranë zyrës së SHBA-së në Prishtinë, z. Michael McClellan: "A thua si është gjendja e fesë në Amerikë sot? Nëse shikon vetëm në Holivud dhe beson në imazhin që krijohet në botë për shoqërinë amerikane, do të mendoje se amerikanët janë kryesisht ateistë, dhe se kishat, xhamitë e faltoret nuk luajnë kurrfarë roli në bashkësinë shoqërore. Kjo, megjithatë është fare larg nga e vërteta, mund të çuditeni kur të mësoni se sot në SHBA afro 60% i kryejnë shërbimet fetare së paku një herë në muaj, se ka mbi 500.000 kisha, xhami e faltore të ndara ndër pesëdhjetë shtete ...Ne kemi mbi 530 mijë shërbyes fetarë ... Në realitet sot Amerika është shteti më fetar në botën e industrializuar, mbase edhe në tërë botën ... Që në nenin e parë të Kushtetutës sonë bëhet fjalë me theks të veçantë për fenë. Ky nen përfshinë pesëdhjetë e pesë fjalë, prej të cilave vetëm 15 të parat kanë të bëjnë me fenë. Gjashtëmbëdhjetë fjalë që garantojnë një vend në jetën amerikane për fenë, 16 fjalë për të mbrojtur fenë dhe komunitetet fetare nga ndërhyrjet e Qeverisë, 16 fjalë të tjera që u lejojnë njerëzve fetarë të kenë të njëjtën të drejtë dhe mbrojtje në bazë të ligjit. Hartuesit e parë të Kushtetutës sonë kanë qenë njerëz thellësisht religjiozë, të cilët kanë përmendur dy herë udhëzimin hyjnor të

Zotit në Deklaratën e Pavarësisë ... Pjesa dërrmuese e suksesit në lëvizjet e të drejtave të njeriut në Amerikë mund t'i atribuohen drejtpërsëdrejti rolit të kishave, xhamive dhe sinagogave, të cilat morën rolin udhëheqës në diskutimet për të ndihmuar amerikanët nga Afrika që edhe këta t'i gëzonin të drejtat e tyre të plota qytetare dhe njëkohësisht të mund të deklaroheshin haptazi për padrejtësitë dhe cenimet e të drejtave të tyre. Kështu, krahas të tjerave, edhe Komuniteti Islamik, me të gjitha strukturat e tij, u angazhua dhe po luan një rol jashtëzakonisht pozitiv e konstruktiv në konsolidimin e bashkësisë shoqërore në Amerikë". **(fusn:** Shih kumtesën e tij të lexuar para imamëve të Kosovës në Seminarin e IV-të të mbajtur në Medresenë e Mesme "Alauddin" të Prishtinës më 5 nëntor 2000: "*Roli i fesë në zhvillimin e shoqërisë civile*", "Dituria Islame"-revistë mujore e kryesisë së BI të Kosovës, nr.126, Prishtinë, fq.26-27)

Madje, aq më keq, ka edhe ca të tjerë mjeranë nga mesi ynë që të bëjnë të ndjehesh vërtet i indinjuar kur i dëgjon tek flasin me injorancë lidhur me themelimin e Shtëpive të ndritura të Zotit tek ne, në vatrat tona, nga ana e organeve të Bashkësive tona Islame, respektivisht nga ana e besimtarëve të devotshëm shqiptarë, që janë vëllezër të një gjaku, të një vatani dhe të një feje me ta (me mjeranët nga mesi i shqiptarëve të konfesionit islam). Në këtë kontekst, fjalën e kam konkretisht për një "mendim" të tyrin, që kohëve të fundit ka ndodhë të shpërfaqet disi në mënyrë të përçudshme si kuloareve

ashtu edhe nëpër disa media tonat, i cili, i shqiptuar me fjalë, ka përafërsisht këtë kuptim: ***"Pushteti sllavo-shkinor, nga njëra anë, të jep leje të ndërtosh sa më shumë xhami dhe institucione simotra të saj (mektepe, medrese, fakultete studimesh islamike etj.), si dhe "bekon" të kultivuarit e çdo veprimtarie fetare nga ana e shqiptarëve të konfesionit islam, ndërkohë që, nga ana tjetër, mbyllë dhunshëm shkollat shqipe, tempujt dituror të të gjitha instancave, si dhe atakon çdo lëvizje, përpjekje a veprimtari që konsiston në ngritjen e vetëdijes kombëtare ndër shqiptarë" (?!!!).***

Këtyre "bilmezëve" detyrohesh t'u vësh në dukje të gjitha përdhosjet, atakimet, rrënimet, konfiskimet, modifikimet, restrikcionet dhe vandalizmat që hordhitë barbare, gjenocidiste, kulturocidiste dhe ultrafundamentaliste sllavo-shkinore, kuptohet me "bekimin" e popave të tyre antikrishtë, i ushtruan mbi gjithë trashëgiminë e begatë kulturo-materiale e sakrale islamike në të gjitha vendet ex-jugosllave, në përgjithësi, dhe në trojet tona iliro-shqiptare, në veçanti. (**fusn.** në lidhje me këto lexo gjerësisht veprën time "Xhamia në analet e historisë - Hoxhallarët dhe institucionet islame në shërbim të çështjes kombëtare", botoi Fondacioni i Rinisë Islame, Zürich, 2009)

MEDITIMET E MIA RRETH TEMËS: XHAMIA DHE ANËTARËSIA

" **...se njeriut nuk i takon tjetër vetëm se ajo për çka ai përpiqet, se (fryti nga) përpjekja e tij së shpejti do të shihet; pastaj ai do të shpërblehet me një shpërblim të plotë".** (Kur`ani, 53:39-41)

"...All-llahu nuk e ndryshon gjendjen e një populli përderisa ata ta ndryshojnë veten e tyre...".(Kur`ani, 13:11)

Një prej çështjeve më substanciale, do të thosha, edhe më të ndjeshme, është anëtarësia e xhamisë.
Xhamitë medoemos duhet të posedojnë bazë solide materiale për mirëmbajtjen dhe zhvillimin sa më në nivel të aktiviteteve e veprimtarive fetare.
Thënë të vërtetën, në këtë drejtim shumica e xhamive kanë probleme serioze. Shumë prej tyre mezi arrijnë t`i mbulojnë shpenzimet e xhamisë: pagimin e qirasë, të rrymës, të nxehjes, të telefonit, pagimin e pagave të imamëve e myezinëve etj.
Çdo besimtarë i ndërgjegjshëm duhet të kryejë obligimin fetar të anëtarësimit në një xhami të caktuar. Kjo është detyrë madhore fetare. Besimtari duhet ta ndjejë xhaminë si shtëpinë e vet private.

Duke kryer pagesën e anëtarësisë tek arkëtari i xhamisë, besimtari nuk jep "hakun e hoxhës" - sikundër rëndomë thuhet popullorçe - porse ai, në të vërtetë, jep "hakun e Fesë", ai kryen një detyrim material fetar për zhvillim të gjithëmbarshëm të veprimtarive fetare islame.
Për të pasur sukses në këtë drejtim, për mendimin tim, do përqëndruar vëmendja në aktivitetet vijuese, që duhet ndërmarrë nga Bashkësitë Fetare, në përgjithësi, dhe xhamitë (imamët, myezinët dhe kryesitë), në veçanti.

Në xhami nuk ka vend për korrupcion

Imamët, myezinët, kryesitë e xhamive dhe të gjithë nëpunësit e bashkësive dhe qendrave fetare kudo në vend dhe jashtë në diasporë duhet të posedojnë virtytet morale në vijim: ndërgjegjshmërinë, besueshmërinë, devotshmërinë, saktësinë, cilësinë, vigjilencën, transparencën dhe pedanterinë në evidentimin, administrimin dhe menaxhimin e mjeteve materiale të grumbulluara në xhami.
Me këto virtyte të larta të moralit islam duhet të karakterizohen në veçanti ARKËTARËT e xhamive dhe të Bashkësive Islame.
Arkëtarët janë të obliguar moralisht dhe fetarisht të raportojnë në mënyrë transparente në çdo 3 apo 6 muaj për buxhetin (të hyrat dhe të dalat) e xhamisë përpara kuvendit ose xhematit të xhamisë.

Emrat dhe shuma e mjeteve të paguara duhet të figurojnë qartazi, në formë të shkruar, në anëkëndin e xhamisë. Kjo, kuptohet, stimulon çdo anëtarë që me kohë dhe rregullisht të kryejë obligimin e anëtarësisë në xhami.
Të gjitha mjetet e grumbulluara administrata e xhamisë i depoziton në një konto numër të veçantë në Bankën ekzistuese.
Aty ku mjetet menaxhohen drejtë dhe saktë, aty, pa medyshje, shtohet nga dita në ditë numri i anëtarëve të xhamisë.
Mjetet e tubuara nga anëtarësia, zeqati, sadakai-fitrat dhe mjetet tjera vullnetare, madje numri i anëtarëve dhe ndihmat në formë donacionesh të dhëna nga vetë fondi i xhamisë për nevoja të ndryshme, qoftë jashtë, qoftë në vendlindje, thjesht gjithçka duhet të jetë e regjistruar në mënyrë strikte, gjithçka duhet të jetë e kompjuterizuar. Së këndejmi arkëtari me kujdes të madh i ndjekë procedurat e vendosura të kontabilitetit (llogarimbajtjes). Atëherë, nëse ndërrohet arkëtari, cilido individ tjetër, që do ta zëvendësojë atë, do të dijë se çfare procedura ka përdorur paraardhësi i tij. Një revizion i llogarive do të ishte më i lehtë, nëse ndiqen procedurat standarde të kontabilitetit.
Me fjalë të tjera, barra më e rëndë dhe më me përgjegjësi nëpër xhami bie mbi supet e arkëtarëve. Profeti Muhammed a.s. thoshte: "*Secili prej jush është bari, dhe çdo bari është përgjegjës për tufën e vet*". (Buhariu dhe Muslimi)
Thënë troç: në xhami nuk kanë vend: matrapazët, të korruptuarit, hajnat e vagabontët.

Imami dhe kryesia duhet të komunikojnë vazhdimisht me masën e gjerë myslimane

Imami dhe kryesia nuk kanë për detyrë vetëm të konstatojnë duarkryq gjendjen ekzistuese të anëtarësisë. Për detyrë prioritare ata kanë të dalin në mënyrë të rregullt në opinion, të vizitojnë rregullisht besimtarët, thjesht të
trokasin në derën e çdo myslimani, si tek anëtarët, ashtu, madje në menyrë të veçantë, edhe tek joanëtarët. Të dalët në opinion, të vizituarit rregullisht të masave të gjera popullore, të komunikuarit e mesazheve hyjnore, ishte detyrë fundamentale e gjithë profetëve të Zotit. Të lexojmë me vëmendje mesazhet e Zotit të Madhërishëm:
"Ti (Muhammed) thirr për në rrugën e Zotit tënd me urtësi e këshillë të mirë dhe polemizo me ata (kundërshtarët) me atë mënyrë që është më e mira...". (Kur`ani, 16:125)
"dhe ne nuk jemi të obliguar për tjetër përveç t`ju kumtojmë ashtu qartë (Mesazhin)". (Kur`ani, 36:17)
"E ti pra, këshillo, se je vetëm përkujtues. Ti ndaj tyre nuk je mbizotërues" (Kur`ani, 88 :21)
"E kush është në rrugë më të mirë se ai që thërret në rrugën e All-llahut, që bën vepra të mira dhe që thotë: "Unë jam prej muslimanëve!". (Kur`ani, 41:33)
Imami, myezini dhe anëtarët e kryesisë së xhamisë nuk guxojnë të vetizolohen brenda për brenda mureve të xhamisë. Administrata e xhamisë nuk është e shëndoshë

po qe se nuk shndërrohet në një zgjua bletësh apo mbretëri milingonash përplot energji dhe gjallëri, që plotëson aktivitete të dobishme në xhemat dhe në masën e gjerë. Administratorët e xhamisë duhet të zbresin nga "kulla e fildishtë" tek masat e gjera...që të ndezin një revolucion të besimit në zemrat e tyre, që t`ua komunikojnë mesazhet e Profetit të tyre, që të krijojnë një rilindje islame dhe një reformë të logjikshme e progresive fetare në shoqërinë dhe në kohën e tyre. Së këndejmi edhe verset e kaptinave të para që u shpallën nga All-llahu i Madhërishëm, i urdhëruan prerazi Muhammedit a.s. që të dalë nga izolimi dhe vetmia dhe të shkojë ndërmjet njerëzve që t`i ngushëllojë, t`u ndihmojë, t`ua tërheqë vërejtjen, t`i porosisë që të veprojnë mirë, t`u prijë atyre drejt lirisë, lavdisë dhe drejtësisë dhe, mbi të gjitha, t`i ftojë ata që nga poshtërsitë e tokës të ngjiten drejt qiellores-engjëllores, t`i falen Zotit e jo individëve, despotëve e faraonëve. Feja Islame shkon aq thellë sa madje All-llahu xh.sh. i urdhëroi Musait dhe vëllait të tij Harunit a.s. që të shkojnë tek Faraoni për ta ftuar në fenë e drejtë edhe atë mu brenda pallatit të tij: "*Shkoni që të dy te Faraoni, se ai vërtet e ka tepruar. Atij i thuani fjalë të buta, ndoshta ai mendohet a frikësohet (nga All-llahu)*". (Kur`ani, 20:43-44)

Për të pasur efikasitet në këtë drejtim ne nuk guxojmë të lejojmë që xhaminë ta administrojnë vetëm 6/7 vetë, të cilët kresisht nuk veprojnë asgjë dhe presin punë e aktivitet vetëmse nga kryetari i xhamisë. Duke qenë se

s'duhet të ketë vend për strëngarkime individuale, imami dhe kryesia duhet të formojnë urgjentisht ***trupën operative*** që në mënyrë konstante do të veprojë në terren. Trupa operative duhet të përbëhet nga anëtarë të devotshëm e besnikë nga të gjitha nahitë e krahinat shqiptare. Në këtë mënyrë punët përshpejtohen në mënyrë të sukseshme për arsye se njerëzit vendasë njihen mirë mes veti dhe kanë ndikim në njëri tjetrin. Madje ata e dinë më së miri se në ç'kohë njerëzit i vjelin frytet e punës (kur i marrin rrogat). Për më tepër, puna ekipore e ekspeditive ka dhënë gjithnjë rezultat. Anëtarët e trupës operative pajisen paraprakisht me blloqe fletëpagues, të verifikuar e të vulosur nga kryesia qendrore e xhamisë. Dhe, natyrisht, kjo trupë i jep llogari rregullisht qendrës.
Kështu ne patëm vepruar para 6 vjetësh në Berlin, ku trupa operative prej 32 anëtarësh me në krye imamin pat trefishuar numrin e anëtarëve të xhamisë në një afat rekord prej 6 muajsh. Kjo ishte një e arritur kolosale, të cilën xhamia s`e kishte parë 17 vjetë më parë. Veçanërisht do të theksoj faktin që unë dhe Haxhi Mejdiu (nga Radusha - themelues i parë i xhamisë në Berlin dhe kryetar për shumë vite i saj) ishim në ballë të kësaj trupe operative. Ishim në ballë të aksionit. Ne dyt nuk kemi lënë vendbanim, rrestorant, kafene, klub, shoqatë etj,. pa vizituar. Shpesh herë komunikonim me mërgimtarët tanë në një atmosferë të ngrohtë vëllazërore, i informonim për mësimet më thelbësore islame dhe u dhuronim falas literaturë fetare, njëkohësisht. Dorën në zemër, pa

kurrfarë qëllimi për t'u vetëlavdëruar, por është fakt i pamohueshëm që unë dhe Haxhi Mejdiu ishim ata që senzibilizuam besimtarët e xhamisë për të vënë xhaminë "Isa Beu" në shërbim të përkrahjes së luftës së UÇK-së në Kosovë, pikërisht në kohën kur klubi Bajram Curri u mbyll me vendim gjyqësor. Kësokohe, xhamia jonë ishte vatër e patriotizmit dhe atdhedashurisë. Kështu vepruam edhe përgjatë zhvillimit të luftimeve në Preshevë, Medvegjë e Bujanoc, si dhe në Maqedoni. Aty mblodhëm qindra mijëra euro për t'i furnizuar me pushkë e barut trimat tanë luftëtarë të ushtrive çlirimtare kombëtare.
Ta zëmë, me të përfunduarit e luftërave të fundit në atdhe, shumë kush prej nesh (veçan ata që kanë halë në sy shtëpitë e Zotit) pat menduar se do të zvogëlohet numri i anëtarëve të xhamisë. Jo, përkundrazi! Ne vetëm se e patëm trefishuar numrin e xhematit. Kjo, thjesht, meqë xhamia jonë i paraprinte çdo aktiviteti pa fije përtese. Praktikisht xhamia, kësokohe, qe shndërruar në klub – në vatër të të gjithë shqiptarëve. Kësokohe meditoja në vetëvete: "Zot, të qofshim falë, po kur lloj-lloj lëvizjesh ideologjike majtiste marksisto-leniniste e maoiste "përpiqen" të bëjnë diçka për çështjen kombëtare, përse të mos përpiqemi ne, besimtarët – LËVIZJA XHEMATORE, që në emër të Perëndisë t`i shërbejmë kauzës sonë të drejtë kombëtare!" Apo, ate që unë shpesh e theksoj: "Po kur edhe popat antikrishtë serbë me kishat e tyre obskure svetisaviane vehen në shërbim të luftës së tyre të fëlliqur e satanike (duke i bekuar masakrat e

çetnikëve mbi popullsinë duarthatë e civile shqiptare!), atëherë përse ne të mos vehemi në shërbim të luftës sonë të drejtë dhe të pastër! Ne nuk manipulojmë me shenjtëritë tona fetare, ndërsa ata manipulojnë keqas me shenjtëritë e tyre sllavo-ortodokse".
Kësisoji arritëm në mënyrë të sukseshme që nën kulmin e Shtëpisë së Perëndisë të bashkojmë të gjithë shqiptarët pa dallime krahinore e fisnore, pa dallime ideologjike e politiko-partiake, tamam sikur një LOBI.
Dhe, rezultatet e punës sonë titanike i vjelëm më pastaj, duke u anëtarësuar shumica e shqiptarëve në xhami.
Madje, këtu do theksuar edhe një fakt tjetër jashtëzakonisht interesant. Po t`u bësh një inspektim anëtarësive të xhamive të diasporës do të konstatosh një fenomen të çuditshëm. Kudo që të shkosh xhamive të diasporës, me ca përjashtime të vogla, do të vëresh se kryesisht 80/90% të anëtarëve dhe vizitorëve të tyre janë shqiptarë nga Maqedonia, 10/20% janë nga Kosova. Nga ana tjetër, kudo që të shkosh klubeve a shoqatave të ndryshme kulturo-arstistike e arsimore shqiptare do të vëresh se situata është krejt e kundërt me atë të xhamive: ka më shumë anëtarë e frekuentues nga Kosova se sa nga Maqedonia.
Kjo situatë na ka brengosur jashtëzakonisht shumë, sepse në mënyrë të përçudshme krijonte (në ca vende akoma krijon) jaze ndarjesh e krahinarizmash mes vëllezërve tanë shqiptarë (duke thumbuar njëri-tjetrin me fjalët e zakonshme përçmuese: "Ata të Maqedonisë nuk janë

patriotë...janë "torbeshë"!?"; "Ata të Kosovës janë laikë në fe...janë "llatinë"!?"). Kjo brengë, zatën, na nxiti që të punojmë palodhshëm në drejtim të zhdukjes së këtij fragmentarizmi. Dhe, pas një pune sistematike, ekipore e me një plan të përgatitur mirë, brenda një viti arritëm që në xhaminë „Isa Beu" dhe në Klubin „Bajram Curri" të Berlinit të baraspeshojmë numrin e anëtarësisë së tyre dhe shqiptarët të ndjehen mirëfilli vëllezër, pa kurrfarë ndarjesh e provincializmash. Por, mos të harrojmë, kjo nuk u arrit me shkop magjik. Ne, administratorët e xhamisë, në bashkëpunim me kryesinë e klubit ishim bashkë me masën në luftë dhe në paqe, në gëzim dhe në hidhërim, në kamje dhe në vuajtje e mjerim, thjesht në çdo aktivitet.

Do të rrëfej një shembull eklatant. Më 1997, udhëheqësit e xhamive në Gjermani me në krye qendrën tonë në Hamburg, ndërmorën një aksion për të grumbulluar mjete për Universitetin e Tetovës. Nga të gjitha qendrat fetare, ne, në Berlin, thyem rekordin me 2300 DM të grumbulluara. Në pyetjen e koordinatorit tonë, Zulhajrat ef. Fejzullahu, se si ia arritëm këtij rezultati, iu përgjigja: "Ne, në Berlin, të gjithë kemi vepruar sikur një trupë e unjësuar. Mjetet i mblodhëm në bashkëpunim të ngushtë me klubin „Bajram Curri", me fondin e Universitetit të Tetovës-nëndega e Berlinit, me klubin futbollistik „Liria", me teqen „Yjet e Ehli Bejtit", me Unionin e Studentëve Shqiptarë, me shoqatën arsimore „Dituria" etj". Në xhamitë e tyre, ndërkaq, ishte mbledhur shumë pak,

kurse në njërën fare hiç. Në pse-në e koordinatorit, imami u përgjigj me fodullëk: „Xhemati im është irituar shumë për faktin se rektori i UT-se, dr. Fadil Sulejmani, ka hyrë në xhaminë tonë e nuk është falur!?"
O Zot, thash më vete, po në ç`kahe e shpiejne popullin tonë soji i këtyre imamëve?! Po çfarë lidhjeje, pashë Zotin, ka falja apo mosfalja e një individi me ngritjen dhe mirëmbajtjen e një tempulli shkencor-arsimor?!
Mjerisht, nëpër shumë xhami anëtarët e kryesive shërbejnë si kukulla statike. Ata tregohen fund e krye pasivë dhe egocentrikë. Nuk komunikojnë dot me masën dhe pandehin se vetëm me „amin" do të „pikin" anëtarët nga qielli! Sa rëndë vetëmashtrohen! Këta mjeranë duhet të dine se kështu nuk veproi as vetë Profeti fisnik. Vetë Muhammedi a.s. personalisht i përvjeli mëngët dhe iu përvesh gjithanshmërisht punës plot 23 vjetë së bashku me shokët e tij besimdrejtë, as'habët, për të komunikuar të vërtetën qiellore ndër njerëz.
Sa irituese, o Zot, më duken fjalët e tyre të shprehura jo rrallë herë në opinion: „ Po, ç`tju bëjmë njerëzve që s`paguajnë asnjë metelik për Fe dhe xhami! Ata e dinë vetë se ku gjendet dera e xhamisë! Apo fjalët e tyre defetiste: „U kemi thënë të paguajnë, por nuk na e varin veshin dot! Aman me këta njerëz, të dalë faresh, nuk punohet!" Druaj se këta udhëheqës xhamish, duke u humbur kështu durimin, do të përsojnë fatin e profetit Junus a.s.: do të përfundojnë "në stomakun e balenës"!

Le të lexojmë me vëmendje këshillën kur`anore: "*Po ti (Muhammed), bëhu i durueshëm ndaj caktimit të Zotit tënd, e mos u bën si ai i peshkut (Junusi) në kohën kur pat thirrur (Zotin) dhe ishte i mllefosur. Sikur të mos i afrohej atij mëshirë nga Zoti i tij, do të hidhej në shkretëtirë i demoralizuar*". (El-Kalem, 48-49)

"Dhe atë (Junusin) *e kafshoi (*e gëlltiti*) peshku, zatën ai ishte që e meritoi qortimin. E sikur të mos ishte ajo që ai kishte qenë prej atyre që shumë e përmendin Zotin, ai do të mbetej në barkun e tij deri në ditën e ringjalljes*". (Es-Safaté, 142-144)

Këtyre zotërinjve „efendilerë" duhet t`u vehet në dijeni deviza për sukses ekonomik**:**

"Në rradhë të parë duhet të japim, përkatësisht të investojmë për të marrë ose vjelë rezultatet më pastaj!"

Shtrohen pyetjet e logjikshme:

Sa kemi dhënë ne për hirë të Zotit në drejtim të shtrirjes së Fesë ndër njerëz?

Sa i vizitojmë besimtarët tanë?

Sa i vizitojmë veçanërisht të sëmurët dhe të burgosurit?

Sa u vehemi në ndihmë hallexhinjve, të hendikepuarve, të varfërve dhe jetimëve?

Sa aktivitete, tribuna, kuize a kurse të ndryshme kulturo-arsimore kemi organizuar me fëmijët dhe rininë tonë?

Çfarë aktivitetesh fetare u kemi ofruar motrave tona?

A u kemi ofruar literaturë fetare gratis joanëtarëve të xhamise? A u kemi dhuruar atyre ndonjë CD a DVD me ligjerata fetare?...dhe sërë pyetjesh të tjera.

Asgjë s`ndërmarrim në këtë drejtim dhe, për më keq, ndodhë të deklarojmë zëshëm: "Jo, jo, nuk ia pastrojmë, nuk ia falim dhe nuk e varrosim sipas parimeve fetare atë mysliman të vdekur (xhenazen) që nuk e ka paguar anëtarësinë!"
Sa për digresion, për të konfirmuar këtë, do përmend një rast shumë të hidhur që pat ndodhur në Berlin, aty diku nga viti 2009, kur unë isha përkohësisht në Zvicër me punë predikimi. Dy banesa shqiptarësh morën flakë. Mjerisht disa ndërruan jetë e disa pësuan djegie të thella. Paramendoni (o Zot!), në kërkesën për të kryer liturgjitë fetare për të vdekurit, drejtuar qendrës islamike shqiptare në Berlin, disa nga kryesia e xhamisë përgjigjen negativisht: "Nuk kryejme ritet fetare (pastrimin dhe faljen e namazit kufomave), sepse ata nuk kanë qenë anëtarë të xhamisë sonë!!!" Përfundimisht ritet fetare i kryen një imam i huaj arab, me ç'rast prezent ishin plot shqiptarë dhe gjermanë.
O Zot, sa të vrazhdë e të pandjenja janë këta njerëz?! O Zot, po çfarë besimtarësh e myslimanësh janë përfaqësues të tillë xhamish, që pikë loti nuk kanë në sy e as fije ndërgjegje religjioze në shpirt!?
Në rregull, dihet fakti se tek ne xhamitë vetëfinancohen nga kontributi vullnetar i besimtarëve tanë, ndërkohë që nga qeveritë shtetërore nuk marrin asnjë metelik për Fe, por ama administratorët e xhamive nuk duhet të sillen në mënyrë të vrazhdë e me një fjalor vullgar me njerëz, sikundër nuk i ka hije fare myslimanit.

Zatën qysh si fëmijë ky soj "efendilerësh" më ngjallnin pezmin e neverinë. Çdoherë që vizitoja xhaminë më ndodhte t`i shihja të mrrolur, të vrenjtur, të krekosur dhe, si të tillë, më bënin përshtypjen sikur xhamia të qe pronë e tyre private. Të këtillët, ruana Zot, edhe fenë "ta gerditin"! Prandaj, s`është për t`u çuditur që një numër i madh i besimtarëve nuk anëtarësohen nëpër xhami (për shembull në Shkup vetëm 27% të familjeve myslimane paguajnë obligimin e anëtarësisë nëpër xhami dhe në Bashkësinë Islame). Prandaj, pason edhe ajo më tragjikja: një numër jo i vogël i myslimanëve tanë të luhatshëm kalojnë në kristianë, në jehovistë, në adventistë etj. Kjo nuk është një frazë e thënë ashtu kuturu. Kjo është një e vërtetë e hidhur me të cilën jam ndeshur vetë personalisht, si në vendlindje, ashtu edhe jashtë në diasporë.

Paramendoni, vallë si do të ndjeheshim ne po të venim në ndonjë kishë? Ç`përshtypje do të fitonim? Si do të na prisnin ata? Kuptohet, vetëm me buzëqeshje e mikëpritje të ngrohtë.

Përkundrazi, udhëheqësit e xhamive duhet t`i karakterizojë morali dhe

edukata e Profetit tonë fisnik, Muhammedit a.s.: zemërgjerësia, buzëqeshja në fytyrë, mëshira, modestia, përkorja etj. Të lexojmë me vëmendje :

*« Juve ju erdhi i dërguari nga lloji juaj, atij i vie rëndë për vuajtjet tuaja, sepse është lakmues i rrugës së drejtë për ju, është i ndijshëm dhe i mëshirshëm për besimtarët »***.**

(Tevbe, 128)
« Ti (Muhammed) ishe i butë ndaj tyre, ngase All-llahu të dhuroi mëshirë, e sikur të ishe i vrazhdë e zemërngurtë, ata do të largoheshin prej teje... ».
(Ali Imran, 159)
« Buzëqeshja yte para vëllait tënd është sadaka (akt bamirësie) »
(Sunen ut-Tirmidhi)
Mbi të gjitha, administratorët fetarë duhet fillimisht të diagnostifikojnë "sëmundjen" që mbretëron në mesin e myslimanëve tanë. Kjo, do të thosha, është primare. Cila është ajo "sëmundje" që i shtyn myslimanët tanë të mos anëtarësohen nëpër xhami dhe të mos i vizitojnë të njëjtat? Përgjigjja kuptohet: imani i dobët i tyre dhe "gafleti" (gjumi, indolenca, amullia, pasiviteti) fetar. Do të thotë ne duhet në mënyrë të organizuar dhe vazhdimisht të punojmë në drejtim të zgjimit ose sforcimit të imanit të tyre. Dhe, tek më pastaj, IMANI është ajo fuqia motorike që vëndon në lëvizje individët myslimanë, që i zgjon nga gjumi dhe pasiviteti i skajshëm fetar dhe i bën subjektë aktivë në bashkësinë myslimane.
Mos të harrojmë kurrë lekcionin krahasues të logjikës predikuese në mes të profetit Ibrahim a.s. dhe Muhammedit a.s., (të cilin po e përsëris këtu) që është shumë aktual për rrethanat tona: Ibrahimi a.s. përdori metodën revolucionare në predikimin e fesë ndër njerëz. Nëpërmjet të shpartallimit brenda nate të hyjnive e idhujve të rrejshëm në tempull, ai vetëm që ngjalli ca më

shumë pezmin dhe neverinë e idhujtarëve të kohës së tij, duke e futur atë në turmën e zjarrit. Ndërkaq, profeti Muhammed a.s., në anën tjetër, përdori metodën evolutive të të predikuarit duke i shpënë njerëzit në atë stad, në atë shkallë vetëbindjeje që ata vetë, me duart e tyre, pas 23 vjetësh, do të shkatërrojnë hyjnitë dhe idhujt e tyre, që ndër shekuj i kishin instaluar në Qabe dhe përreth saj. Dhe, rrjedhjimisht ata, me vetëdëshirë, grupe-grupe do të futen në fenë e drejtë – në Islam.

Në xhami duhet të ketë atmosferë të gjallë dhe atraktive

Në xhami krahas vendeve për shërbesa e ibadete fetare duhet pasur edhe vende të tjera separat për aktivitete shkencore e arsimore, për aktivitete të larmishme sportive e për lojëra të ndryshme, kabinete kompjuterësh dhe bibliotekë sa më të pasur në mënyrë që të tërheqim sa më shumë të rinjë dhe intelektualë në xhami, në mënyrë që të shtojmë numrin e anëtarëve në xhami. Po të kemi tërhequr një intelektual në xhami ne, në fakt, kemi tërhequr pas tij dhe dhjetëra të tjerë. Kjo vetëkuptohet, sepse intelektuali është në gjendje që nëpërmjet të diapazonit dhe diskursit të tij të pasur shkencor e filozofik të bindë edhe shumë individë të tjerë. Vallë, a nuk iu lut Zotit vetë Profeti ynë që të pranojë fenë njëri nga dy fisnikët, inteligjentët e dinjitarët mekas, Ebu Xhehli apo Omeri r.a.? E, Zoti ia pranoi lutjen me kalimin

në Islam të Omerit r.a., i cili më pastaj do të japë kontributin kolosal për Fenë tonë. Vallë, a nuk kishte Profeti rreth vetes poliglotë (që dinin shumë gjuhë të huaja), korrespondentë të shumtë, të cilët i shfrytëzonte për t`i ftuar në fe mbretërit e asokohshëm? Vallë s`e kishte rreth vetes arkitektin brilant, Selmani Farisiun, i cili hartonte planet strategjike për luftë? Vallë nuk kishte rreth vetes komandantë brilantë të tipit të Halid bin Velidit e komandantë dhe dijetarë të shkëlqyer të tipit të Aliut r.a.? Vallë, madje, nuk kishte rreth vetes këshilltarë e biznesmenë të tipit të Ebu Bekir Siddikut? E shumë e shumë të tjerë specialistë fushash të ndryshme.

Për të pasur sukses në këtë drejtim, ti, si anëtar i kryesisë së xhamisë apo si imam, ta zëmë, postojau nga një letër intelektualëve të rrethit tënd ku do t`i ftosh në mënyrë solemne në ndonjë tribunë debative a tryezë të rrumbullakët për të rrahur ndonjë temë aktuale fetare, shkencore a filozofike? Këtë letër postojau edhe kryesive të shoqatave e klubeve, zyrtarëve të ambasadave a konsullatave vendase, korrespondentëve të gazetave a mediave ekzistuese elektronike. Në ndërkohë merr edhe ti pjesë aktive në të tilla aktivitetesh çdoherë kur të jesh ftuar nga të tjerët. Do të thotë, krijo sa më shumë lidhje miqësore me intelektualë profilesh të ndryshme dhe përfaqësues asociacionesh të ndryshme. Vetëm në këso mënyrash mund të shpresojmë në rezultate praktike. Kurse ti, imam i nderuar, përpiqu që të premteve, në predikimet tuaja (në hytbe), të jesh sa më aktual, bindës, i

rrjedhshëm dhe konciz. Vetëm kështu mund të përvetësosh zemrat e njerëzve në Fe e xhami. Herë-herë, madje, dil nga „petku klerikalesk" jashtë në masë, zbrit poshtë tek të rinjtë dhe njerëzit hallexhinj, solidarizohu me ta dhe ofroju ndihmë, shpresë e ngushëllim. Kryej falas shërbimet fetare për varfënjakët dhe jetimët. Pra, thjesht, dil nga soji i hoxhallarëve „xhenazexhi" e „bakllavamenë", që për aktivitete fetare njohin vetëm „mevlydet", „jasinat" dhe „qelimet". Edhe ju, efendilerë të Bashkësive Islame dhe profesorë të Medreseve e Fakulteteve të Shkecave Islame, dilni ndonjëherë nga „rrethet kabinetike", "nga kullat e fildishta", nga fotelet e buta e të nxehta në mes të xhemateve, besimtarëve, rinisë dhe masës së gjerë popullore dhe sakrifikoni më shumë për rilindjen islame.

Jo rrallë herë më ka ndodhur që shumicën e tribunave fetare e shkencore (në kohën kur kisha përgjegjësinë për të organizuar tribunat në nivel republikan në Maqedoni) t`i organizoj edhe jashtë xhamisë, në ndonjë lokal tjetër, në shkollë, në teatër apo nëpër lokale komunale. Kjo sepse kishim më tepër sukses. Tjesht, në të këtilla vende njeriu s`është i detyruar të marrë abdest apo të kryej ndonjë liturgji fetare, punë këto që vështirësojnë shumë pjesëmarrjen e ndonjë intelektuali apo të riu në xhami, të cilët s`kanë njohuritë më thelbësore islame. Ata thjesht u përtojnë këtyre punëve. Tribuna më e sukseshme, për shembull, na doli ajo që patëm organizuar (në kuadër të Bashkësisë Islame të Maqedonisë) në sallën e Teatrit të

Kombësive në Shkup më 1996, në temën: „Aktualiteti i Fesë Islame në rrjedhat bashkëkohore". Ligjërues: shkencëtarë profilesh të ndryshme, publiku: qindra pjesëmarrës dhe dhjetëra korrespondentë gazetash e mediumesh elektronike. Më pastaj, temat nga kjo tribunë u botuan në një libërth të veçantë në kuadër të Bashkësisë Islame.

Rezultatet në terren na kanë rrëfyer më vonë për faktin se një numër i madh i intelektualëve dhe i të rinjve janë bërë anëtarë të devotshëm e besnikë xhamish.

Sa për digresion po jap një shembull të thjeshtë por shumëdomethënës e instruktiv. Një xhematliut tim një ditë i thashë: „Përse ti paguan anëtarësinë e xhamisë kur dihet se vëllai yt më i madh është veçmë anëtar i kahmotshëm?" M`u përgjigj në frymën islame: „Më fal hoxhë, por kur të vdes unë nuk do të hyj në një varr me tim vëlla! Ai paguan (sadakë) për shpirtin e tij e unë për timin". Më la pa tekst. "No coment" - thash më vete.

Të merremi vesh, myslimanët elitë e paguajnë me përpikmëri, në çdo kohë dhe rrethanë shumën e përcaktuar të anëtarësisë (madje, herë-herë japin edhe më shumë). Dhe, ata këtë e bëjnë ekskluzivisht për hirë të All-llahut xh.sh., largë mendjemadhësisë a interesave të kësobotshme. Ai, pra, nuk e paguan anëtarësinë për hirë të imamit. Imamët shkojnë e vijnë, ndërrohen, kurse ai qëndron stabil në rrugën e All-llahut xh.sh. Besimi i tij është i lidhur fuqimisht për Zotin e Madhërishëm dhe vetëm Atij i përkulet në shtëpi, kudo në natyrë dhe në

shtëpitë e Zotit – në xhami. Dhe me këta myslimanë të përkryer ne nuk kemi pse të merremi. Ne duhet të merremi me ata myslimanë që kanë rënë në letargji të thellë e u është ndryshkur imani.
Do të thotë duhet të bëjmë sa më shumë „werbung" (reklamë) në favor të Fesë dhe xhamisë. Xhaminë duhet ta bëjmë në të ardhmen ELEKTRONIKE. Çdo xhami sot duhet të ketë webfaqen e vet në internet: xhamia të kompjuterizohet urgjentisht. Së këndejmi edhe dijetari me famë botërore, dr. Jusuf Kardavi shqiptoi fetvanë nëpërmes të cilës detyrohet çdo mysliman bashkëkohorë të inkuadrohet aktivisht në rrjetin e INTERNETIT.
Paj, dreqi ta marrë, pse ne të mos merremi me „werbung" të mësimeve të Fesë sonë të ndritur ndërkohë që hebrenjtë edhe me një „kikirikë" të prodhuar po t`i nxjerrin sytë me „werbung" në TV edhe atë në çastet e shfaqjes së ndonjë filmi të rëndësishëm artistik apo të ndonjë ndeshjeje të madhe sportive botërore.
Nuk do të ishte kurrfarë suksesi sikur të arrinim të krijonim një fond vetëm sa për të mbuluar shpenzimet më të domosdoshme të xhamisë. Sukses i mirëfilltë do të ishte sikur të arrinim të krijonim një fond të pasur mjetesh sa të arrinim të zhvillonim edhe aktivitete e veprimtari shtesë për zhvillim sa më në nivel e më cilësor të jetës fetare islame, si p.sh.:
- të themelojmë shtypshkronjat tona për botim librash, buletinesh e gazetash,
- të pasurojmë bibliotekat me tituj të rinj librash,

- të hapim klasa për zhvillim cilësor të procesit edukativo-arsimor islam, duke i pajisur ato me inventare sa më moderne,
- të prodhojmë CD,DVD e kaseta filmash e ligjëratash të llojllojshme,
- të hapim web-faqe tonat zyrtare,
- të themelojmë shoqata bamirëse humanitare,
- të organizojmë kurse për mësimin e kompjuterit dhe të gjuhëve të huaja

etj.

Pra, të bëjmë gjithçka që në xhami të ketë atmosferë të gjallë e atraktive. Në këtë drejtim duhet të angazhohen jo vetëm imamët, myezinët e kryesitë e xhamive, por të gjithë xhematlinjt, pa dallim.

FEMRA MUSLIMANE DHE XHAMIA

Të gjitha të dhënat historike nga koha e Pejgamberit a.s., sahabëve të tij dhe tabi'inëve, periudha këto të arta të historisë islame, rrëfejnë dokumentarisht se femra muslimane me përpikmëri dhe me përkushtim të thellë fetar i kryente obligimet e saja ndaj All-llahut të Madhërishëm, ndërkohë që i gëzonte edhe të gjitha të drejtat e saja të garantuara me dispozitat e Sheriatit islamik, edhe atë pas një durimi të gjatë të torturave e padrejtësive gjithëfarëshe nga ana e të gjitha regjimeve tiranike nga koha e xhahilijetit.

Feja islame e liroi përfundimisht femrën muslimane nga prangat e robërisë, është sjellur shkëlqyeshëm ndaj saj dhe e ngriti në pozitë të lartë duke e çmuar për qenie njerëzore, për bijë, bashkëshorte, për anëtare të familjes dhe për subjekt të barabartë me mashkullin në bashkësinë e gjerë muslimane.

E respekton për qenie njerëzore që nga momenti i proklamimit se edhe ajo është bartëse e obligimeve (mukel-lefe) njësoj sikur edhe mashkulli, se edhe ajo shpërblehet dhe dënohet sikurse ai, dhe atë se ajo përbën gjysmën e njerëzimit, ashtu që pa të, fundja, nuk mund të flitet edhe për ekzistimin e gjinisë njerëzore në tokë, gjë të cilën e konfirmon All-llahu i Madhërishëm në Kur'anin Famëlartë: ***"O ju njerëz, vërtet Ne ju krijuam juve prej një mashkulli dhe një femre... "*** (El-Huxhuratë, 13); ***"... Unë nuk ia humbë mundin asnjërit prej jush, mashkull qoftë***

apo femër. Ju jeni nga njëri tjetri... " (Ali Imran, 195)**;** ***"...Burrave ju takon hise nga ajo që fituan ata dhe grave gjithashtu ju takon hise nga ajo që fituan ato... "*** (En-Nisa, 32); ***"Nuk ka dyshim se për muslimanët e muslimanet, besimtarët e besimtaret, adhuruesit e adhurueset, të sinqertit e të sinqertat, durimtarët e durimtaret, të përvuajturit e të përvuajturat, sadakdhënësit e sadakdhënëset, agjëruesit e agjërueset, ruajtësit e nderit e ruajtëset e nderit, shumë përmendësit e All-llahut e shumë përmendëset e All-llahut, All-llahu ka përgatitur falje*** *(mëkatesh)* ***dhe shpërblim të madh ".*** (El-Ahzabë, 35).

Krahas obligimeve dhe të drejtave të shumta që i gëzon femra muslimane krah për krah me mashkullin në shoqërinë muslimane, Feja islame asaj ia dhuron edhe të drejtën e pjesëmarrjes në të kryerit e namazeve kolektive (me xhematë) në xhami.

Pesëmarrja e gruas në xhami në kohën e Pejgamberit a.s.

Të dhënat nga sunneti pejgamberik dhe nga koha e bashkëkohësve (sahabëve) të të Dërguarit të All-llahut xh.sh. flasin për pjesëmarrje të rregullt të gruas muslimane në xhami përgjatë kryerjes së namazeve të përditshme në mënyrë kolektive. Rreshtat e përparmë të xhamisë, sipas rregullave formalo-juridike të

jurisprudencës islame – fikhut, kanë qenë të burrave, ndërsa rreshtat e fundit të grave.
Në kohën e Pejgamberit a.s., gratë fillimisht kanë hyrë e kanë dalë nga e njëjta derë e xhamisë së bashku me burrat. Kësisoji është vepruar gjatë kohë përderisa një ditë, kur veçmë numri i grave sa vinte e shtohej më shumë në xhami e në mënyrë që të mos krijohej tollovi brenda saj – veçan në të hyrë e në të dalë të saj, Pejgamberi a.s., siç transmeton Ibën Umeri, u tha shokëve të tij: **"Sikur ta kishim lënë këtë derë për femrat".** Lidhur me këtë Nafiu ka thënë: "Ibën Umeri më kurrë nuk ka hyrë nga ajo derë deri në vdekje". (Transmeton Ebu Davudi). Kjo derë që gjendet në Xhaminë e Pejgamberit a.s. në Medinë edhe sot e kësaj dite quhet si "dera e grave" (babu-n-nisa).
Nga një numër jo i vogël hadithesh të Pejgamberit a.s. nënkuptojmë se ca nga shokët e të Dërguarit të All-llahut xh.sh. kanë ngurruar t'u lejojnë bashkëshorteve të tyre që të venë në xhami, nga frika se po u njolloset atyre fytyra e dinjiteti. Me të marrë vesh të kësaj, Pejgamberi a.s. u tha atyre botërisht: **"Mos ua ndaloni shërbëtoreve të Zotit** (grave) **shtëpitë e Zotit** (xhamitë)**".** (Ky është transmetim i Muslimit, ndërkaq në transmetimin e Ebu Davudit thuhet: Ebu Hurejreja transmeton se Pejgamberi a.s. ka thënë: "Mos i pengoni femrat (që të dalin) për në xhaminë e All-llahut, le të dalin por të mos u vijë era e keqe, të mos parfimosen dhe të mos zbukurohen". Madje, në transmetimin e Buhariut lidhur me këtë temë thuhet:

"Transmeton Salim b. Abdullahu, e ky nga babai i tij, se Pejgamberi a.s. kathënë:"Kur bashkëshortja e dikujt prej juve kërkon leje (për të shkuar në xhami) mos e pengoni atë").

Ndërkaq sa i përket hadithit të Pejgamberit a.s., transmetuar nga Ibën Umeri,: **"Kur gratë tuaja t'u kërkojnë leje për të shkuar natën në xhami lejoni ju !"** (Buhariu), numri më i madh i juristëve (fekihëve) mendojnë që ky hadith u referohet grave të moshuara, të cilat kanë mundur më lirshëm të venë edhe natën në xhami për të falur namazin e akshamit e të jacisë, apo në orët e hershme të mëngjesit, akoma pa gdhirë dita, për të falur namazin e sabahut. Kohë këto që, në fakt, nuk u preferohen grave dhe vajzave të reja, të cilat duhet të kujdesen shumë për ruajtjen e moralit, nderit dhe fytyrës.

Në kohën e Pejgamberit a.s. gratë i vizitonin shtëpitë e All-llahut xh.sh. dhe merrnin pjesë në mënyrë dinjitoze në të falurit e namazeve me xhemat në to, ndërkohë që ruanin me devocion dhe fanatizëm fytyrën dhe dinjitetin vetanak, nderin e burrave dhe familjeve të tyre, si dhe, njëkohësisht, kryenin në mënyrë shembullore detyrat shtëpiake si amvise dhe nëna në familje.

Për pjesëmarrjen në mënyrë dinjitoze të tyre në xhami flasin shembuj të shumtë nga koha e Pejgamberit a.s. Shi për këtë më së miri na rrëfen bashkëshortja e Pejgamberit a.s., Ummi Selemeja: **"Në kohën e Pejgamberit a.s. gratë kur jepnin selamin e namazit të detyrueshëm, ngriheshin, e Pejgamberi a.s. dhe ata që kanë falur me**

te, qëndronin (në vendet e tyre) aq sa të donte All-llahu xh.sh. Kur ngrihej Pejgamberi a.s., ngriheshin edhe njerëzit". Në vazhdim Ummi Selemeja thotë: **"Mendojmë, e All-llahu e dinë më së miri, se atë e ka bërë që gratë të dilnin më parë, për të mos i arritur meshkujt"** (Buhariu). Në këtë kontekst, edhe nëna e besimtarëve, Aishja r.a. thotë: **"Pejgamberi a.s. e falte namazin e sabahut dhe gratë kthehesh (nëpër shtëpi) të mbështjella me shallat (çarçafet) e tyre e që për shkak të errësirës nuk kanë mundur të njihen"**. (Buhariu).

Çdo herë kur lidhej në namaz në cilësinë e imamit, Pejgamberin a.s. e kaplonte ndjesi e madhe sa po i vetëtinte në kokë fakti se prapa tij, në safët e fundit, janë radhitur edhe motrat muslimane. Ai (paqja dhe mëshira e All-llahut qofshin mbi te) më së miri dinte për rolin jashtëzakonisht të rëndësishëm që ka gruaja në familje si bashkëshorte dhe nënë, si dhe për mundimet, përpjekjet dhe punët e saja kolosale në rrafshin e rritjes, zhvillimit dhe edukimit të fëmijëve të saj. Kjo e bënte t'i dhimbseshin tejmase ato, sa që edhe në namaz, si imam që ishte, këndonte shumë pak nga Kur'ani Fisnik në mënyrë që zgjatja e tij të mos dëmtonte ndonjërën prej tyre. Në këtë kontekst, siç transmeton Abdullah b. Ebi Katade el-Ensariu, e ky nga babai i tij, Pejgamberi a.s. thoshte: **"E kam filluar namazin me qëllim që ta zgjas të kënduarit e Kur'anit në të. Pastaj kam dëgjuar të qarit e fëmijës dhe e kam shkurtuar këndimin në të, duke mos**

dashur që me këtë t'i shkaktoj vështirsi nënës së tij". (Buhariu)

Në këtë periudhë kohore, femra muslimane nuk ka marrë pjesë në xhami thjesht vetëm sa për t'u falur me xhemat, porse ajo ndërkohë ka marrë pjesë aktivisht edhe në namazin e xhumasë ditëve të premte, si dhe në dy namazet e Bajrameve, në të cilat i përcillnin me vëmendjen më të madhe ligjëratat, këshillat, mësimet dhe hutbet e Pejgamberit a.s. dhe të sahabëve të tij, që ishin më të dalluar nga të tjerët në dijen dhe shkencat islamike. Kjo thjesht nga fakti se Feja islame ia bëri obligim të domosdoshëm femrës të kërkojë dituri në të njëjtën masë siç e obligoi edhe mashkullin. Në kohën e të Dërguarit të All-llahut xh.sh. gratë merrnin pjesë aktivisht në namazin e xhumasë ditëve të premte në xhami, duke përcjellur me vëmendjen më të madhe hutbet e Pejgamberit a.s. Në këtë kontekst transmetohet se njëra nga sahabet e tij me aq kujdes i ka ndjekur ligjëratat e Pejgamberit a.s. sa që një ditë e pat mësuar përmendësh kaptinën kur'anore "Kaf", të cilën e pat dëgjuar shpeshë nga minberi i tij.

Mirëpo, duke qenë se Xhamia e Resulull-llahit a.s. zakonisht ishte e mbushur përplot me meshkuj, e gratë uleshin largë në safët e fundit të saj, ato nuk mund t'i dëgjonin mirë ligjëratat e Pejgamberit a.s. Kështu që një ditë, siç transmeton Ebu Se'id el-Hudriu, ato iu ankuan Pejgamberit a.s., duke i thënë: **"Meshkujt na e kanë bërë të pamundur pjesëmarrjen** (për shkak të kallaballëkut) **në ligjëratat tua, prandaj, caktoje një ditë**

vetëm për ne" (Buhariu). E, Pejgamberi a.s., fill më pas, caktoi një ditë për ndjekje ligjëratash enkas për femrat muslimane. Ato pa kurrfarë ngurrimi a turpi e pyetnin Pejgamberin a.s. për gjithçka ishte objekt interesimi për to, thjesht për të gjitha çështjet që kishin të bënin me pozitën e femrës në Fenë islame. Në këtë kontekst, për mosngurrim në të parashtruarit e pyetjeve rreth çështjeve femërore, veçan shquheshin gratë e Ensarëve. Nëna e besimtarëve, Aishja r.a., i lavdëronte ato për këtë veti duke u thënë: **"Gra të shkëlqyeshme janë gratë Ensare, ato nuk i pengon turpi që të mësohen në fe** (besim)". (Buhariu)

Për rëndësinë e madhe që ka të përcjellurit e ligjëratave dhe të përvetësuarit e mësimeve islame nga ana e motrave tona muslimane, që paraqesin bërthamën e edukatës dhe moralit islamik në familje, flet edhe fakti tjetër eklatant se Pejgamberi a.s. u rekomandonte vajzave të reja dhe grave që të marrin pjesë në musal-la (vend ky apostafat ku falej namazi i Bajramit) për të falur namazin e Bajramit, për t'i shqiptuar tekbiret jozëshëm, për të marrë pjesë në fund në lutjen e përbashkët që do të bëhej me këtë rast, si edhe për të dëgjuar ligjëratën qendrore të Bajramit (hutben). Po kështu, madje, Pejgamberi a.s. u rekomandonte edhe grave që ishin në periudhën e ciklit menstrual, me kusht që kur të falej namazi i bajramit të tërhiqeshin anash, jasht musal-las, duke zënë kështu pozitë të përshtatshme nga ku do të përcillnin tekbiret, tesbihun, lutjet dhe ligjëratën e imamit. Kjo konform

deklaratës së Ummi Atijes r.a., e cila ka thënë: **"E kemi pas urdhër që në Bajram të dalim në musal-la, ashtu që e nxirrnim edhe vajzën nga dhoma e vashërisë, madje edhe gratë me menstruacion. Ato rrinin pas burrave, e thoshin tekbirin e asaj mase, këndonin lutje bashkërisht me ata, me shpresë për bekim të asaj dite dhe pastërtisë së asaj dite"**. (Buhariu) Ndërkaq lidhur me këtë Ibën Abbasi rrëfen: **"Kam dalë me Pejgamberin a.s. një Bajram të Ramazanit apo të Kurbanit, në musal-la. Ai e fali namazin e Bajramit e pastaj e këndoi hutben, mbajti fjalim, e mandej u foli grave, u tërhoqi vërejtjen për dënim dhe i përkujtoi për shpërblim dhe i ka urdhëruar që të japin sadakë"**. (Buhariu).

Është mjaft interesante e dhëna tjetër që flet se shumë gra i janë ankuar Pejgamberit a.s. se për mungesë të teshave të nevojshme, përkatëse, për të dalë jashtë shtëpisë, ato nuk mund të venin në mesxhid apo në musal-la. Por duke qenë se mungesa e tyre në mesxhid ishte e disfavorshme për to, Pejgamberi a.s., sikundër transmeton sahabeja Hafs b. Sirin, e këshilloi njërën prej tyre duke i thënë: **"Le ta marrë shoqja e vete dhe ta mbulojë me ferexhen e vet dhe së bashku le të prezentojë në punë të mira dhe lutje me besëdrejtët. Kështu le të veprojnë edhe individet me menstruacion, me kusht që të tërhiqen nga musal-la gjatë namazit".** (Buhariu)

Veç të tjerash, të dhënat nga kjo kohë flasin edhe për pjesëmarrjen e grave tok me burrat edhe në ibadete të

tjera fetare të karakterit kolektiv, si për shembull në rastet kur Pejgamberi a.s. me sahabët e tij tuboheshin për të falur një namaz të veçantë, me ç'rast i drejtoheshin All-llahut xh.sh. me lutjet për të rënë shi, madje edhe në rastin kur është zënë dielli (eklipsi i diellit). Për këtë më së miri na rrëfen Esma, e bija e Ebu Bekrit r.a., e cila ka thënë:

"Kam ardhur te Aisheja r.a. – bashkëshorte e Pejgamberit a.s., kur është zënë dielli, dhe aty burrat faleshin, qëndronin në kijam (në këmbë në namaz – Z.I.)**, edhe Aisheja qëndronte dhe falej"**

- Ç'është me këta njerëz? – pyeta unë.

Bëri me dorë kah qielli dhe tha: "Qoftë lartësuar All-llahu ! (Subhanall-llah !)"

- Ndonjë dukuri? – pyeta unë

- Pastaj hyra në namaz – thotë Esma – dhe vazhdova namazin derisa filloi të më mirren mendtë". (Buhariu)

Gruaja si mësuese dhe thirrëse në rrugën e All-llahut xh.sh

Me të zbatuarit me përpikmëri të ibadeteve fetare në xhami, me të marrit pjesë tok me burrat në tubimet diturore dhe në solemnitetet fetare që organizoheshin në xhami, si dhe me të dëgjuarit me afsh dhe me vëmendjen më të madhe të ligjëratave, këshillave dhe mësimeve – që mbaheshin në xhami nga i Dërguari i All-llahut xh.sh. dhe shokët e tij autoritativë e me namë në shkencat islamike, një numër i konsiderueshëm nga mesi i grave-

sahabe të Pejgamberit a.s. do të shquhen më vonë si mësuese brilante të vajzave, grave dhe burrave të ummetit islam në të gjitha lëmenjt e dijes dhe shkencës islamike. Së këndejmi, edhe prej mesit të tyre hasim një numër jo të vogël shkencëtaresh, shkrimtaresh, poetesh, hafizesh, si dhe transmetuesesh besnike të haditheve dhe sunnetit pejgamberik përgjithësisht, deri tek të cilat kanë vajtur në këmbë, nga viset edhe më të largëta, hafizët dhe muhaddithinët tjerë për të mësuar prej tyre diç nga rrafshi i shkencës së hadithit, pa kurrfarë ngushtimi a mërzie, gjë për të cilën qartazi dëshmojnë faktet historike. Një prej burimeve me rëndësi të madhe fill pas Kur'anit Famëlartë dhe Sunnetit të Muhammedit a.s., nga ku sahabët thithnin nektarin e diturisë islame, është edhe familja e Pejgamberit a.s., respektivisht bashkëshortet e tij, që konsiderohen nëna të Ummetit islam (ummehatu-l-mu'minin). Ato ishin dëshmitare të drejtpërdrejta të jetës, përkatësisht Sunnetit pejgamberik të Muhammedit a.s. në rrethin e ngushtë familjar në shtëpi. Ato thjesht dinin edhe për gjërat më intime dhe më të imëta nga jeta e tij. Kështu që pas ndërrimit jetë të Pejgamberit a.s., shtëpia e tyre do të shndërrohet në institucion të mirëfilltë arsimor, të cilin e frekuentonin shpesh herë sahabët, meshkuj dhe femra, me qëllim që të mësonin hadithe nga gratë e tij dhe t'i pyesnin ato për çdo gjë që u interesonte nga lëmenjt e numërt të dijes islame.

Gruaja më inteligjente dhe më shembullore në shkencat islamike nga mesi i tyre ka qenë bashkëshortja e

Pejgamberit a.s., nëna e muslimanëve, Hazreti Aisheja r.a. (ndërroi jetë në vitin 57 hixhri, jetoi plot 65 vjetë), e cila me pedanteri të pashoqe kreu detyrën e mësuesisë në mesin e femrave dhe meshkujve muslimanë gjatë gjithë kohës sa ishte gjallë. Duke qenë se, si bashkëshorte e Pejgamberit a.s. që ishte, ishte dëshmitare e drejtpërdrejtë e thënieve, praktikës së gjallë dhe jetës në përgjithësi të të Dërguarit të All-llahut xh.sh., ajo transmetoi më shumë se gratë tjera hadithe nga Pejgamberi a.s., gjithsej 2210 hadithe, që për nga kjo sasi, ajo zë vendin e katërt në ranglistën e transmetuesve të hadithit. Në këtë kontekst, falë mbamendjes fascinante dhe vokacionit për vlerësim kritik të gjërave, ajo u tregua kritike e rreptë kundrejt ca sahabëve kur ndodhte të transmetonin këta diç gabimisht nga hadithet apo sunneti i Pejgamberit a.s., si dhe në të tjera raste kur shfaqte dyshim lidhur me atutenticitetin e ndonjë hadithi të transmetuar jobesnikërisht. Mu për këtë, siç thekson Ibën Haxher el-Askalani, një numër i sahabëve me namë në rrafshin e shkencave islamike ndoqën me vëmendjen më të madhe lëndën e hadithit para saj.

Ajo, veç të tjerash, siç thekson Dhehebiu në veprën e tij"*Tedhkiretu-l-huffadh*", veçanërisht është dalluar edhe në lëmin e njohurive juridiko-sheriatike, për ç'gjë edhe unanimisht do të marrë epitetin "Fetvadhënëse e grave" (Mufti-n-Nisa').

Individualiteti i gruas është një parim i Fesë sonë. Gratë kanë të drejtë të plotë të shprehjes së mendimeve të tyre.

Të dhënat nga periudha e të Dërguarit të All-llahut xh.sh. flasin për shumë gra mësuese nga mesi i as'habëve të cilat shquheshin për guximin e tyre për t'i paraqitur mendimet e tyre para Pejgamberi a.s. dhe halifëve të drejtë. Në këtë rrafsh Ibën el-Xhevziu rrëfen për rastin e një gruaje të devotshme e cila nuk ka ngurruar të kritikojë publikisht në xhami njërin nga të katër halifët e drejtë lidhur me të drejtat e gruas në Fenë islame. Ja se ç'thotë ai: "Halifi Umer r.a. gjatë ligjërimit të tij në xhami u ndaloi njerëzve që të paguajnë prika (mehër) të tepruara dhe iu drejtua atyre duke thënë: "Mos i fiksoni prikat për gratë mbi 40 unca (dirhemë). Nëse ndonjëherë kjo tejkalohet, unë do ta deponoj tepricën në thesarin publik". Siç ishte duke zbritur nga minberi, një grua e devotshme u ngrit nga mesi i grave dhe tha: "Kjo nuk është e drejta jote". Umeri tha: "Pse kjo të mos jetë e drejta ime?" Ajo u përgjigj: "Për shkak se Zoti i Madhërishëm ka proklamuar në Kur'anin Famëlartë: **"Në qoftë se dëshironi të ndërroni** (ta merrni) **një grua në vend të një gruaje** (të lëshuar)**, e asaj** (të lëshuarës) **i keni pas dhënë shumë të madhe, mos merrni prej saj asnjë send. A do të merrni atë pa të drejtë e në mënyrë mizore?"** (En-Nisa, 20). Kur e dëgjoi këtë Umeri r.a. tha: "Gruaja ka të drejtë ndërsa burri (Umeri) gabon. Siç duket të gjithë njerëzit kanë mprehtësi dhe urtësi më të thellë se Umeri". Atëherë, ai u kthye në minber dhe deklaroi botërisht: "O njerëz, unë e kufizova dhënien e më tepër se 40 dirhemëve si prikë (mehër). Kushdo nga mesi juaj që

dëshiron të japë prikë aq sa dëshiron dhe kënaqet duke vepruar ashtu, le ta bëjë këtë".
Gratë muslimane asokohe, në bazë të besimit të tyre të palëkundshëm, parreshtur punuan në rrafshin e përhapjes së mësimeve islame. Shumica prej tyre, përmes bisedave, ligjëratave dhe debateve, ndihmuan jashtëzakonisht shumë në përkrahjen e kauzës së Islamit, si brenda qarqeve të veta familjare, ashtu edhe në masën e gjerë muslimane dhe jomuslimane. Madje një numër i konsiderueshëm nga mesi i tyre u flijuan në rrugën e All-llahut xh.sh., duke marrë epitetin shehide (dëshmore e Fesë). Ato, për më tepër, migruan masovikisht me burrat e tyre nga Meka në Medinë, shumë prej tyre përjetuan tortura dhe peripeci të mëdha nga armiqtë e Fesë në mbrojtje të idealeve islamike, si dhe shumë prej tyre morën pjesë në shumë luftëra që i udhëhoqi Muhammedi a.s., duke shërbyer kryesisht si infermiere dhe, në raste kritike, duke rrokur armën në luftë kundër armikut të muslimanëve.
Pra, praktikisht Feja islame gruas nuk i jep vetëm të drejta, por edhe e detyron që të bëhet subjekt aktiv dhe kreativ në xhami dhe në shoqërinë e gjerë muslimane, duke i propaguar vlerat pozitive dhe duke i luftuar të gjitha dukuritë negative në të krah për krah me mashkullin. Kjo konform versetit kur'anor: **"Besimtarët dhe besimtaret janë të dashur për njëri-tjetrin, urdhërojnë për të mirë, e ndalojnë nga e keqja, e falin namazin dhe japin zeqatin, respektojnë All-llahun dhe**

të dërguarin e Tij. Të tillët do t'i mëshirojë All-llahu. All-llahu është ngadhënjyes dhe i urtë". (Et-Tevbe, 71).
Përse gruaja sot nuk shkon në xhami?

Pas gjithë kësaj që shtruam, pas gjithë këtyre të dhënave relevante që i shtruam nga gurra burimore islame lidhur me pjesëmarrjen e gruas në spektrin e gjerë të aktiviteteve publike e shoqërore fetaro-islame, me të drejtë sot do të parashtronim këto pyetje: Përse gruaja muslimane sot tregohet aq indolente karshi aktiviteteve të gjithëmbarshme të saja socio-kulturore, arsimore e politike në shoqërinë e gjerë muslimane? Përse gruaja sot nuk participon në bashkësitë xhematore të xhamive e të qendrave të tjera simotra islamike tek ne? Përse nuk prezenton në namazet e përditshme kolektive në xhami, madje në ato javore – të xhumave si dhe në ato vjetore – të bajrameve? Madje, përse nuk kemi akoma të punësuar edhe një të vetmen femër teologe në instancat e administratave fetare tek ne, respektivisht nëpër organet e Bashkësisë Islame tek ne, qoftë në Kosovë, në Maqedoni, në Mal të Zi apo në Shqipëri?... dhe një varg pyetjesh të tjera, të cilat në momentet e pikërishme kërkojnë prej nesh, burrave muslimanë, një qasje shumë serioze, studioze dhe të gjithanshme, sepse, s'do mend, këtë, nga sa u tha dhe u kuptua më lartë, e kërkojnë prej nesh urdhëresat kur'ano-sunnetike, e kërkon prej nesh mbase edhe ajo deviza sublime e iluminizmit fetar: "Po të keni edukuar një mashkull – keni ngritur një personalitet,

ndërkaq po të keni edukuar një femër – keni ngritur një popull të tërë".
Mjerisht, të dhënat nga realiteti i përditshmërisë fetare të nënës, motrës, vajzës apo femrës sonë muslimane përgjithësisht rrëfejnë për një situatë jashtëzakonisht të mjerueshme të saj. Në kohën e sotme gruaja muslimane pothuajse tërësisht është e privuar nga jeta, feja dhe bota. Ajo sot gjendet shumë larg shtëpive të Zotit të Madhërishëm që janë rrugë udhëzuese për në Fe e në jetë. Të dhënat e deri paradokohshme nga universi i aktiviteteve të nduarnduarta fetare, qoftë në botën muslimane në përgjithësi, qoftë në botën shqiptare në veçanti, flasin dukshëm për dominancë të theksuar njëgjinore në favor të mashkullit. Nëpër shumë xhami në botë dhe në vend merrnin pjesë vetëm meshkujt. Thjesht në të gjitha aktivitetet fetare merrnin pjesë fund e krye meshkujt: në namazet e karakterit kolektiv, nëpër akademi solemne, nëpër mevlude, tribuna, në aktet solemne të kurorëzimeve (shi ironinë, o Zot, po me ç'të drejtë ore nuk merr pjesë bashkëshortja në të këtilla raste?!) si dhe në shumë e shumë ceremonish e shërbesash të tjera fetare islame. Gruaja muslimane zakonisht ndodhej larg këtyre aktiviteteve, e ngujuar midis katër mureve të shtëpisë, me çka privohej padrejtësisht nga e drejta që ajo e gëzon në saje të parimeve të legjislacionit islamik. Madje, aq më keq, skena të këtilla , ta quaj të një segregacioni fetar midis gjinive, ndodhë të na shpërfaqen aty-këtu edhe në ditët e

sotme. Dhe, për pasojë, sot një numër i konsiderueshëm i motrave tona janë të zhytura në injorancë, duke u reduktuar kështu roli i tyre deri në atë të shtëpiakes, një numër i madh prej tyre nuk posedojnë njohuritë më thelbësore për jetën, fenë dhe botën në përgjithësi, një numër i madh prej tyre kanë braktisur fare zbatimin e obligimeve të domosdoshme fetare (në veçanti faljen e namazeve të obligueshme ditore-që janë shtyllë e Fesë Islame), një numër i madh prej tyre janë të prira të absorbojnë lehtas pothuajse çdo pseudovlerë nga kulturat e proviniencave joislame, një numër i konsiderueshëm prej tyre, madje, nuk posedojnë njohuritë edhe më thelbësore lidhur me detyrat dhe obligimet e tyre që i kanë karshi burrit, fëmijëve dhe familjes në përgjithësi, detyra dhe obligime këto që burojnë nga mësimet e Fesë sonë të ndritur, si dhe një varg anomalish të tjera.

Kësokohe, izolimit të gruas muslimane nga skena publike e shoqërisë muslimane i ndihmonte një fushatë propaganduese e ca hoxhëve, aktivistëve e kryefamiljarëve konservativë fetarë, të cilët kudo dhe kurdo që u jipej rasti trumbetonin dofarë argumentesh pseudo-religjioze (sipas tyre "argumente të mirëfillta islame") me qëllim të arsyetimit të pozitës izolacioniste të saj. Sofizmat e tyre propagandistike ndodhte të shpërfaqeshin kryesisht në këto forma: "Vërtet gruaja në kohën e Pejgamberit a.s. ka marrë pjesë në spektrin e gjerë të aktiviteteve publike në shoqërinë muslimane, por ne tanimë nuk jemi në kohën e tij, kohë kjo të cilën e

karakterizonte turpi, përkorja dhe modestia. Tashmë koha ka marrë tatëpjetën, sot janë paraqitur sheshazi paturpësitë, amoraliteti, shpifjet, thashethemet dhe fitneja, ndaj vetë paraqitja e gruas në aktivitet publike fetare do të shkaktonte paraqitjen e dukurive në fjalë!" Nga imagjinata e këtyre farë alamet burrash do të pjellin kuloareve dofarë fetvashë të përçudshme (heu, fetva u thënçin!), ta zëmë të llojit: "Paraqitja e saj publike konsiderohet një formë e ekzibicionizmit të turpshëm!"; "Zëri i saj natyral (natyrisht jo ai i pispillosur, i cili në fakt ndalohet fetarisht), qoftë edhe kur këndon diç nga Kur'ani Fisnik, kur ligjëron ose kur interpreton këngë hyjnore-ilahi, në prezencë të meshkujve, konsiderohet "avret" (siç e emërtonin tradicionalisht fjalën "turp" tek ne hoxhë efendilerët)!", dhe sërë gjepurash të tjera të ngjashme me këto.

Këtu e shoh të rrugës të ndalem një fije tek një deklaratë e një gruaje të devotshme nga koha pejgamberike, e cila më pastaj është keqinterpretuar në kohë e rrethana të ndryshme nga personat e sipërtheksuar me pretekst të arsyetimit të botëkuptimeve të tyre konzervative kundruall pozitës së gruas në shoqërinë muslimane. Konkretisht bëhet fjalë për deklaratën e nënës së muslimanëve, bashkëshortes së Muhammedit a.s., Aishes r.a., transmetuar nga Amreja, të cilën e ka evidencuar me pedanteri në librin e tij hadithologu zulmëmadh, Buhariu, deklaratë kjo e thënë pas ndërrimit jetë të Pejgamberit a.s.: **"Po ta përjetonte Pejgamberi a.s. risinë**

të cilën gratë po e fusin në xhami, ai këtë (pra të vizituarit e xhamisë – Z.I.) **do t'ua ndalonte, siç u është ndaluar grave të beni israilëve"**. Aishja r.a. me deklaratën e saj ka aluduar në veshmbathjen luksoze të botës femërore të kohës së vet, kohë kjo kur faktikisht nuk është ditur për modelet e sotme ekstravagante të kreatorëve dhe për pornografinë dhe të ashtuquajturin revolucion të sotëm seksual.

Por, si do qoftë, le të shohim se ç'thotë lidhur me këtë deklaratë muxhtehidi më në zë i kohës, dr. Jusuf Kardavi në veprën e tij "E drejta islame": "Është e mundur që këto fjalë të kenë pasur për qëllim vetëm dënimin energjik të paraqitjes së ca dukurive të pahijshme tek gratë pas ndërrimit jetë të Muhammedit a.s....Pavarësisht nga qëllimi i kësaj deklarate, ajo, në të vërtetë, është pjellë e ixhtihadit (mendimit të lirë e të pavarur – Z.I.) të Aishes r.a., të cilit i është kundërvënë Abdullah ibën Umeri. Madje kjo deklaratë shënonte fillimin e periudhës së ngurtësisë dhe ashpërsisë sukcesive ndaj të drejtave të gruas, situatë kjo e mjerueshme e cila është stërpërsëritur nëpër shekuj, ashtu që në të shumtën e vendeve islame erdhi gjer tek ndalimi i vizitimit të xhamive nga ana e grave dhe gjer tek izolimi i tyre brendapërbrenda mureve të shtëpisë, nga e cila do të dalin vetëm kur të vdesin e të venë në pushimin e amshueshëm (në varr). Një kësi burgimi i paskrupullt për gruan, nuk është i sankcionuar me vendim Kur'anor. Përkundrazi, Kur'ani fisnik masën ndëshkuese ia shqipton vetëm atyre grave që haptazi

bëjnë kurorëshkelje (zina), fill pasi të kenë dëshmuar këtë katër dëshmitarë të drejtë....E, në kohën tonë, gruaja ka dalë në skenën publike dhe ka arritur në çdo vend: në rrugë, në çarshi, në tregëti, në fabrikë, në zyrë, në kinema etj., por vetëm në xhami jo !!! "Ndalesa" e vjetër ka lënë gjurmë të atilla të cilat kanë vërë barrikadë në mes gruas dhe xhamisë".

Së këndejmi, tradita islame shënon të dhënën tjetër interesante të polemizimit në këtë temë ndërmjet Abdullah ibën Umerit dhe të birit të tij. Kur ky pohoi në prani të babait të vet se është kundër pjesëmarrjes së grave në namazet kolektive në xhami, Abdullah ibën Umeri iu përgjigj me nervozizëm: **"Si guxon të mendosh kështu kur i Dërguari i All-llahut, Muhammedi a.s. na ka porositur qartë: "Mos ua ndaloni shërbetoreve të Zotit** (grave) **shtëpitë e Zotit** (xhamitë)**!"**. Më tutje, siç marrim vesh nga të dhënat burimore, me të refuzuar të këtyre fjalëve nga i biri, Abdullahu r.a. në shenjë revolte, që i biri i tij nuk përfilli hadithin e Pejgamberit a.s., më nuk i ka folur për mot e jetë.

Në lidhje me çështjen, respektivisht dilemën që kemi në shqyrtim, në vazhdim do t'i referohem mendimeve të dijetarit të shquar bashkëkohor dr. Hasan Turabi, i cili, në veprën e tij "Pozita e gruas në Islam", në mënyrë të shkëlqyeshme deshifron hallet e vërteta të atyre dertlinjëve të cilët në emër "të idealeve të larta islame", në emër "të një shoqërie të pastër e të moralshme islame", në emër "të eliminimit të dukurive të pahijshme e të

turpshme në shtëpitë e All-llahut xh.sh." etj., synojnë të izolojnë ose të mënjanojnë gruajën nga xhamitë, qendrat e nduarta islame, nga tubimet dhe nga të gjitha aktivitetet tjera fetare.

Ja se ç'thotë ai: "Askush dhe asgjë në Fenë Islame nuk mund të qëndrojë në udhën e gruas, që kontribuon për të mirën e përgjithshme dhe që garon për arritjet fetare. Përkundrazi, ajo duhet me ngulm t'i derdhë të gjitha energjitë për ta plotësuar pjesën e saj; sepse po qe se të gjithë muslimanët do ta neglizhonin plotësimin e këtyre përgjegjësive kolektive, ajo për këtë mangësi do të përgjigjej si çdo burrë tjetër... Zotimi dhe përkushtimi i dobët i burrave ndaj fesë shkakton trajtim të padrejtë dhe armiqësor ndaj grave. Sepse, për dallim nga mashkulli, femra është krijuar dhe rritur si e butë dhe e ndieshme. Mashkulli, i pakulturuar nga feja, tenton ta shtypë atë – gjë që është e natyrshme në shumë shoqëri njerëzore. Meshkujt shpesh i mbajnë gratë të dobëta, ndërsa xhelozia, të cilën ata e ushqejnë ndaj femrave, i nxit që t'i shtojnë mjetet dhe mënyrat për t'i kufizuar dhe monopolizuar ato. Ata dëshirojnë të dominojnë mbi gjendjen dhe jetën e femrave, me qëllim që ta mbrojnë fodullëkun dhe arrogancën e vet. Xhelozia mashkullore është vetëm një aspekt i tendencave tekanjoze, ndaj të cilave vetëm të devotshmit janë imunë, dhe të cilat kanë ngulitur mitin, se gratë nga natyra vuajnë nga paaftësia e tepërt. Meshkujt e përdorin këtë fantazi si arsyetim për ti penguar gratë nga pjesëmarrja aktive në spektrin e gjërë

të jetës njerëzore dhe për t'i privuar ato nga përvoja.... Mendimi dhe praktika e muslimanëve, kohëve të fundit kanë filluar t'i keqparaqesin shumicën e mësimeve doktrinore dhe normative të mësimeve të Fesë Islame, që kanë të bëjnë me femrën. Në shoqërinë e ulët të muslimanëve, gruaja ka pak liri që të martohet me atë që dëshiron, apo të ndahet nga burri, të cilin nuk e pëlqen. E as që ka ajo të drejtë, si grua, për konsultim të plotë apo për shoqërim të këndshëm nga bashkëshorti...Të gjitha llojet e dredhive përdoren për t'ia mohuar asaj të drejtën e trashëgimisë. Në sferën e jetës publike, asaj nuk i lejohet të japë ndonjë kontribut origjinal për avansimin e kualitetit fetar të jetës. Ajo është e izoluar ashtu, me pretekst që të mund t'i përkushtohet vetëm kujdesit ndaj fëmijëve të saj dhe shërbimit ndaj burrit. Mirëpo, si ka mundësi ajo të jetë e aftë për mbikëqyrjen e çështjeve shtëpiake të familjes apo për rritjen e fëmijëve të saj në një mënyrë të kënaqshme, pa qenë edhe vetë e aftësuar përmes arsimit, edukatës së shëndoshë fetare apo eksperiencës në kulturën morale dhe funksionale të shoqërisë më të gjerë?..."

Do theksuar faktin se paraqitja e këtyre modifikuesve "të devotshëm" të normave burimore fetare, respektivisht i këtyre "efendilerëve" që mëtojnë të privojnë gruan nga participimi në bashkësinë muslimane, nga pjesëmarrja në xhematin islam etj., nuk është dukuri vetëm e ditëve të sotme apo e kohëve të mëvonshme. Raste analoge kanë ndodhur edhe në kohët e mëhershme. Si për shembull

rasti me disa sundues tejskrupulozë muslimanë të cilët patën tentuar të ndajnë burrat nga gratë gjatë kryerjes së Tavafit në haxhillëk (qarkullimit rreth Qabës). Mirëpo, dijetarët e mirëfilltë, të cilët përkrahnin me ngulm ndjekjen e praktikës pejgamberike – Sunnetit, kundërshtuan çfarëdo ndryshimi në praktikën që është kryer gjatë vetë jetës së Muhammedit a.s. Kjo ndodhi në kohën kur Muhammed bin Hishami, guvernator i Mekës, i ndaloi gratë nga kryerja e Tavafit pranë burrave. Ata-i, dijetar ky i njohur i Sunnetit pejgamberik, kundërshtoi rreptësisht: **"Si i ndalon ti ato, kur vetë gratë e Pejgamberit a.s. e kryenin Tavafin rreth Qabës pranë meshkujve?"**

Por, shikuar nga perspektiva e sotme, megjithatë, falë zgjimit të gjithëmbarshëm islamik tek një pjesë e konsiderueshme e motrave tona të reja muslimane, ka filluar shumëçka të ndryshojë në favor të pozitëssolide që gruaja e gëzon në kuadër të legjislacionit islamik. Funksionimi i kahershëm i Shkollës së Mesme Islame "Medreseja e Femrave" në Sarajevë, pastaj paralelet për femra pranë medreseve në Shkup, në Tetovë, në Prishtinë, në Gjilan, në Prizren, në Tiranë, në Shkodër e gjetiu, po madje edhe funksionimi i fakulteteve islamike në Sarajevë, në Shkup e në Prishtinë, ku paralelisht me meshkujt studjojnë edhe motrat tona, kanë dhënë dhe akoma vazhdojnë të japin një kontribut të madh në rrafshin e ngritjes së vetëdijes islamike në mesin e femrave muslimane tek ne. Daljet për herë të parë të

kuadrove të mirëfillta islame të teologeve në trojet tona, i pritën me lot në sy nga gëzimi i papërshkrueshëm nënat, motrat dhe vajzat tona. Kësisoi, xhamitë tona filluan të frekuentohen dendur edhe nga motrat tona, ku, në bashkëpunim me medresistet dhe teologet, filluan të organizojnë tubime të numërta me karakter fetar. Pas shumë vitesh, pas shumë dekadash, falë mëshirës së All-llahut të Gjithëpushtetshëm, motra jonë arriti të dalë jashta mureve të shtëpisë e të vejë me afsh, me dashuri, me devocion në shtëpinë e All-llahut duke klithur nga thellësia e shpirtit: "Edhe unë, si qenie e Zotit, kam të drejtë që bashkë me motrat e mia të madhëroj Krijuesin tim në xhami, t'i përkulem e ta falënderoj Atë nga zemra, si dhe shpirtin tim ta freskoj e moralin tim ta çelnikos me të dëgjuar të fjalëve të Tij dhe të fjalëve të të Dërguarit të Tij, Muhammedit a.s. Që kështu, e rreshtuar në safë me motrat e mia, të ndjek me përpikmëri rrugën e motrave të devotshme nga koha e Pejgamberit a.s....."
Gjithashtu, dalja në dritë e botimeve të numërta librash, broshurash e artikujsh në gjuhën shqipe me temat boshte për pozitën e gruas në Fenë Islame, hapja e rubrikës së veçantë për femrën muslimane në kuadër të gazetës informative kulturore islame "Hëna e re"-organ ky i BI në RM, dalja në dritë e revistës islamike shkencore për femra "Medina"-organ ky i shoqatës së femrave "Islami dhe Shkenca", inkuadrimi i femrës në rrjetin e internetit me faqen e veçantë "www.horizonti.com/gjerdani" (Gjerdani i Pëllumbeshës), madje organizimi i tyre në

shoqata të ndryshme, janë hapa kapitalë që, pa dyshim, paraqesin kthesë jashtëzakonisht pozitive dhe shpresëdhënëse për perspektivën e grave tona muslimane në atdhe dhe kudo në diasporë.
Detyrë mbi detyrat kemi që femrave, të cilat janë bërthama e familjes, shoqërisë dhe popullit mbarë, t'ua kthejmë merituesheëm rolin jashtëzakonisht madhështor që kishin në kohën e të Dërguarit të All-llahut dhe halifëve të drejtë, respektivisht t'i ngrisim në pozitën që ua ka përcaktuar All-llahu i Madhërishëm në legjislacionin e Tij të përkryer, në Sheriat.

P.S. *Këtë shkrim e kam përgatitur në bashkëpunim e konsultim të thellë me bashkëshorten time, Kefsere Ibrahimi-Idrizi, e cila, dorën në zemër, kreu punën më të madhe në përpilimin e këtij shkrimi. Allahu i Madhërishëm e shpërbleftë! Në këtë rrafsh na ka ndihmuar shumë dhe përvoja jonë shkrimore që bëmë me artikuj të shumtë në gazetën fetare të Bashkësisë Islame në Maqedoni "Hëna e re", Shkup, në rubrikën "Gruaja dhe familja", brenda viteve 1994-1997.*

FESTA E FLIJIMIT SUBLIM
- BAJRAMI I KURBANIT

Festa e Bajramit të Kurbanit - sinonim i paqes

Marrë nga këndvështrimi i Fesë islame institucioni i kurbanit, respektivisht flijimi i një kafshe për hirë të Zotit të Madhërishëm, është një akt sublim religjioz me relevancë shumëdimensionale. Andaj në këtë artikull këtij institucioni do t' i qasem nga disa aspekte të brendshme substanciale, duke anashkaluar me këtë rast trajtimin juridik (fikhor - sheriatik) të tij.

Kurbani gjatë historisë

Studimet krahasimtare religjioze, madje edhe Kur'ani famëlartë dhe tradita profetike e Muhammedit a.s. konfirmojnë se institucioni i kurbanit daton që nga fillet e ekzistimit të gjinisë njerëzore në tokë. Kur'ani famëlartë konfirmon në mënyrë të qartë të dhënën se ky akt i flijimit sublim për Zotin përmendej edhe në legjislaturën e njeriut të parë në tokë - profetit Adem, sikundër më vonë edhe në legjislaturën hyjnore të profetit zulmëmadh, Ibrahimit fisnik - rast ky i pashembullt në tërë historinë njerëzore. Le t'i kthehemi për një çast kësaj ngjarjeje madhore dhe le të përkujtojmë Ibrahimin, babain e të birit fisnik Ismailit, vepra e të cilëve mbeti shembëlltyrë për mbarë njerëzimin. Përkushtimi dhe devocioni i profetit Ibrahim, siç rrëfejnë librat hyjnorë,

për ta zbatuar emanetin e dhënë dhe gatishmëria e tij për të flijuar për hirë të Zotit gjënë më të shtrenjtë - të birin Ismailin, nga njëra anë, dhe vendosmëria e gatishmëria pa hezitim e Ismailit për t'u bërë kurban po për këtë hir, flet se çdo besnikëri që kultivohet në rrafshin e sinqeritetit të plotë, se çdo sakrifikim për ideale më të larta, në asnjë rast nuk do të mbetet pa u kurorëzuar me një sukses madhështor, me një fitore e cila garantohet prej vetë Fuqisë Absolute - Allahut të Madhërishëm. Natyrisht se Zoti nuk ka patur nevojë për një flijim të tillë. Ai, në fakt, deshi vetëm për një çast t'i vë në sprovë të dashurit e Tij për të provuar gatishmërinë e tyre për realizimin e premtimit që qe bërë në emër të Tij. Këtë praktikisht e dëshmon çasti kur Zoti i Mëshirshëm flijimin e Ismailit e zëvendësoi me flijimin e një kafshe për kurban, pra me një flijim që del si shpagim kundruall gatishmërisë për ta flijuar gjënë më të shtrenjtë për hirë të Perëndisë.

Nëpërmes të këtij shpagimi Zoti deshi t'ju kumtojë mesazhin profetërve të Tij, madje përmes tyre edhe mbarë njerëzimit, se në sakrifica qëndron jeta, suksesi. Zaten, historia njerëzore është përplot shembuj që flasin se asnjë sukses, sado i vogël qoftë, nuk është arritur pa sakrifikimin e vlerave të numërta njerëzore, fakt ky të cilin e vërteton edhe realiteti i djeshëm dhe i sotëm në përgjithësi dhe ai shqiptar, në veçanti.

Më pastaj, studimet shkencore nga rrafshi i besimeve krahasimtare na vënë në dijeni faktin se kurbani,

respektivisht sakrifica-flijimi ka qenë traditë e rrënjosur thellë edhe tek popujt e vjetër, si p.sh. tek asirianët, persianët, egjiptasit e vjetër, fenikasit, ilirët, grekët etj. Këtë e praktikonin edhe arabët paraisamikë politeistë, të cilët flijonin kurbanë për idhujt e tyre.

Kurbani dëshmon besimin e drejtë

Institucioni i kurbanit me theks të veçantë përmendet edhe në legjislaturën e fundit të Zotit, në Kur'anin e shenjtë - që iu shpall profetit Muhammed a.s. Kur'ani fisnik na bën me dije se flijimi i një kafshe për hirë të Zotit është detyrë rigoroze fetare (vaxhib) për pjesëtarët moshëritur të besimit islamik, të cilët gjatë tre ditëve të festës së Bajramit të kurbanit kanë pasuri të tepërt, jashtë nevojave të përditshme familjare. Në kaptinën kur'anore "el-keuther" thuhet në formë urdhërese: "Andaj, ti falu dhe prej kurban për hirë të Zotit tënd". Këtë akt sublim e praktikoi vetë profeti Muhammed a.s. me gjeneratën e parë myslimane, praktikë kjo e cila vazhdon të praktikohet edhe sot në mbarë botën myslimane, po edhe tek shqiptarët përkatës të proviniencës myslimane.
Kurbani si komponent qenësor i mësimit islamik është në funksion të konfirmimit të njësisë së një të Vetmit Zot (teuhid). Kontakti që vehet me Zotin përgjatë aktit të flijimit të kurbanit është imediat dhe pa kurrfarë elementesh politeizmi a idolatrie. Së këndejmi edhe del në pah dallimi qenësor midis flijimit islamik dhe atij

politeist. Përderisa tek besimet pagane flijimi është akt për të fituar simpatinë dhe ndihmën e zotërave të imagjinuar ose për të zbutur hidhërimin dhe dënimin e tyre, në fenë islame flijimi është akt i gatishmërisë sonë për të flijuar gjënë më të shtrenjtë dhe më të dashur për hirë të Krijuesit të botëve e në shërbim praktik të njerëzimit, përkatësisht në shërbim të shtresës së varfër. Koncepcioni islamik aktin e flijimit të kurbanit e fisnikëron dhe e lartëson nga motivet primitive e egoiste në motive altruiste, sociale e humane. Këtë më së miri e sqaron Allahu i Madhërishëm në kaptinën "el-haxhxh" të Kur'anit fisnik, verseti 37: "Tek Zoti nuk arrin as mishi as gjaku i kurbanëve tuaj, por tek Ai arrin devotshmëria juaj".

Bajrami i Kurbanit solidaritet në vepër

Bajrami i kurbanit, si festë madhore islame, është rast praktik në të cilin besimtari i vërtetë dëshmon solidaritetin, shpirtin e tij human, altruizmin, si dhe vetëdijen se flijimi në dobi të vëllezërve të tij të varfër është çelësi i shpëtimit të një kolektiviteti nga shkatërrimi, nga theqafja. Së këndejmi edhe feja islame në kuadër të legjislacionit vetanak ka vënë sërë rregullash, në mesin e tyre edhe kurbanin, që në mënyrë sa më efikase të çrrënjos varfërinë, mjerimin. Pra, Bajrami i kurbanit është festë ku ndjenja kolektive e mbizotëron ate individuale e egocentrike. Nga këtu dhe rezulton ajo

dispozita konkrete juridike fetare që pjesën më të madhe të mishit të kurbanëve ta ndajmë për jetimët, varfënjakët dhe fqinjët tanë, pa dallime regjionale a konfesionale. Kur them pa dallime konfesionale (fetare), këtu kam për qëllim ato vise shqiptare ku popullsia është heterogjene për nga struktura fetare. Kështu që përkitazi me kurbanin dispozita juridike islame kërkon nga shqiptari mysliman që në radhë të parë një pjesë të mishit të kurbanit t'ia ndajë të vëllait të vet të besimit krishter. Historia islame na mëson se vetë profeti Muhammed a.s. ka ndarë pjesë nga mishi i kurbanëve për fqinjt e tij hebre e të krishterë.

Më shumë se kurdoherë sot ndjehet nevojë e madhe për ndihmë familjeve të numërta shqiptare, që gjenden në zgripc të ekzistencës, të cilët kurrsesi nuk munden të shijojnë bukuritë e atmosferës festive të Bajramit. Veçmas janë tragjike rastet me fëmijët e këtyre qindra mijëra familjeve, të cilët pa pikë gëzimi në fytyrë, të uritur e me rroba të leckosura i presin këto ditë festive. Shto këtu dhe mijëra familje me fëmijë jetimë e invalidë të luftës kudo trojeve shqiptare. Të mos harrojmë, të mos heqim kurrë nga mendja faktin për mëkatin e madh që bën ai person i pasur i cili nuk ndan asnjë metelik, i cili nuk shtrin dorën e solidaritetit për jetimët, varfënjakët, familjet e dëshmorëve e invalidët e luftës, sikundër thoshte dhe vetë profeti Muhammed a.s. "Nuk është mysliman i vërtetë ai që fle barkun ngopur e nuk merakoset fare për fqiun e vet që po vdes urie!"

Kurbani dënon aktet kabiljane të vëllavrasjes shqiptare

Ndër mesazhet fundamentale të kurbanit, krahas të mësipërtheksuarave, është edhe mesazhi i PAQES, që implikohet në vetë aktin e flijimit të kafshës së paraparë për hirë të Zotit. Këtë më së miri e konfirmon rrëfimi kur'anor përkitazi me rastin e dy bijve të profetit Adem: Kabilit tiran dhe Habilit paqedashës (rast ky për të cilin rrëfen edhe Bibla). Sikundër na rrëfejnë librat hyjnorë, urdhëri i Zotit asokohe ishte që fëmijët bineqë të profetit Adem (djem e vajza) të martohen më largë, në mënyrë që djali të mos marrë për grua të motrën e vet binjake. Mirëpo, fill pas kësaj urdhërese lindi mosmarrëveshja midis vëllezërve të sipërpërmendur. Shkaktar i konfliktit ishte Kabili kryeneç, i cili dëshironte të merrte për grua të motrën e vet binjake, për arsye se ishte më e bukur, ndërkohë që kjo binte ndesh më urdhëresën hyjnore, sepse ajo ligjërisht i takonte Habilit. Në këtë konflikt, sipas rekomandimit hyjnor, ndërmjetësoi i ati i tyre, Ademi, i cili në shenjë kompromisi i porositi që të dy të therrin nga një kurbabn, me motivin që kurbani i atij që do pranohej nga Zoti do ta merrte për grua ate më të bukurën. Me tu pranuar tek Zoti kurbani i Habilit, kuptohet i të drejtit, Kabili shfaqi arrogancën e tij dhe e mbyti të vëllain e vet.

Çka nënkuptojme nga ky rrëfim?

Këtu na bëhet e qartë se kurbani, në këtë rast si mjet kompromisi, ka lozur rolin e paqevënësit, rendit dhe

vëllazërisë, përkatësisht rolin e parandaluesit të gjakëderdhjes, luftës. Me po këtë rol, sikundër sqaruam në fillim, kurbani do të na paraqitet edhe në rastin e profetit Ibrahim dhe të birit të tij, Ismailit. Interesant është për tu theksuar, madje, se me po të njëjtin rol na paraqitet dhe në rastin kur gjyshi i profetit Muhammed Abdulmutal-libi deshi të flijojë të birin e tij Abdullahun (babain e Muhamedit a.s.), rast ky i cili u zëvendësua me flijimin e njëqind kurbanëve.

Tani logjikisht pason pyetja: Vallë, ky mesazh i kurbanit për dominim të PAQES në botë a nuk është aktual edhe sot në tërë këtë galimatias të botës moderne, përplot antagonizmash e paradoksesh? A s'është aktual sot kur përmes aktesh gjenocidale, kulturocidale, luftërave zhduken vlera kapitale: njerëz, popuj, kultura e qytetërime të tëra?

Jorastësisht Zoti nëpërmes të institucionit të kurbanit deshi t'i vë në dijeni njeriut, e do të thosha, veçanërisht organizmave ndërkombëtarë, kriminelëve, terroristëve, shpirtzinjëve me maska të zeza, katilëve të të gjitha nacioneve e kulturave, po mbase edhe të gjithë pjesëtarëve të sekteve satanike në botë që për qëllime të mendermethënshme djallëzore flijonë njeriun - apelin:

"NE URDHËRUAM KAFSHA
TË FLIJOHET E JO NJERIU TË MBYTET!"

P.S. *Ky artikull më është botuar në gazetën "Bota sot" (botimi në diasporë), në gazetën "Fakti" dhe në "Koha ditore".*

Letër motrës sime Besarta Hodaj
- e sëmurë nga leukemia

BESARTA, MOTRUSHE JONA E NDERUAR!

Dorën në zemër, tashmë je shndërruar në një ikonë gjithëshqiptare. Tashmë je bërë ikonë, që me figurën, personalitetin dhe veprimtarinë tënde të begatë kulturore, arsimore, etike e artistike-folklorike, ndonëse në një moshë fare të re, që sapo ke mbushur të nëntëmbëdhjetat, ke pushtuar zemrat e miliona shqiptarëve të Berlinit me rrethinë dhe të botës mbarë. Sëmundja jote e ***leukemisë***, që të plandosi në krevat spitali, tronditi thellë jo vetëm prindërit e tu, motrat, vëllezërit, farefisin e ngushtë e të gjerë, bashkënxënëset e bashkënxënësit dhe të gjithë mësimëdhënësit e gjimnazit Ernst-Reuter-Oberschule në Berlin, por kjo sëmundje e rëndë tronditi thellë dhe të gjithë shqiptarët pa dallim dhe anekënd rruzullit tokësor. Emri yt Besarta, motrushja ime e dashur, pushtoi imagjinatat e të gjithë shqiptarëve. Si kudo - nëpër shtëpi, shkolla, klube e shoqata, xhami, teqe, kisha e manastire, kafene, gjelltore e restorante, kuloareve, ashtu edhe në shtëpinë time, emri yt Besarta u lakua shpesh herë dhe për çdo ditë me një ndjesi të veçantë: e përzjerë me respekt, admirim të thellë, dhimbje, gjëmë e ngashërim (vaj). Në imagjinatën time

fitoja përshtypjen sikur tanimë ti dhe vetëm ti ekziston, frymon e gjallëron në këtë planet. Madje, për më tepër, sëmundja jote pushtoi rrufeshëm dhe qindra mijëra zemra të njerëzve të proveniencave të tjera nacionale, kulturore e religjioze. Emri yt pushtoi të gjitha mediumet tona elektronike dhe të shkruara, si dhe dhjetëra web-faqe (web-seite) shqiptare dhe të huaja. Kudo në Berlin janë ngjitur pllakatat me mbishkrimin aksional "Hilfe für Besarta, Schülerin an Leukämi erkrankt" (Ndihmë për Besartën, nxënësen e sëmurë nga Leukemia).

Po po, s'ka dyshim se fenomeni i të mbeturit gjallë, se fenomeni i të ngelurit në jetë të qenies sate engjëllore, Besarta, motrushe, tashmë është shndërruar në devizën, respektivisht në LUTJEN më sublimereligjioze e njerëzore në çdo familje e shtëpi shqiptare dhe më gjerë. Dhe, pikërisht kjo fenomenologji e jotja të kualifikon edhe si engjëlleshë gjithëshqiptare edhe gjithënjerëzore e planetare, njëkohësisht.

Të gjithë jemi ngritur në këmbë, thjesht i gjithë Komuniteti Shqiptar i Berlinit me rrethinë për të të dhuruar të gjitha ndihmat e nevojshme për shërimin Tënd sa më të shpejtë dhe për kthim në gjirin familjar dhe atë komunitar tonin.

MOTRUSHJA IME BESARTA!

Nga ca miq të mij të ngushtë jam informuar se ti veç talenteve të shumënumërta që posedon, je, njëkohësisht, dhe një besimtare e shkëlqyeshme dhe e devotshme në Perëndinë, në Zotin. Kjo më ngjall shpresën se do i përballoni sëmundjes me një qëndrueshmëri kulminante. Dhe ne, që të gjithë, pa dallim përkatësie religjioze a konfesionale, do i lutemi përunjësisht, përshpirtshmërisht dhe me një devocion të thellë Zotit të Madhërishëm së bashku me Ty Besarta, që sa më shpejtë të kthehesh edhe më e fortë, edhe më e shëndetshme në gjirin e ngushtë familjarë, mes shoqeve dhe shokëve të shkollës dhe lagjes sate si edhe në botën tonë të gjerë shqiptare. Dhe kuptohet, mos të harroj, do tu kthehesh dhe valleve tona me atë veshjen tradicionale kombëtare, që të kishte moj hije për mrekulli. Po, po , kismet, me izën e Zotit, do ti kthehesh dhe tërë atij mozaiku të pasur vallesh që dije me aq profesionalitet dhe tamam në nivel artistik t'i ekzekutoje si përpara auditoriumit shqiptar, ashtu edhe atij të huaj, në ç'mënyrë keni reprezantuar në mënyrë autentike vlerat tona tradiconale kombëtare. Kjo për faktin, që për një periudhë të gjatë kohore, tok me të motrën tënde ti ishe anëtare e rregullt e grupit të valleve "Shqiponjat" në Berlin.

BESARTA! MOTRUSHE JONA!

Sa bukur më tingëllon në zemër, në shpirt, ajo deviza sublime kundruall figurës sate engjëllore: **"BESARTA NË BOTË - BOTA TEK BESARTA; BESARTA ËSHTË VETË UNIVERSI NË MINIATURË (SI MIKROBOTË) - E UNIVERSI ËSHTË VETË BESARTA NË MEGATURË (SI MAKROBOTË)".**

Besarta, të lumtë motrushe! Ti vërtet je krenaria jonë kombëtare! Nxënësja më e mirë dhe shembullore në Gjimnazin e Berlinit dhe e brumosur me një edukatë të mirëfilltë kombëtare dhe njerëzore njëkohësisht. Ishalla, bën mir sa më shpejtë!
Gëzim, bac, vëlla, baba i Besartës! Ju nënë e nderuar e Besartës! Ju lumtë, për faktin që Zoti (i qofshim falë!) ju ka dhuruar një vajzë të këtillë ikonë, ENGJËLL, apo më mirë ta them metaforikisht nga prizmi religjioz, një Fatime të profetit Muhammed, një Merjem (Shën Mëri), kësaj mëmëmadheje të profetit të lavdishëm Isa. Falënderone Zotin e Madhërishëm për këtë DHURATË hyjnore dhe jini të durueshëm tamam siç Juve ju ka hije!

Besarta! Motrushe imja!

Dashtë Zoti të na shërohesh sa më shpejtë nga kjo sëmundje që të ka pllakosur sot e gjashtë muaj më parë!
Zoti të bekoftë Ty dhe familjen tënde!
Zoti i bekoftë të gjithë shqiptarët!

P.S. "Lutje-ligjëratë kjo qendrore e lexuar në koncertin e madh humanitar me moton "TË GJITHË NË LUTJE PËR BESARTËN - NJË PIKË GJAKË, NJË ZEMËR DHE NJË LUTJE ZOTIT PËR SHËNDETIN E SAJ", kushtuar Besarta Hodajt, nga Hasi i Prizrenit. Koncerti u mbajt me datën 06.07.2008 në Berlin. Mjerisht, dy javë pas koncertit, Besarta Hodaj ndërroi jetë. All-llahu Fuqiplotë e mëshiroftë me parajsë (xhennet)!

LUTJE PËR DËSHMORËT E KOMBIT

Në kaptinën "Ali Imran" Zoti i Madhërishëm thotë: "Kurrsesi të mos mendoni (e as mos thoni) se janë të vdekur ata që ranë dëshmorë në rrugën e Zotit. Përkundrazi, ata janë gjallë e të furnizuar me bollëk tek Zoti i tyre. Janë të gëzuar me ato që u dhuroi Zoti nga të mirat e Tij. Për ta s'ka frikë e as pikëllim. Ata në fakt janë të gjallë, por ju s'mund të kuptoni të qenët gjallë të tyre. Zotzi atyre kurrsesi nuk ua humb veprat (por ua shton). Dhe do t'i shpjerrë në parajsë, ku do t'i shijojnë dhuntitë e Tija të shumënumërta." (169-170)

Ndërsa, hirësia e tij, profeti Muhammed a.s. ka thënë: "Dëshmorët tek All-llahu i Madhërishëm gëzojnë gjashtë privilegje hyjnore:

1. Shpirti i tyre dëliret nga të gjitha mëkatet që me derdhjen e pikës së parë të gjakut,
2. Dëshmorët, që në çastin kur i dorëzon shpirtin fisnik Perëndisë, i përdëftohet në mënyrë imediate panorama e parajsës,
3. Do të privohet nga llogaridhënia natën e varrit, madje do të kursehet nga ndëshkimet gjithëfarëshe në jetën e varrit,
4. Do të privohet nga tmerri Ditën e Gjykimit, respektivisht Ditën e Apokalipsës (kijametit), tmerr ky të cilin na e paralajmërojnë librat e shenjtë: Zeburi, Tevrati, Inxhili dhe Kur'ani famëlartë.

5. Në botën e amshimit do të gëzojë privilegjin e të drejtës nga Zoti për të intervenuar në faljen e mëkateve të 70 anëtarëve të familjes së tij, dhe, mbi të gjitha, ajo më fundamentalja
6. Që nga çasti i rënjes së luftëtarit në altarin e lirisë, shpirti i tij drejtëpërsëdrejti futet në parajsë, i shoqëruar me shpirtërat e profetërve, evlijave, dijetarëve e njerëzve të sinqertë e të devotshëm.
Duke patur në dijeni këto të dhëna të pakontestueshme hyjnore të të Madhit Zot, i qofshim falë, dhe të librave të Tij të shenjtë, në këtë ditë kur me admirim, pietet të lartë dhe respekt të thellë përkujtojmë veprën madhore të sakrifikimit sublim të martirëve të kombit, të gjithë dëshmorëve të tjerë, në përgjithësi, të cilët ranë stoikisht e burrërisht në altarin e lirisë për t'mos vdekur kurrë, si në Kosovë dhe Kosovën Lindore, ashtu edhe në Maqedoni, i drejtohemi Zotit të Gjithëmëshirshëm përultësisht, me zemër dhe devocion të thellë:
- O Zot i Madhërishëm! Për hirë të veprës madhore të dëshmorëve të shqiptarisë, për hirë të vetëflijimit të tyre, për hirë të gjakut të derdhur të tyre në të mirë të mbarë kombit, bën që shpirtërat e tyre të prehen në parajsën Tënde!
- Zot, të qofshim falë! Shndërroi varret e tyre në kopshte të parajsës, pikërisht ashtu sikundër Ti ke konfirmuar në Kur'anin e shenjtë!
- Zot! Derdhe mëshirën Tënde të pafund mbi të gjithë dëshmorët e lirisë!

O Zot për hirë të Kur'anit të shenjtë dhe të profetëve fisnikë shndërroi vajet dhe lotët e nënave tona në gëzim, kënaqësi dhe krenari. Shtojau durimin atyre o Zot i Plotëfuqishëm!
- Zot! Zëvendësoi kufomat e të vdekurve tanë me të atyre që dëshirojnë e synojnë zhdukjen, zhbërjen tone!
- Bën o Zot që të dështojnë gjitha planet e veprat e liga të gjithë atyre personave, kolektiviteteve e shteteve që nuk ia duan të mirën kombit tonë, e dëshirojnë të na shohin të përçarë e të robëruar!
- Zot të lutemi nga zemra të ndriçosh shpirtat dhe zemrat e gjithë atyre shqiptarëve që punojnë me nderë, ndërgjegje dhe dinjitet të lartë në të mirë të ATËDHEUT dhe kauzës sonë të drejtë kombëtare, duke u zhveshur kështu nga interesat individuale, egocentrike, dhe duke çmuar interesin e përgjithshëm dhe atë kombëtar në përgjithësi, pikërisht mu ashtu sikundër vepruan dëshmorët e kombit dhe gjithë ata e ato që sakrifikuan gjithçka në të mirë të kombit e atëdheut, si materialisht, ashtu edhe fizikisht, shpirtërisht, me penë dhe luftarakisht.
- Zot bekoje flamurin shqiptar dhe bën që shkaba dykrenore të valojë për mot e jetë në gjitha tokat shqiptare!
- Përfundimisht të lutemi o Zot i Gjithëmëshirshëm me një lutje të shenjtë që dikur, në periudhën e Rilindjes Kombëtare, ta drejtonin hoxhallarë, shehlerë e priftër shqiptarë, me shpirt atdhetari:

"Për hirë të Torës dhe Biblës së shenjtë
Për hirë të Kur'anit fisnik dhe kryeengjëllit Gjibril
Falna Zot, falna atëdhenë!
Zot flamuri kuq e zi të valojë
Zot! Le të na rrojë atëdheu e kombësia
dhe e mbarë Shqipëria
aq sa të rrojë edhe gjithësia"

P.S. *Lutje këto që i pata lexuar në të gjitha tubimet komemorative-përkujtimore për dëshmorët e kombit, që i organizonim me komunitetet shqiptare të mërgatës sonë, si nëpër xhami, ashtu edhe nëpër klube e shoqata tonat, si, ta zëmë, në Berlin, në Hamburg, në Ahen (Stolberg Reinhald, Julich), në Bielefeld, në Siegen, në Cyrih (Seebach, Dietikon), në Bazel, në Bazeland (Liestal, Pratel), në Lucern, në Sant Galen etj.*

IMAMI GJITHËPOPULLOR DHE XHAMIA MBIPARTIAKE

Vendet ligjëruese të xhamisë: qyrsija dhe minberi janë altoparlant i mësimeve dhe këshillave islame. Nga ato imamët interpretojnë ligjerata në përputhshmëri me mësimet e legjislacionit (sheriatit) islam: Kur`anit famëlartë dhe Sun-netit të të dërguarit të All-llahut të Madhërishëm. Profeti Muhammed a.s. nuk ka pasur vend apostafat ku trajtonte me shokët e tij (as-habët) çështjet e nduarnduarta fetare, jetësore, shoqërore e politike. Ai këtë e bënte vetëm në xhami. Pra, xhamia në kohën e profetit ka qenë qendër e fesë dhe rezidencë e shtetit islam, njëkohësisht. Kështu xhamia ka qenë edhe në kohën e kalifëve të drejtë pas profetit. Ajo ishte qendër e aktiviteteve të ndryshme, qofshin ato politike apo jopolitike. Kështu vazhdoi së funksionuari xhamia në gjeneratat më të lavdishme të Ummetit islam dhe në shekujt e lulëzimit të tij. Dihet mirëfilli se intifada (kryengritja) e bekuar në tokën e Pejgamberëve, në Palestinë, filloi prej xhamive. Kushtrimet e saja të para jehuan prej minareve të xhamive. Së këndejmi edhe intifada myslimane, në fillimet e paraqitjes së saj, u quajt "REVOLUCIONI I XHAMIVE".

Por, më vonë, me perëndimin e civilizimit gjigant islam dhe degradimin (më në fund edhe suspendimin) e hilafetit, xhamitë do të degradohen e zhvleftësohen skajshëm duke u shndërruar në vende ku flitet, kuvendohet e meditohet vetëm për vdekjen dhe jetën e përtejme në ahiret, duke anashkaluar kështu problemet e çështjet e nduarnduarta shoqëroro-ekonomike, arsimore e socio-politike.

Imami, për nga detyra, përgjegjësia dhe roli fetar islam, duhet të jetë gjithëpopullor. Imami i kryen shërbesat fetare për të gjithë besimtarët pa dallime ideologjike, partiake e politike. Xhamia nuk guxon assesi të partizohet! Imami, ndërkaq, duhet të jetë më i informuari për situatën aktuale në vend dhe në botë përgjithësisht. Ai duhet të ketë njohuri të bollshme lidhur me politikën kombëtare edhe atë ndërkombëtare. Por, mbi të gjitha, në veprimtarinë e vet fetare dhe kombëtare, imami duhet të udhëheqë një veprimtari politike gjithëmyslimane dhe gjithëkombëtare. Në asnjë mënyrë nuk guxon të anojë në parti e tarafe gjithëfarëshe.

Paramendoni se çfarë paradoksi do të ishte sikur t`ia falnim
namazin e xhenazës apo t`ia këndonim një mevlyd një besimtari që është, ta zëmë, bashkëpartiaku ynë, e të mos ia kryejmë të njëjtat tjetrit që është anëtar apo simpatizant i një partie tjetër?!!! Ose, paramendoni se çfarë paradoksi do të ishte sikur t`i ndanim edhe shtëpitë e Zotit-xhamitë

në baza ideo-politike e partiake?!!! Kjo, fatkeqësisht, ka ndodhur nëpër disa vende, si në vendlindje, ashtu edhe në diasporë. I kanë ndarë dhe i kanë shëmtuar, si mos më keq, xhamitë në "ldk-iste", "pdk-iste", "pdsh-iste", "bdi-ste" etj.!?

Imamët njëpartiakë, shih ironinë, edhe nëpër foltoret e tyre (qyrsi e minbere) ndodhë të mbajnë ligjerata njëpartiake! Ka ndodhur që nga hytbet e tyre, të premteve (në xhuma) t`u apelojnë besimtarëve të votojnë ekskluzivisht për kandidatët e partive të tyre përgjatë zgjedhjeve parlamentare e lokale-komunale. Dhe, nga ana tjetër, me një mendjeshkurtësi të paparë, deklarojnë se "me politikë janë marrë edhe hoxhallarët tanë famëmëdhenj të periudhës së Rilindjes Kombëtare!" "Me politikë janë marrë edhe Haxhi Zeka, Imer ef. Prizreni, Vehbi Dibra, Mulla Kadri Prishtina e të tjerë" - deklarojnë ata zëshëm në opinion.

Zotërinj të nderuar efendilerë! Ata janë marrë me politikë, por politika e tyre ka qenë mbarëkombëtare e jo ideologjiko-partiake, partikulariste e provincialiste. Ata kanë qenë iluministë, fund e krye politikanë kombëtarë, prijës shoqatash atdhetare dhe komandantë të shkëlqyer lufte. Kur në një rast iu ankua Dërgut Pashai konsullit anglez në Shkup se nuk mund t`ia dalë në krye me shqiptarët, konsulli i tha: "Si more kështu kur ushtria jote është

shumëmilionëshe dhe e armatosur mirë, ndërkohë që ushtria rebele shqiptare është e vogël dhe e armatosur

dobët?" "Po - ia ktheu Pashai - por më së shumti ua kam frikën dy kokave të tyre që janë në gjendje sa çel e mëshel sytë t`i bashkojnë 30 fise shqiptare". "Kush janë ata?" - ndërhyri konsulli. "Haxhi Zeka dhe Imer Prizreni" - përfundoi me mëllef Pashai turk.

Dorën në zemër, sot kemi dhe hoxhallarë të tillë me të cilët duhet të mburremi. Kanë marrë (dhe akoma marrin) pjesë në punë e aktivitete me vlera mbarëkombëtare: në pajtime gjaqesh e hasmërish ndërvëllazërore shqiptare, në fushëbetejë kundër armiqëve, në logjistikë, në aksione për themelim e mirëmbajtje të tempujve diturorë e shkencorë, në aksione humanitare bamirëse për varfënjakët, jetimët dhe invalidët e luftës, si edhe në të gjitha rastet vendimmarrëse për kauzën tonë kombëtare.

Imami nuk guxon të marrë pjesë nëpër fushata propaganduese politiko-partiake në kohë zgjedhjesh lokale apo parlamentare. Sepse në këtë mënyrë ai zhvleftëson misionin e tij universal prej imami. Në njësitë e pastra etnike elektorale, ku kandidatët garues u përkasin partive të ndryshme shqiptare, ai nuk guxon që nëpërmjet të propagandës së tij të tregohet i njëanshëm në pikëpamje politiko-partiake. Sidomos ai nuk guxon të marrë pjesë në fushatat propagandistike të raundeve të para zgjedhore kur kandidatë konkurrues janë persona të nacionaliteteve e të partive të ndryshme, kuptohet nëpër ato zona zgjedhore ku përbërja e popullsisë është heterogjene për nga pikëpamja etnike. Kurse nëpër

raundet e dyta, kur në garë ngelin vetëm dy kandidatë: njëri shqiptar e tjetri maqedonas, serb a bullgar, atëherë imamët duhet t`i përdorin të gjitha mekanizmat, thjesht t`i shfrytëzojnë të gjitha mundësitë propaganduese që në Parlament apo në krye të Komunës të vehet kandidati ynë, pavarësisht se cilës parti ai i takon apo se cila parti e hedh në garë kandidaturën e tij.

Në këso rastesh, qyrsitë dhe minberet (hytbet) duhet të kthehen në mjete propaganduese politike në interes të kombit dhe fesë. Imamët, ndërkaq, me çallma dhe xhybe, duhet të bëhen subjektë politikë, duke marrë pjesë aktivisht nëpër fushata propaganduese dhe nëpër mitingje, si jashtë në masë, ashtu edhe në xhami, në favor të kandidatit tonë.

Në planin praktik, nëpër disa vende me shumicë shqiptare (veçanërisht në viset shqiptare në Maqedoni), falë neglizhencës, pasivitetit, zënkave donkishoteske ndërpartiake dhe sharlatanizmit tonë politik, ka ndodhur (o Zot!) të fitojnë kandidatët maqedonasë, serbë apo bullgarë!

Në të gjitha konkurrimet zgjedhore për post deputeti a prefekt

(kryetar) komune, siç dimë, hoxhallarët kanë pësuar debakël politik. Sa keqë degradoheshin këta hoxhallarë në këto zgjedhje! Ata kalonin nga stadiumi i postit ose misionit universal (gjithënjerëzor) të imamit a myderizit (profesorit) në një post a mision parcial, ideologjiko-partiak e provincialist - katundaresk! Kuptohet, një masë

e ngritur, që ka sens politik dhe kulturë universale, nuk mund të kapërdijë dot dokrrat e llojit "allahoxhesk"!
Në të gjitha rastet vendimtare për kauzën tonë kombëtare dhe fetare imamët, myezinët, mualimët dhe myderizët e medreseve e fakulteteve islamike (thjesht të gjithë) duhet të lozin rolin unifikues gjithëkombëtar, gjithëmysliman e ndërpartiak në vendet implementuese (jetësuese): nëpër XHAMITË - SHTËPI TË ZOTIT.
Dhe mos të harrojmë kurrë: Partitë, tarafet dhe lëvizjet e ndryshme ideo-politike vijnë dhe shkojnë – janë kalimtare, ndërkaq për jetë e mot, gjer në ditën e kijametit, ngelin: gjuha, Vatani (iliro-dardano-shqiptar), Feja dhe xhamitë, si shtëpi të All-llahut të Madhërishëm.

Evokim mbresash studentore

EDHE MIDIS SARAJEVËS, NË XHAMINË E FERHAT PASHËS, JEHOI GJUHA E ËMBËL SHQIPE

Aty nga fundi i vitit 1990 nga ana e studentëve shqiptarë të Fakultetit të Shkencave Islame në Sarajevë janë ndërmarrë një sërë aktivitetesh në rrafshin e ngritjes së vetëdijes fetare dhe kombëtare, si ndër studentët e teologjisë islame, ashtu edhe ndër studentët tjerë shqiptarë, që studjojnë gjithandej nëpër fakultetet e Universitetit të Sarajevës, po mbase edhe ndër vëllezërit tanë mërgimtarë, që ka kohë që kanë ardhur këtu për të siguruar kafshatën e gojës.

Aktiviteti i parë i ndërmarrë nga ne, i cili njëherësh do të jetë edhe moto e gjithë aktiviteteve të mëpastajme, qe ideja, përkatësisht nisma për gjetjen e një lokaliteti që do të na shërbente si xhami, ku, thjesht, të gjitha aktivitetet tona fetare dhe kombëtare do të manifestoheshin në gjuhën amtare. Nismëtarë për vënjen në jetë të kësaj ideje të kahmotshme, si nevojë e domosdoshme për ruajtjen dhe kultivimin e vlerave vetanake fetare, kulturore dhe kombëtare ndër shqiptarët e nënqiellit boshnjak, qenë ca studentë tanë të dalluar, të cilët fillimisht punuan parreshtur në senzibilizimin e opinionit të këtushëm

shqiptar për nevojën e ekzistimit dhe funksionimit të një faltoreje islamike për shqiptarët. Në këtë rrafsh u dalluan dy kolegët e mij, Muvehid Hebibi nga Presheva (i ndjeri - Allahu xh.sh. e mëshiroftë!) dhe Gafur Zharku, shok imi qysh nga shkolla fillore në Shkup.

Të gjithë shqiptarët e Sarajevës, pa dallim: studentët (Unioni i Studentëve Shqiptarë pranë US), punëtorët e krahut, gastronomët, kryesia e klubit "Bajram Curri", dega e LDK-së për BH, me seli në Sarajevë, e përkrahën njëzëri këtë nismë tonën të mbarë.
Fill më pas, ashtu tok të organizuar, do të trokasim në dyert e administratës islame në Sarajevë, përkatësisht në Muftininë e Bashkësisë Islame, ku kërkesa jonë do të hasë në mirëkuptim të ngrohtë vëllazëror tek Muftiu i saj, Haxhi Abdulgaffar Jukiq, Zoti e shpërbleftë!
Të gjithë kemi qenë të ngazëllyer, prandaj, kur mu në mes të Sarajevës, mbi Bashçarshi, atje diku me një skaj, brenda një dhome të vogël, në xhaminë e Ferhat Pashës, për herë të parë filloi të predikohet Feja jonë madhore në gjuhën e ëmbël shqipe, të flitet shqip për Krijuesin e shqiptarëve, të këtij kombi trim, fisnik e paqedashës, dhe të njerëzimit mbarë, si dhe të kuvendohet shqiptarçe për kauzën tonë të pazgjidhur kombëtare.... Gëzim ky i madh, i papërshkrueshëm!
Xhamia në fjalë do të hapet solemnisht më 09. 11. 1990 dhe ndërkohë do të bëhet vatër e aktiviteteteve të larmishme studentore, ku, krahas aplikimit të riteve të

domosdoshme fetare, do të manifestohen edhe ceremoni të nduarnduarta fakultative fetare tradicionalisht të mishëruara në kodin shpirtëror të popullit tonë. Në veçanti, brendapërbrenda saj, studentët e teologjisë do të konstituojnë "Këshillin e Studentëve Shqiptarë", i cili, në saje të statutit të vet të përpiluar, do të zotohet për zbatim me përpikmëri të detyrave vijuese:

1. Nëpërmes të xhamisë duhet të krijojmë atmosferë pune krijuese brendapërbrenda nesh si studentë. Vend ky ku ne, duke u unifikuar në një simbiozë të fuqishme fetare dhe kombëtare, do të thenim barrierat morbide të provincializmit, individualizmit e të snobizmit, vrragë këto që në vend të unitetit e miqësisë mes nesh po mbjellin, mjerisht, farën e ndasive e të armiqësisë. Me këtë rast nuk guxojmë të lejojmë dot që mes nesh të shkëmbehen etiketat diferencuese në ato trajtat veçmë të njohura primitive: "ata të medresesë së Prishtinës" e "këta të medresesë së Shkupit" ; "të kësaj" apo "të asaj krahine" ; "të këndejkufirit" apo "të andejkufirit" e dokrrash të tjera, që s'i kanë hije një muslimani e shqiptari të mirëfilltë, e aq më pak një teologu të ardhshëm musliman.

2. Nëpërmes të xhamisë të krijojmë marrëdhënie të ngushta pune me afro 35.000 shqiptarë (statistikë kjo e marrë nga dega e LDK për BH, me seli në Sarajevë), që gjenden me banim të përkohshëm këtu, duke iu ofruar kështu program të begatë nga proçesi edukativo-arsimor islam me qëllim të ruajtjes dhe kultivimit të vlerave të tij substanciale.

3. Në këtë shtëpi të All-llahut të Madhërishëm duhet inkuadruar edhe 250 studentët tjerë shqiptarë (këtë vit akademik shkollor nëpër fakultete të ndryshme të Universitetit të Sarajevës u regjistrua një numër i madh studentësh të Universitetit të Prishtinës nga Kosova dhe Maqedonia, kjo, kuptohet, fill pas mbylljes me dhunë nga pushteti kulturocidist serb të UP dhe të të gjitha institucioneve tjera shkollore në R. e Kosovës). Këtu duhet të kihen parasysh edhe raportet e ndërsjella që do lidhur me të gjitha organizatat tona studentore nga Prishtina, Tirana dhe Shkupi.
4. Detyrë mbi detyrat kemi t'i kthejmë xhamisë sonë rolin që kishte në kohën e të Dërguarit të All-llahut të Madhërishëm, Muhammedit a.s. dhe gjeneratës së parë muslimane. Epokë kjo e artë islame në të cilën xhamia paraqiste bërthamën e qytetërimit dhe kulturës së gjithëmbarshme islamike. Pra, xhamia të na shërbejë veç të tjerash edhe si universitet, bibliotekë, parlament etj.
Ky program, të cilin e prezentova para jush, ashtu në mënyrë të përgjithësuar, paraqet vetëm një pikë në oqeanin gjigant, përkatësisht është vetëm një mikropjesë e makroprogramit gjithëmusliman që konsiston në dekolonizimin përfundimtar të "Bejtul – Mukaddesit" ose "Mesxhidi Aksasë", këtij tempulli të shenjtë autokton musliman në Jerusalem, dhe, së këndejmi, për të dominuar në botë PAQEJA UNIVERSALE HYJNORE (lexo: ISLAMI). Ky program, njëherazi, është edhe pjesë e PROGRAMIT TË MADH GJITHËSHQIPTAR që

konsiston në çlirimin e Kosovës martire dhe, mbi të gjitha, për të qenë të zotët e vetvetes në trojet që Vullneti i të Madhërishmit na i parapërcaktoi, në trojet tona etnike të së bukurës mëmë SHQIPËRI. Kjo pos që është aspiratë, është edhe rënkim, gjëmë... nga studentët shqiptarë të Fakultetit të Shkencave Islame në Sarajevë.

Zekerija Idrizi,
kryetar i KËSHILLIT TË STUDENTËVE SHQIPTARË

(Pjesë nga referati i lexuar para studentëve
në prag të vitit të ri shkollor akademik 1991)

LETËR E HAPUR KRYETARIT TË BASHKËSISË ISLAME NË MAQEDONI HAXHI SULEJMAN EF. REXHEPI

Duke qenë se edhe Ju personalisht keni ushtruar detyrën e imamit në gurbet, po Ju drejtohem me këtë letër të hapur për të qarë hallin me Ju, eminenca Juaj kryetar!
Siç e dini edhe vetë, është vështirë t'u dalësh në krye të gjitha punëve, detyrave dhe përgjegjësive që ka një imam në gurbet.
Së pari, është në pyetje shtrirja gjeografike e veprimtarisë së gjithëmbarshme të imamit nëpër qytetet e Evropës. Këtu ka hapësirë të gjerë veprimi. Nuk është sikurse tek ne në vendlindje, që për pesë minuta mund të përshkosh në këmbë terrenin veprues: t'i vizitosh xhematlinjt, si anëtarët, ashtu edhe joanëtarët e xhamisë. Këtu në Evropë ndryshon puna. Terreni veprues është mjaft i gjerë.
Së dyti, këtu në Evropë numerikisht kemi më shumë besimtarë. Aty-këtu kemi nga pesë apo dhjetë mijë besimtarë. Nëpër metropolet e mëdha, madje, kemi edhe nga njëzetë e pesë mijë besimtarë, si, ta zëmë, në Berlin, Hamburg, Cyrih, Bern, Gjenevë, Bruksel, Mynhen, Londër, Bazell etj. Së këndejmi edhe struktura e xhemateve është mjaft heterogjene në pikëpamje regjionale. Xhematlinjt na vijnë nga të gjitha viset shqiptare: nga Maqedonia, Kosova, Kosova Lindore

(Presheva, Bujanoci dhe Medvegja) dhe nga Shqipëria londineze.
Të gjitha aktivitetet fetare duhet t'i kryejë fund e krye, pikë për pikë dhe në kohë fikse vetëmse një nëpunës fetar: IMAMI. Do të thotë hoxha këtu është edhe imam, edhe myfti, edhe hatib, edhe mual-lim, edhe da'i (misionar feje) në terren, edhe pajtues e pleqnar gjaqesh, zënkash e hasmërish ndërvëllazërore shqiptare, herë-herë edhe imam edhe myezin njëkohësisht, edhe...edhe...deri në pafundësi.
Dhe, thjeshtë, nuk mund të qahesh fillikat vetëm në të gjitha anët dhe frontet. Thjesht duhet të bëhesh ai që s'mund të bëhesh dot: o farë alamet "terminatori" nga filmat fantastikë, o ndonjë "jashtëtokësorë" i pikur nga qielli për t'i zgjidhur me "okus-pokus" problemet në tokë. Me vetëm një imam nuk mund të ketë produktivitet dhe rezultate të mjaftueshme në xhami. Mandej, një këso praktike, për më keq, krijon ato situatat komike në xhami, ku të gjithë, si xhematlinjt ashtu edhe imamët, futen e sillen në një rreth vicioz, pa rrugëdalje. Kjo, madje, krijon edhe ato situatat tragjike kur me mosprezencën e një imami erudit, inteligjent e punëtor produktiv në një kohë namazi në xhami, dy-tre xhematlinj pleq (që janë "me njërën këmbë në tokë e tjetrën në varr", apo që s'janë "as hajri i myslimanit e as sherri i shkjaut!") krijojnë rrëmujë të madhe, deri edhe skandaloze e eksplodive në xhami. "Hoxhë duhesh detyrimisht të prezentosh në të gjitha kohët e namazit,

sepse ne të paguajmë rrogën! Përndryshe ... (hmmm!?)“ – çirren ata kështu përpara imamit (tek i dëgjoja ndonjëherë kështu, thoja vetë me vete: "Of, of! Obobo! Nëse do të ngelja në mëshirën tuaj, që moti do të kisha "vdekur për bukë!"). Paramendoni kur xhematlinj të këtillë, të pacipë, çirren e vërsulen si lakej përpara imamëve të ngratë tek ne në vendlindje, të cilët marrin rroga minimale mujore, veçanërisht në Shkup me rrethinë me rroga mesatare prej 50 ose 60 euro në muaj!

Të tëra këto situata dramatike koinçidojnë me atë sentencën e mirënjohur fetare: "Mjerë hoxha me xhematin, si dhe mjerë xhemati me hoxhën!".

O zotëri kryetar! Ju e dini se të këtillët, pa fije turpi, edhe profetit tonë fisnik, Muhammedit a.s. i çirreshin duke i thënë: "Nuk e keni ndarë drejtë plaqkën e luftës!"; një zvarranik tjetër: "O profet! Mua më keni borxh dy dërhemë!"; apo fytyra tjetër rudimentare: "Mua më keni lënduar me majën e shigjetës teksa i drejtoje rreshtat në akëcilën luftë!".

Për të këtillët imami i respektuar, Ebu Hanifeja, me të drejtë thoshte: "Më së shumti në jetë më kanë irrituar xhahilët e devotshëm dhe dijetarët ateistë!"

Pavarësisht punëve dhe aktiviteteve të larmishme që i bën imami, ata nuk janë në gjendje t’i akceptojnë e t’i vlerësojnë. Kjo, sepse ata me dekada kanë çarë kurrizin nëpër „baushtellet„ (sipërmarjet ndërtimore) e Evropës dhe mendojnë se hoxhallarët "e hanë qelepyrë" (!?), duke

ndejtur këmbëkryq përbri oxhakut të odës apo nën hije lisi! O Zot, jep mend aty ku s'ka!

Zotëri kryetar! Është vepruar me një mençuri të thellë tek ne, në vendlindje, që nëpër xhamitë qendrore të qyteteve dhe nëpër katunde të mëdha të Maqedonisë keni punësuar nga Ÿ nëpunës fetarë: imamin, myezinin, muallimin dhe hatibin. Dhe, kështu në mënyrë kolegjiale e ekipore veprohet më me sukses, si nëpër xhami, ashtu edhe jashtë në terren. Njëri kryen rregullisht faljen e pesë namazeve ditore, tjetri shkon shpejt e shpejtë në ndonjë rast vdekjeje a në ngushëllim familjar, në gazmend familjar apo në dasëm, tjetri shkon në pajtesë apo në da've me të rinjt e kështu me radhë. Në veçanti hatibi – figurë kjo qendrore intelektuale e xhamisë, duhet të angazhohet më së shumti në drejtim të senzibilizimit të opinionit të gjerë mysliman rreth kauzës sonë islame, duke mbajtur ligjërata të rregullta, duke i vizituar besimtarët, në veçanti joanëtarët e xhamisë, duke organizuar aktivitete suplementare fetare për të rinjt, duke ngjeshur mirë rradhët në mesin e myslimanëve, si edhe shumë aktivitete të tjera kruciale për progres islamik në të gjitha poret e jetës.

Tekefundit hytbet, va'zu-nasihatet, da'veja në terren, tribunat, tryezat e rrumbullakëta etj., paraqesin ajkën e veprimtarisë së një imami erudit. Për të qenë më në nivel dhe sa më cilësore, ato, s'do mend, kërkojnë hapësirë më të madhe kohore, punë dhe përkushtueshmëri të thellë shkencore e intelektuale.

Është e pamundur të jesh i sukseshëm në shumë rrafshe veprimi. Për shembull: nuk mund të jesh edhe ligjërues i përkryer edhe mual-lim i aftë e produktiv. Puna edukativo-arsimore me fëmijë grupmoshash të ndryshme kërkon nga mual-limi të ketë nerva, vullnet të madh, përvojë, dije dhe metodologji të sofistikuar pedagogjiko-didaktike. Ju e dini se, ta zëmë, në Shkup më i aftë për këtë punë është treguar mual-limi autodidakt Mensuri (i cili s'është as hoxhë e as imam xhamie) se sa dhjetëra hoxhallarë e mual-limë të tjerë profesionistë. Mensuri ka vepruar me dekada në lëmin e "ta'limit" (mësim-besimit) me talebe të të gjitha moshave e kategorive dhe, njëherësh, ka korrur sukses të madh, duke nxjerrë qindra talebe, të cilët sot e lexojnë Kur'anin famëlartë në mënyrë perfekte dhe janë imamë potencialë xhamish e xhematesh private kudo në Shkup dhe rrethinë.

Kanë përfunduar ato kohëra kur strukturat e xhemateve tona përbëheshin kryesisht nga xhematlinj analfabetë e të paarsimuar. Sot, përkundrazi, falë Zotit nëpër xhamitë tona kemi minimum xhematlinj që janë me gjimnaze a shkolla të mesme dhe, besa, edhe të atillë që kanë arsimim të lartë universitar. Dhe, kjo nënkupton faktin që hoxhallarët duhet "të nxehin" mirë karriget e tyre në shtëpi për të përgatitur ligjëratat në mënyrë që të dalin sa më të qartë e më të argumentuar në foltoret e xhamisë (nëpër qyrsi e minbere) përpara masës myslimane.

Zotëri kryetar!
Duhet doemos të keni një strategji të përpunuar mirë në seleksionimin e rreptë që duhet t'u bëni kuadrove fetare për punësim nëpër xhamitë e diasporës. Në këtë drejtim duhet të përzgjedhni imamë të shëndoshë, inteligjentë dhe me shpirt universal. Veçanërisht duhet të keni kujdes nga infiltrimi i ca hoxhallarëve dritëshkurtër dhe skajshëm konservativë. Ose, thënë më mirë, kini kujdes që të mos depërtojnë në Evropë hoxhallarë e imamë me andrralla, me shije, me kulturë dhe me folklor "turko-arabo-aziatik"! Apo të tillë hoxhallarë të cilët me trup gjenden nëpër xhamitë e diasporës, kurse me tru dhe shpirt gjenden nëpër zyrat e sheikëve "binbazianë" arabë; ose, ndryshe, flasin e predikojnë shqip, ndërkohë që ëndërrojnë, përsiasin e meditojnë "arabisht"!
Të këtillët, mjerisht, aty-këtu nëpër ca xhami të diasporës, po krijojnë një imazh të stërkequr "fundamentalist" e radikal, thënë më thuktë të llojit "binladenian", të besimtarit tonë shqiptar mysliman në sytë e nikoqirëve evropianë. Madje predikimi i tyre "fetar" është jashtëkohor e jashtëhapësinor për kushtet dhe rrethanat tona bashkëkohore.
S'di për të satën herë e kemi konfirmuar një fakt mjaft interesant, por domethënës, me disa kolegë hoxhallarë:
"Investimi i Arabisë Saudite në zhvillimin intelektual (heu intelektualë u thënçin!) të disa hoxhallarëve konservativë "binbazianë" nuk ka qenë i qëlluar, ndërkohë që investimi i Vatikanit në zhvillimin

intelektual të tipit të Dom Lush Gjergjit ka qenë i qëlluar!". Kjo, besoj, nuk do koment të tepërt!
Në pyetjen time se si qëndron puna me një zyrtar të lartë nga kreu i Bashkësisë Islame në Kosovë (produkt ky i sauditëve "binbazianë"), këshilltari i tij personal m'u përgjigj: "Është shumë i mirë dhe i jashtëzakonshëm! Ai kurrë nuk e heq dot xhyben nga trupi dhe çallmën nga koka!"
Madje, zotëri kryetar, duhet të bëni çmos që, në bashkëveprim me Bashkësitë fetare islame në Kosovë, në Kosovën Lindore dhe në Shqipëri, të keni një diasporë sa më të organizuar e sa më unike. E di se keni bërë ca përpjekje më parë në këtë rrafsh, por ama nuk duhet të ndaleni aty. Disa përpjekje që i patët ndërmarrë tok me kryetarin e Bashkësisë Islame të Kosovës për të inkorporuar universin fetar të diasporës sonë nën ombrellën e bashkësive fetare amë në atdhe, Ju patën shkuar huq. Por këtu s'ka vend për demoralizim dhe defetizëm. Përse të mos veprojmë ne në mënyrë të organizuar dhe unike kur dimë mirëfilli se fqinjët tanë sllavo-ortodoksë kanë diasporë më të organizuar dhe më unike. E dini shumë mirë se ç'veprime kolosale ka bërë dhe akoma vazhdon të bëjë, ta zëmë, diaspora maqedonase me organizatën e saj "Kongresi Botëror Maqedonas" në Australi dhe në Zenlandë të Re.
Duke i pasur parasysh këto të dhëna relevante, do bënit mirë, zotëri kryetar, sikur në bashkërendim të thellë me kryesitë e xhamive dhe të qendrave udhëheqëse fetare të

diasporës të ndërmerrnit masa adekuate në drejtim të përmirësimit dhe fuqizimit të situatës kadrovike fetare nëpër xhamitë e Evropës, nga njëra anë, dhe në drejtim të unifikimit të tyre dhe të mbarë diasporës shqiptare myslimane, nga ana tjetër. Po qe se do të krijonim një simbiozë të mirëfilltë në relacionin: Bashkësi Islame bazë në atdhe dhe bashkësitë fetare në diasporë, atëherë, vetëkuptohet, nuk do të ngelte vend për depërtimin në diasporë të miopëve "binbazianë".

Në këtë rrafsh, bëni hapat e parë konkretë duke organizuar takime të rregullta vjetore me imamët e diasporës përgjatë periudhës së pushimeve verore. Kuptohet, jo takime e ftesa mbledhjesh vetëmse në kohë fushatash parazgjedhore kur organizohen në instancat më të larta të Bashkësisë Islame. Përkundrazi! Këto takime le të jenë për jetë e mot tradicionale vjetore, ku në mënyrë të shtruar dhe vëllazërore do të qajmë hallet dhe dertet tona të përbashkëta të kauzës islame.

Dorën në zemër, Ju, zotëri kryetar, keni kredibilitetin moral, shpirtëror dhe institucional fetar për të ndërmarrë këto hapa konkretë.

Në këtë drejtim edhe unë, pa kurrfarë dileme, do të jap ndihmesën time, sikundër, siç e dini, edhe e kam dhënë në të kaluarën sa punova plot katër vjetë rresht (1993-1997) në organet e Bashkësisë Islame në Shkup.

Me nderime dhe selame të përzemërta,
I Juaji: Zekerija IDRIZI
19.04.2008

MONOLOG
PRANË VARRIT TË PRESIDENTIT RUGOVA

President i nderuar! Kombi yne, thjeshtë asnjë emër historik i tij, nuk bëri krime mbi popujt tjerë, nuk gllabëroi pjesë tokash të tjera... Asgjëkundi në analet, leksikonet a enciklopeditë e historiografisë sonë nuk figurojnë termat pezhorativë: Inkuizicion, antisemitizëm, holokaust, fashizëm, terrorizëm, fundamentalizëm etj. Kjo, thjesht, sepse që të gjitha këto akte makabrale krimi e gjenocidi u ushtruan pamëshirshëm mbi hartën e tokës dhe mbi qenien e kombit tonë, duke e katandisur kështu tokën tonë në një Shqipëri xhuxhe me pjesët tjera të saj të shpërndara nën thundrrën e racës sllavo-shkinore, kryq e tërthorë kufinjve që ia kishin vërë asaj padrejtësisht hasmit.
Përkundrazi! Kombi ynë, President, ka kredon morale dhe krenarinë kombëtare përmasash planetare që diti, sot e dy mijë vjetë më parë, t`i dhurojë botës të tillë kolosë që dhanë kontribut të çmueshëm nëhumanizimin e jetës, njeriut dhe të botës në përgjithësi. A s`i dhuroi botës moderne frymën e sotme të kosmopolitizmit, koegzistencës e të tolerancës njerëzore, qysh nga antikiteti Iliri e bardhyli tok me të shoqet e tyre Zanën dhe Teutën, kur këtu e njëmijë e pesëqind vjetë më parë, mu në brendi të ILIRISË, iu

ofruan jo vetëm konak të ngrohtë: bukë, kripë dhe zemër, por edhe e ndanë më dysh atë trohëzë tokë që kishin për t`u bërë një grimë vend, pa kurrfarë qirraje a dëmshpërblimi Stojanit e Stojadinkës, të cilët kishin mbërritur këtu, si cubë e barbarë që ishin, pa pasur ama hiçgjësendi me vete: pa bukë e ujë, pothuaj të zhveshur, të mërdhirë e të raskapitur nga gjithë ajo rrugëe gjatë dhe e stermundimshme që kishin marrë për këndej nga përtejkarpateve.

Të tillë ishin Shën Jeronimi (që i dhuroi Biblën në latinisht botës katolike perëndimore), Gjergj Kastrioti - Skënderbeu, Shën Klementi (i cili u laureua me kunorën papnore në Vatikan në vitin 1700 - me këtë fron udhëhoqi në harkun kohor 1700-1721), Onufri (që me gjenialitetin e tij prej piktori brilant freskoi, zbukuroi artistikisht dhe demistifikoi Kishat dhe Katedralet krishtere me pejsazhe pitoreske vizatimore), Mimar Sinani (kryearkitekti famëmadh që la pas vetes vepra kolosale në arqitekturë), Muhamed Isai (që ndërtoi njërën ndër shtatë veprat grandioze botërore, Taxh Mahallin në Agra të Indisë), Nënë Tereza - Gonxhe Bojaxhiu (kjo gjithëmëmë botërore katolike, e cila u laureua me çmimin Nobël), Muhammed Nasiruddin Albani (Muhaddithi më me famë në botën myslimane), akademik Ferid Murati (shkencëtar me famë botërore - Nobelist) e të tjerë.

Prandaj, i dashur President, përskaj gjithë këtyre vlerave shumëdimensionale e jashtëzakonisht relevante, e të shumë e shumë të tjerave që s`përmenda, kombi

ynë pati fatin historik të ju ketë Juve President, qëme veprimtarinë Tuaj të begatë e kolosale prej shkrimtari, esteti, filozofi, krijuesi, politikani e BURRËSHTETASI zulmëmadh u futet gjenealisht në ranglistën e burrave e kolosëve të mëdhenj, si në analet shqiptare, ashtu edhe në ato botërore.

Figura Juaj është aq poliedrike sa përbën një precedent, është, do të thoja, pa dilemë, unikate. Çdo dromcë e jetës dhe veprimtarisë suaj jetësore, që nga lindja e gjer në vdekje, përbën diçka sublime, magjepsëse, përbën, madje, një eveniment të shenjtë. Për më tepër, marrë përgjithësisht, keni qenë, jeni dhe do të mbeteni për jetë të jetëve figura më emblematike shqiptare, lider historik jo vetëm i Kosovës, por, njëkohësisht, edhe lider shpirtëror i të gjithë shqiptarëve.

President i nderuar! Ta them shkoqur, ashtu tamam shqiptarçe, hallall Ty të qofte gjiri i asaj nëne famëmadhe rugovase që të përkundi në djep, të ushqeu e të edukoi ne fëmijërinë Tuaj prej jetimi, prej djalë hasreti, edhe atë pikërisht në çastet më dramatike që përjetoi Familja Juaj, me të likuiduarit e babait Ukë dhe gjyshit Rrustë nga barbarët sllavo-çetnikë.

Çfarë koinçidence sublime!

Të qenët jetim apo bonjakëria a s`ishte vallë fat edhe i profetërve fisnikë të Perëndisë? Pyes retorikisht: A s`qenë të tillë, që në lindje, profetët më të mëdhenj të të tri religjioneve abrahamike (ibrahimike): Mojsiu (Musai), Jezui (Isai) dhe Muhamedi, të cilët, falë misionit

të tyre human e qytetërues, kaluan nga stadiumi i bonjakërisë (varfërisë, inferioritetit, anonimitetit) në stadiumin e njerëzve më prestigjiozë në botë.
Edhe Ju President, prandaj, patët një fat të këtillë. Ju lumtë! Zoti e bekoftë shpirtin Tuaj përdëllestar! Nga jetim e varfënjak u ngritët në majat e madhështisë. I brumosur me një edukatë të mirëfilltë kombëtare e njerëzore, i pajisur me një fond të pasur dituror e shkrimor, me një vizion dhe filozofi brilante politiko-diplomatike përmasash të formatit më të spikatur perëndimor – Ju, i nderuar, pushtuat zemrat e miliona shqiptarëve në Kosovë dhe gjithandej hapësirës së Gadishullit Ilirik, përfshirë këtu edhe zemrat e neve mërgimtarëve të Berlinit, Gjermanisë dhe të të katër anëve të globit.
Hmmm...! Ah, President, atë ditë ogurzezë të 21 janarit 2006, me të marrë të lajmit të kobshëm për vdekjen Tuaj, shtanga në vend i shokuar, i memecosur, pa gjak. Vetëtimthi vajtja në shtëpi ku së bashku me familjen time qajtëm me ngashërim. Qanë që të gjithë: fëmijë, gra, burra e pleq. Qau mbarë bota e qytetëruar. Klintoni, Bushi, Wiliam Wallkeri, Merkeli e burrështetas të tjerë me renome deklaruan dhimbshëm: „ U shokuam nga ky lajm i hidhur!"
Mjerisht, President, siç e keni ditur edhe vetë boll mirë, vdekja Juaj e kënaqi vetëm atë pjesën e fëlliqur e të qelbur të kombit tonë: marksistë-leninistët, enveristët e ballsamosur, maoistët, shajzexhinjt, ndaj të cilëve dikur

Mulla Idrizi i Gjilanit e shprehte dufin e tij zemërak: „ O burra, ata janë të veshur shqiptarçe, por zemrat, ore, i kanë të shkjeve!" Këtë soj shqipfolësish, ato ditë zie e pikëllimi, i shihja tek paradonin rrugëve tëkrekosur, tek zgërdhiheshin pa fije turpi, tek bënin banket duke cakërruar gotat pa fije turpi e mekati. Phu! Zoti i vraftë këta spiunë e tradhtarë të qelbosur!"

O president i nderuar, të këtillë ishin këta sojsuzë e edepsuzë, vaj për ne, edhe me vdekjen e mikut Tuaj të ngushtë, të madhërishmit Akademik Fehmi Agani. Më kujtohet fare mirë kur në tubimin komemorativ për të ndjerin, organizuar kësokohe në Klubin Bajram Curri në Berlin, këta dreqër hingëllinin e dërdëllonin zhurmshëm, zgërdhiheshin dhe i kthenin shpinën tubimit. Po të këtillë ishin madje edhe me rastin e vdekjeve tragjike të patriotëve të devotshëm: Gjeneral Ahmet Krasniqi, Gjeneral Tahir Zemaj, z. Xhemajli Mustafa, z. Enver Maloku etj. Vetëm soji i këtyre në kolaborim me elementët e UDB-së serbo-jugosllave i patën likuiduar edhe më herët në mërgatë patriotët e mëdhenj: Enver Hadrin, Jusuf e Bardhosh Gervallën dhe Kadri Zekën. Maskarenjt ditën defilonin të krekosur me plisa e flamuj kombëtar në duar, ndërkaq natën „flirtonin" me naçallnikë e sigurimsa të UDB-së nëpër Ambasadat e Legatat ushtarake të Serbo-jugosllavisë.

E falënderoj thellë Zotin, President, që të mori në prehërin e Vet, në përjetësi, e i la me gishta

në gojë këta komplotistë faqezinj, këta dreqër e të birit birit shkjaut.
Me vëmendje të thellë e përcolla çdo sekuencë të funeralit Tuaj zyrtar. Ç`të shohësh: Presidenti në botë – bota tek Presidenti; Kosova në botë – bota, kosmosi, universi në Kosovë: KOSOVA UNIVERS-BOTË NËMINIATURË. Bashkangjitja plot 24 orë në kortezh e miliona njerëzve grupmoshash të ndryshme në ato ditë të ftohta më cytën shpejt e shpejtë të bëj pastrimin ritualesk fetar dhe të kryej liturgjinë mortore duke e lutur Zotin për Ju President. Liturgji mortore u kryen pothuaj në të gjitha xhamitë dhe teqetë shqiptare, në të gjitha kishat fishtiane e noliane në vend dhe jashtë në mërgatë. Kjo sepse komplet jeta dhe veprimtaria Juaj President paraqet PROVIDENCË të Zotit në historinë dhe në tokën e Kosovës moderne. Edhe trupi Juaj i pa jetë President i bëri që të gjithë tok, pa dallim provinience politike a backroundi fetar.
Nejse, deshën të të përvetesojnë matrapazët e lajkatarët religjiozë, por përpjekjet e tyre shkuan huq përpara kredibilitetit Tuaj të lartë moral-shpirtëror.
Me plot të drejtë një mik imi teozof pati konstatuar ato ditë zie e pikëllimi:
„KOSOVË, MBI TY ËSHTË SHTRIRË DORA E ZOTIT DHE VIZIONI, FILOZOFIA E VEPRIMTARIA KOLOSALE E LIDERIT RUGOVA E TRASOI ARDHMËRINË TËNDE, KOSOVË E BEKUAR!"

Pusho i qetë në prehërin e Perëndisë, në Parajsë, President i nderuar!
Ju qoftë i lehtë dheu ILIRO-DARDANO-SHQIPTAR i KOSOVËS MARTIRE, KRYEARKITEKT i së cilës ishit pikërisht Ju i nderuari PRESIDENT.

21, janar 2007 - BERLIN
(FJALIM I IM QENDROR I MBAJTUR NË AKADEMINË PËRKUJTIMORE, NË BERLIN, ORGANIZUAR NGA KOMUNITETI SHQIPTAR NË NJËVJETORIN E VDEKJES SË PRESIDENTIT RUGOVA)

DITARI JAVOR

E enjte, 5 maj

Të mërkurën dhe dhe këtë ditë gati në çdo vend të Shkupit flitej për bisedën time që pata me z. Mihajlin – kryepeshkopin e Kishës Ortodokse Maqedonase dhe me përfaqësuesin e Kishës Katolike në programin e televizionit privat maqedonas A-1. Tema boshte ishte "Elementet e përbashkëta për bashkëjetesë ndërkonfesionale në Maqedoni". Po, pikërisht për bashkëjetesën, dukuri kjo aq e nevojshme dhe e domosdoshme për popujt ballkanikë në përgjithësi dhe për popullin heterogjenë në Maqedoni në veçanti – për të cilën zëshëm diskutohet dhe shkruhet në zhurnalistikën tonë dhe atë botërore, nëpër konferenca e seanca të ndryshme nivelesh ballkanike, evropiane dhe botërore, e veçmas në Maqedoni, e cila, sipas parashikimeve të analistëve botërorë, është fuqia më e madhe e barutit fill pas Kosovës. Por, fatkeqësisht, përpjekjet në këtë rrafsh më tepër, për të mos thënë fund e krye, janë deklarative, si në planin kombëtar, ashtu edhe në atë fetar. Shi paradoksin, atë natë në A-1 z. Mihajl, në fjalimin e tij nxirrte mjaltë prej goje, duke himnizuar bashkëjetesën dhe tolerancën ndërkonfesionale, ndërkaq në praktikë zvarrit të gjitha problemet kyç mes Kishës Ortodokse Maqedonase dhe Meshihatit të Bashkësisë Islame, që kërkojnë zgjidhje sa më urgjente. Në mënyrë tinëzare solidarizohet me veprimtarinë vandaliste të Mitropolitit

Petar dhe të fundamentalistëve të tjerë ekstremë maqedonasë, të cilët në mënyrë drakonike përdhosin monumentet kulturo-historike islame në Maqedoni. Dhe, që ironia të jetë edhe më e madhe, ata të gjitha veprimet e tyre antikulturore dhe antiqytetëruese i mbështesin në gjoja praninë e një farë "fundamentalizmi islamik" në Maqedoni !? S'di për ç'barabarësi mund të flitet në Maqedoni, shtet ky që pretendon të jetë demokratik, kur edhe në nivel kushtetutar deavanson pozitën e Bashkësisë Islame dhe të bashkësive të tjera fetare, ndërkohë që në mënyrë eksplicite avanson Kishën Ortodokse Maqedonase, duke e theksuar dy herë në nenin 19 të Kushtetutës. Të dhënat mbi supremacionin e KOM-it në Maqedoni s'kanë fund, por ama një gjë është më se e sigurtë: ky shtet s'ka si të mos pranojë këtë fakt: "BASHKËJETESË, PAQË, MARRËDHËNIE TË MIRA RECIPROKE NDËRKONFESIONALE PO, POR, JU LUTEM, NGA POZITA TË BARABARTA!".
Këtë natë në kokë më sillet vërdallë ai proverbi i artë popullor me atë njeriun realist që mundohej të bindë bashkëfolësin e tij që kishte prirje për halucionacione: "Ja ku është ariu – jo, ja ku janë gjurmët e tij !". Fundamentalistët e sëmurë serbë, maqedonasë e grekë termin "fundamentalist" ose, thënë më drejtë, sintagmën inekzistente "fundametalizëm islamik" e gatuan nëpër kuzhinat e tyre dhe me pa të drejtë ia mëveshën popujve muslimanë në shtetet e ex-jugosllavisë, e sidomos

popullit shqiptar, me të vetmin pretekst për të arsyetuar aktet e tyre gjenocidale në arenën ndërkombëtare.

E premte, 6 maj

Edhe këtë ditë, si rëndomë ditëve të premte, vajta për të falur namazin e xhumasë në xhaminë e fshatit Lubosh-Batincë të komunës së Shkupit, xhami kjo e sapondërtuar. Ka një muaj e gjysëm që rregullisht vizitoj këtë xhami, ku pjesa dërmuese janë boshnjakë muslimanë të Sanxhakut, ndaj edhe ligjëratat ua mbaj në gjuhën e tyre. Kur gjendem në mesin e tyre prore më kaplon një ndjenjë sa e ëmbël aq edhe përmalluese, meqë evokoj vitet e lumtura studentore që i kalova në Sarajevë – kryeqytetin pitoresk të Bosnjë dhe Hercegovinës sovrane, tashmë të rrënuar. Me mallëngjim evokoj institucionet gjigante të këtij metropoli evropian: bibliotekën universitare në qendër të Bashçarshisë (tashmë të djegur), bibliotekën e madhe të "Gazi Husrev Beut" (gjithashtu të djegur), Fakultetin e Shkencave Islame, dhjetëra xhami e veçmas xhaminë e "Ferhat Pashës" ku ne, studentët shqiptarë ligjëronim në gjuhën amë shqipe, Klubin shqiptar "Bajram Curri" ku ne, teologët e rinj, bashkëvepronim me Unionin e Studentëve Shqiptarë dhe me degën e LDK-së në rrafshin e kauzës kombëtare etj. Por, tani me të drejtë rrënqethem kur parafytyroj tablot tmerruese të apokalipsës boshnjake. Rrojmë me shpresë se së shpejti do të dominojë drejtësia

dhe paqeja – kështu si rëndomë e ngushëllojmë njëri-tjetrin.
Më të falur namazin e xhumasë, konform detyrave që mi shtron posti i referentit të arsimit fetar në kuadër të Këshillit të Bashkësisë Islame të Shkupit, edhe këtë ditë kuvendova me këshilltarët e xhamisë përkitazi me format e legalizimit të kësaj xhamie, meqë për të s'patën marrë paraprakisht leje nga organet kompetente komunale. Ekziston droja që edhe kjo xhami ta pësojë fatin e shumë xhamive të tjera në vendin tonë, të cilat në mënyrë të paskrupullt i rrënuan përdhe.
Po, po, s'ka pse të çuditemi kur objektet tona fetaro-islame shndërrohen në gërmadha, ndërkohë që kishat sllavo-ortodokse mbijnë për çdo ditë si këpurdhat pas shiut, meqë, siç e dini, kjo është punë e shteteve "demokratike" (lexo: policore).

E shtunë, 7 maj
Meqë është ditë pushimi, një mik imi më ftoi të dalim në Çarshinë e vjetër të Shkupit sa për t'u freskuar një çikëz. Ç'të shohësh! Në çdo hap sytë të ndeshen në një numër të madh agjencish turistike shqiptare, të cilat në këto çaste të liga e vendimtare për kauzën tonë, po e shpiejnë popullin tonë drejt një varri kolektiv, veçanërisht pjesën më vitale të saj – rininë. Në mënyrë fare të pahetueshme e "elegante" po vehen në përkrahje të shpërnguljeve masive të popullit tonë, duke i realizuar me këtë rast planet kolonialiste të "-viqëve". I kredhur në këto mendime të

hidhura, aty për aty se ç'mu kujtua tragjedia e vërtetë e një familjeje shqiptare që pat marrë rrugën e gjatë e të stërmundimshme të emigrimit për në tokat e Anadollit, peripeci këto që me aq pedanteri na i përshkruan shkrimtari ynë, Nazmi Rrahmani, në romanin e tij "Rruga e shtëpisë sime".
Me gjasë e kemi harruar edhe mesazhin profetik të të Dërguarit të Zotit, Muhammedit (paqa e Zotit qoftë mbi të): "Dashuria ndaj vatanit është element bazë i besimit" – thash më vete. Si do qoftë, tashmë s'ka nevojë dikush tjetër të bëjë marrëveshje "alla xhentëlmençe" në dëm tonin, meqë ne sot, si më të "vetëdijësuar" që jemi, vetë po i kryejmë punët!

E diel, 8 maj
Edhe këtë herë, si çdo të diele, shpejtova fluturimthi në drejtim të kioskut më të afërt, në lagjen e Dizhonit, për të blerë "Flakën" – të vetmen gazetë shqipe që e kemi në Maqedoni. Me këtë rast shfrytëzoj rastin të uroj daljen e përditshme të saj prej 19 majit. Por ama më brengos tejmase fakti që përgjithësisht nuk e kemi në masë të mjaftueshme, për të mos thënë fare, të kultivuar kulturën apo traditën e leximit ndër ne. E njëjta gjë, mjerisht, ndodh edhe me të vetmen gazetë fetare shqipe "Hëna e re", që botohet në kuadër të Meshihatit të BI. Është tragjedi sa kombëtare po aq edhe fetare kur të vëresh grumbullin e gazetave të pashitura nëpër kiosqet e qytetit, a të mos flasim për xhamitë tona ku diku thellë

qosheve të tyre varroset "Hëna e re" (numra të tërë), sa edhe myku e nxë.
Me gjasë, pjesëtarët e besimit islamik kanë harruar faktin që Feja islame më parë ua ka bërë farz (obligim të domosdoshëm), të lexojnë, mësojnë e studjojnë, e tek më pas i ka ngarkuar me obligimet tjera fetare. S'do harruar faktin e pakontestueshëm historik që flet se populli japonez e pat humbur betejën me amerikanët, por s'e humbi luftën. Ai sot, falë pikërisht traditës kontinuitive në të kultivuarit e leximit-shkencës, arriti të zë vendin meritor në mesin e shteteve më të zhvilluara në botë.

E hënë, 9 maj
Çuditërisht, kudo që të shkosh do të ndeshesh me njerëz bindjesh të çuditshme dhe në esencë kontraproduktive. Më konkretisht ndeshesh me botëkuptimin më paradoksal të llojit "feja apo kombi përpara" (!?), të cilën aq shpesh e dëgjojmë kuloareve. Kështu më ndodhi sot me një bisedë rasti tek një mik imi, ku qenë tubuar shumë veta. Me orë të tëra u harxhuan kotas së diskutuari secili prej tyre rreth çështjes në fjalë. Për më tepër diskutime të këtilla mund të hasim pothuajse në çdo mjedis shqiptar, edhe atë zakonisht të inicuara nga individë alamet patriotë, të cilët në thelb shesin folklor-patriotizëm, bajraktarllëk dhe nga ca të tjerë të "tejdevotshëm" në fe, të cilët në emër të fesë shesin dokrra. U thash se nuk ka nevojë t'u rrekemi gjërave që do të na shpienin në qorrsokak dhe, njëherësh, i këshillova që të mbështeten

në historinë tonë të lavdishme duke filluar qysh nga periudha e Rilindjes Kombëtare e gjer më sot, brenda së cilës kemi pasur fytyra markante fetare prej hoxhëve të cilët edhe u martirizuan në luftë për pavarësinë e Shqipërisë etnike, si, Imer efendi Prizreni, Haxhi Zeka, hoxhë Hasan Tahsini, Seid Najdeni, hafëz Ibrahim Dalliu, mulla Vehbi Dibra, mulla Idriz Gjilani, Vejsel Gjelaludin Guta si dhe shumë e shumë të tjerë, të cilët, atëbotë, tok me intelektualët, priftërit, shehlerët dhe luftëtarët e tjerë atdhedashës shqiptarë nuk kishin kohë të merren me gjëra periferike e banale, e lëre më me çështjen në fjalë që është kontraproduktive dhe jashtëzakonisht e dëmshme për kombin dhe fenë tonë.
Ekstremistëve fetarë dhe atyre kombëtarë le t'u bëhet e qartë një herë e mirë se sot, në këto orë të liga të Ballkanit, dështimi në planin kombëtar nënkupton ndërkohë edhe dështimin në planin fetar dhe anasjelltas.

E martë, 10 maj
Herët në mëngjes, në Bashkësinë Islame, dorëzova një punim mbi filozofinë islame në redaksinë e gazetës "Hëna e re", ku kryesisht bëhet fjalë për kokat kolosale të kësaj filozofie Ibën Sinain (Avicenën) dhe Ibën Ruzhdin (Avareosin), të cilët dhanë kontribut të madh në rrafshin e zhvillimit të mendimit shkencor filozofik në Evropë, madje nëpërmjet tyre Evropa u njohtua me shkencëtarët dhe filozofët e mëdhenj të Greqisë antike, si p.sh. Aristotelin, Platonin, Pitagorën, Hipokratin, Galenën etj.

Por ç'e bën kur neve sot na ka ngelur vetëm të mburremi me këto personalitete të së kaluarës. Le të rrojmë me shpresë se muslimanët – që dikur e ushqenin Evropën me kulturë, shkencë e dije, do të këndellen së shpejti nga letargjia shumëshekullore.

Aty kah dreka, në të dalë nga Bashkësia Islame vërej koreferentin tim tek shkruan diç. Në pyetjen time u përgjigj se po përgatit ftesat për mbajtjen e një mbledhje parapërgatitore përkitazi me festën madhore të "Bajramit të Kurbanit". Aty për aty mu kujtua se është dashur ta bëj edhe një punim përkitazi me këtë festë islamike. Këtë domosdo duhet ta shkruaj për numrin e ardhshëm të gazetës me titull "Festa e Bajramit të Kurbanit – sinonim i paqes", meqë pikërisht nga kjo festë del apeli aq aktual për paqë dedikuar të gjitha organizmave ndërkombëtarë, e veçanërisht kriminelëve serbo-çetnikë:

"ZOTI URDHËROI KAFSHA TË FLIJOHET
E JO NJERIU TË MBYTET!"

Botuar në "Flaka e vëllazërimit",
e premte 13 maj 1994, SHKUP

MONOLOG

Një ditë prej ditësh dola para pasqyrës dhe iu drejtova vetes: Zekë! Ishe njëri nga akterët dhe subjektët në ditët dhe çastet më të vështira nëpër të cilat kalonte kombi yt, toka yte dhe kauza madhore e kombit tënd, në fund të mileniumit të dytë dhe në prag të mileniumit të tretë.
Po, po, pikërisht kur në tokën tënde mëmë, kriste e gjëmonte gjithandej pushka e baruti nga burrat e gratë më të fisme të kombit tënd, të racës iliro-pellazgjike, arbërore e shqiptare, ti brofje i shashtisur në këmbë skutave të dhomës tënde. Shpirti yt i sfilitur përjetonte rënkim, gjëmë e erupcion. Zemra yte, ndërkaq, përpëlitej sikur përjetonte çastet e agonisë. Dhe, këto ditë përjetimesh ogurzeza ti i përjetoje aty diku në një "kolibe" të Berlinit grandioz. Pikërisht këtu, si i huaj (auslander) në mes kombit gjerman, kryepari i të cilit Otto Von Bismark, me "amenin" edhe të ca princërve e mbretërve të tjerë të racave konglomerat të kontinentit të vjetër Evropë, pjesë përbërëse e të cilit është dhe raca yte e stërlashtë dhe e bekuar njëkohësisht, këtu e mbi një shekull më parë pat vënë padrejtësisht kufinj ndarës në gjeografinë e tokës tënde. Ndarje kjo nga e cila më pastaj, o Zot, pollën shumë provinca, duke e kthyer kështu rrjedhimisht etnosin tënd kreshnik atje diku filleve të epokës ilirike, e besa edhe parailirike. Epoka këto në të

cilat kombi yt nuk kishte veçse vetëdijen e familjes (herë patriarkale e herë matriarkale), të fisit e të provincës, nuk kishte, madje, veçse vetëdijen e të rrojturit gjallë. Për më tepër, ai mjet i hekurt e ogurzi, tashmë i përdorur edhe më parë, që nga antikiteti e tëhu, si nga barbarë romakë e bizantinë, ashtu edhe nga barbarë sllavo-shkinorë e baballarë të dovletit e mymleqetit sulltanor, për më keq, tokën tënde të bekuar, që nuk ishte "e premtuar" porse e dhuruar nga Hyu (Zoti), këtu e shumë shekuj më parë e katandisi në atë vorbullin e vilajeteve, pashallëqeve, sanxhaqeve e minisanxhaqeve. Këtu e dymbëdhjetë shekuj më parë, veçan brenda shekullit që lamë pas, si dikur Roma e Bizanti, këtë tokë tënden Zekë, që ta fali Zoti (i qofshim falë!), e shkeli barbarisht raca ardhacake përtejkarpatiane, respektivisht raca sllavo-ortodokse, e cila shumë më keq e më rëndë se sa racat tjera, kudo që na ishte e është akoma, varrosi e po varros pjesëtarët e kombit tënd, bëri dhe akoma po bën pluhur e hi tokën tënde pjellore.

Ula kokën dhe ofshana aq thellë sa desh më doli shpirti. Klitha: Sa e sa hektarë të tokës sonë, o Zot, na i gllabëroi ky armik shkja?

O Zekë! Kjo farë e mallkuar, madje, edhe faltoret, respektivisht tempujt e shenjtë fetarë të të parëve tu jo vetëm që i rrënoi dhe përdhosi si mos më keq, por edhe i uzurpoi padrejtësisht.

Histeria, mendësia e tyre qyqare prej antikrishti e satanai, shpirti i tyre patologjik fetar kishat shqiptare të të parëve

tu, si shtëpi të Perëndisë, i shndërroi në vatra të obskurantizmit mesjetar sllavo-ortodoks, në kisha svetisaviane. Paraardhësit e tu, për habi, si kosmopolitë që ishin, ndër shekuj shpërfaqën një përkujdesje dhe një respekt të thellë në ruajtjen dhe mbrojtjen e këtyre kishave. Jo sepse ato tashmë ishin nën patronazhin e ortodoksëve sllavë, por sepse ato kishin në të vërtetë gjenezë iliro-dardano-shqiptare.

Vallë po të të përrallis? Apo mos vallë po të të dëftoj andrralla të zbukuruara!?

Jo, jo! Kështu, sikundër të tregova, në të vërtetë patën vepruar ndër shekuj ca familje fisnikësh të kombit tënd, të ashtuquajturit "vojvodë shqiptarë", me kishat tona në Deviq, në Pejë dhe në Deqan, të cilat qysh herët na i pat uzurpuar armiku.

Barbaria e tyre madje nuk përfundoi me kaq. Ata bënë edhe hapin tjetër fatal: gjithandej trojeve të Ilirisë ata mbollën kishat e tyre politike për të justifikuar mendësinë e tyre fantazmagorike, respektivisht mitin e tyre për Kosovën iliro-dardane si "djep të serbizmit", si "tokë të shenjtë serbe", si "Jerusalem serb" etj.

Me të ngritur më pas të kokës, ndeshem sy më sy me vetveten. Tashmë fytyra m'është ca më e mrrolur e më e zymtë. I mëzitur thellë vazhdova.

Zekë! Rrjedhimisht, nga katrahura e përgjithshme që pllakosi kombin tënd, t'u bë pikë e pesë gjenealogjia yte fisnore. Po, po. Pikërisht në oborrin e fisit tënd, qe vërë

dhunshëm (aaah!) kufiri ndarës, i cili, jo pakë, i ngjasonte tamam murit kinez, apo mbase edhe atij berlinas.
Këtë kufi, ke parasysh, fisit e kombit tënd ia sugjeroi me një tradhëti tinëzare, e din më, cari rus me bekimin e asaj kurvës plakë. Sugjerim ky të cilin e vënë në jetë këlyshët e tyre: knjazët, carat, naçallnikët, hordhitë çetnike, popat antikrishtë e satanë, akademikët, në kolaborim të thellë e konspirativ këta me farën e fëlliqur të kombit tënd: me ca shqipfolës të mendermethënshëm, të cilët - sikundër me të drejtë do t'i kualifikojë kolosi ynë Mulla Idriz Gjilani - ishin në fakt "zemërshkjesh, të veshur shqiptarçe". Phu! Zoti i vraftë këta spiunë e tradhëtarë të qelbosur!
Për rrjedhojë, fisi yt u shkapërderdh aty diku përskaj kufirit, në të dy anët e tij. Gjaku i nënës dhe gjyshes sate ngeli në viset e andejkufirit, në katundet rrëzë kodrës së Kopilaçës: në Debollde e në Mjak të Vitisë, të përfshira këto asokohe në Kosovën autonomiste nën serbo(jugo)sllavi. Ndërkaq gjaku i babait e gjyshes sate ngeli andej-këndej kufirit: në Kodërtrim (ish-Gjurgjedell) të Kaçanikut dhe (gjaku i ime gjyshe, apo i nënës së tim atë) në Tanushë të Shkupit ilirik nën Maqedoni. Këtë fat të ligë, mjerisht, do ta pësojnë edhe miliona pjesëtarë familjesh e fisesh të kombit tonë, që shtrihen gjithandej Shqipërisë së përgjakur, të sakatosur e të pëgjysmuar nga brenda dhe nga jashtë, si dhe nga të katër anët me kufinj të hekurt.
Më kupton? Kuptove se de jure ku na është vënë kufiri?

O burrë, të plaçshin sdytë, po kufiri, vaj medet për ne, na është vërë mu në mes të oborrit, gjakut, familjes e të fisit tonë!
Madje, për më keq, edhe shkollën e Tanushës legjendare, për gjynaf, kufiri e ndau më dysh. Sikundër dijmë, me marrëveshjen më të fundit, pikërisht aty para fillimit të luftës në Maqedoni, që qe arritur në Shkup në mes zyrtarëve të lartë serbë e maqedonasë, kufiri u shty ca më në brendi të territorit të Kosovës, duke gllabëruar kështu mijëra hektarë tokë të plleshme shqiptare. Protestat e njëpasnjëshme të banorëve të katundit Debollde, në të cilat kërkohej zëshëm revidimi i kësaj marrëveshjeje të padrejtë, me çka do t'u riktheheshin pronat, hasnin në veshë të shurdhër të zyrtarëve të UNMIK-ut. Protestat nuk rreshtin së organizuari edhe sot e kësaj dite. Por ama s'do harruar faktin se kjo marrëveshje, që lëvizi kufirin në dëm të kauzës e gjeografisë sonë edhe ashtu të dëmtuar prej shekujsh, qe shkak plus, për të mos thënë vendimtar, në vargun e shkaqeve të shumënumërta që nxiti eruptivisht revoltën luftarake shqiptare. Pas pak çastesh, aty rrëzë kodrës së Kopilaçës, në Tanushën tonë historike krisi pushkën e parë me bismil-lah brigada e Ushtrisë Çlirimtare Kombëtare nën komandën e trimave zemërluaj, Xhezair Shaqirit (komandant Hoxha), hoxhë Ridvan Nezirit (ndjesë pastë - Allahu e mëshiroftë!) dhe shumë luftëtarëve të tjerë.
Zekë! Yt atë, Zeneli, kur ti s'kishe lindur akoma, duke mos mundur të durojë zullumin dhe trysnitë e numërta

që i ushtronte mbi shqiptarët regjimi i egër rankoviqist-titist viteve të pesëdhjeta në Kosovë, mblodhi kalamajt dhe plaçkat dhe u zhvendos nga Kaçaniku në Shkup. E, me të e pas tij rendën edhe qindra mijëra familje të tjera, që u vendosën gjithandej viseve të Shqipërisë Lindore (ah!) nën Maqedoni.
Mu duk sikur e mërzita dhe më shumë.
Nejse de, mos u mërzit he burrë! - u përpoqa ta ngushëlloj.
Sepse, ti e din më, se këto dyndje de fakto na ndodhën jo gjetkë, në ndonjë vend të huaj, por mu brendapërbrenda tokës sonë mëmë. Mandej, sidoqoftë, ne na mbanë shpresa që, në mos mundshim sot, bile në një të ardhme të afërt me izën e Zotit do t'i bashkojmë trojet tona e do t'i vendosim kufinjt ashtu siç na i pat vendosur që në fillim të ekzistencës Krijuesi ynë, i qofshim falë!
Në rregull, unë e kuptoj se, vërtet, të vie të pëlcasësh nga mërzia e përmallimi kur ke parasysh atë fatin e hidhur të familjes së gjakut tënd, familjes së xhaxhait tënd Metushit, e cila ia mbathi për t'mos kthyer kurrë për në shkrepat e Anadollit. E, për në këtë tokë "të ftohtë" ia mbathën edhe miliona shqiptarë të tjerë. Si mundem, vallë, të heq nga mendja edhe miliona e miliona pjesëtarë të tjerë të kombit tonë që po dergjen tokave të huaja: në Turqi, në Azi, në Afrikë, në Itali, Sicili e Kalabri, në Ukrainë e në Amerikë ...ahhh! Ah, kurbeti - kjo plagë jona shekullore - seç nuk na u hoq dot qafesh, mor burrë!

Besa boll mirë! Po ti? Ti ku na ishe e ku ngele kësoperiudhe?
Ti mor i mjerë, tok me pjesën tjetër të fisit tënd, ngele në Shkupin e "Skopjes" sllavomaqedone. Ti, në fakt, në këtë vend linde dhe u rrite.
Ah, mor Zekë! Qafirët shkje ta shëmtuan si mos më keq me këtë emër Shkupin - këtë kryeqendër të Dardanisë antike dhe të Vilajetit të Kosovës, këtë "mekë" të Shqipë(ta)risë etnike!
.....
Megjithatë, Zekë mbaje veten dhe mos humb kurrnjëherë shpresën, duke e shoqëruar ate edhe me punë të palodhshme gjer në vdekje, se një ditë, kysmet, do jemi banorë e shtetas të Shqipërisë ETNIKE-NATYRALE. Dhëntë Zoti sa më shpejtë të jetësohet kjo dëshirë dhe ky synim i shenjtë yni! Amin!

Përmbajtja e librit

1. Veprimtaria universale e imamit në kurbet
-Myslimanë, sufinj e katolikë shqiptarë të bashkuar në veprimtari kombëtare
-Intelektualët e hijeshojnë xhaminë
-I tërë rruzulli tokësor është xhami, i nderuari profesor i filozofisë
2.Evokim mbresash studentore
-Edhe midis Sarajevës, në xhaminë e Ferhat Pashës, jehoi gjuha e ëmbël shqipe
3.Evokim përsiatjesh nga e kaluara në të ardhmen
-Letër e hapur shqiptarëve muslimanë të Shkupit
4.Letër e hapur kryetarit të Bashkësisë Islame në Maqedoni Haxhi Sulejman ef. Rexhepi
5.Ditari javor
6.Festa e flijimit sublim - Bajrami i Kurbanit
-Festa e Bajramit të Kurbanit - sinonim i paqes
7."Ehlen ve sehlen" në xhaminë tonë vëllezër "xhema'atu tebligë"!
8.Xhamia dhe literatura islame në fokus
-Kemi apo nuk kemi përgjegjësi në punën tonë?
9.Letër motrës sime Besarta Hodaj - e sëmurë nga leukemia
10.Letër e hapur Ali Ahmetit
11.MONOLOG ME PRESIDENTIN E NDJERË DR. IBRAHIM RUGOVA
PRANË VARRIT TË PRESIDENTIT RUGOVA
12.MONOLOG

13.Pjesë të papublikuara në librin tim "Xhamia në analet e historisë - Hoxhallarët dhe institucionet islame në shërbim të çështjes kombëtare"
14.Xhamitë në shënjestër të islamofobëve shqiptarë
15.Anëtarësia e xhamive në fokus
-Meditimet e mija rreth anëtarësisë në xhami
16.Xhamia dhe politika në fokus
-Imami gjithëpopullor dhe xhamia mbipartiake
17.Femra muslimane dhe xhamia
-Pesëmarrja e gruas në xhami në kohën e Pejgamberit a.s.
-Gruaja si mësuese dhe thirrëse në rrugën e All-llahut xh.sh.
-Përse gruaja sot nuk shkon në xhami?
18.Lutje për dëshmorët e kombit

Shënime për autorin

Zekerija Idrizi lindi në vitin 1969 në lagjen e Dizhonit në Shkup. Shkollën fillore dhe të mesmen "Medreseja Isa Beu" i kreu me sukses të shkëlqyeshëm në Shkup. Studimet i ndoqi në Fakultetin e Shkencave Islame në Sarajevë. Afro tre vite punoi si imam në Zvicër tek qendrat kulturore islamike në: Zürich, Seebach, Liestal (Basel), Sant Gallen dhe Luzern. Madje përkohësisht punoi në Gjermani në qendrat islamike: Bielefeld, Achen (Stolberg) dhe Hamburg. Më 1992 plot një vjetë punoi si imam në xhaminë e fshatin Sheshovë (Shkup). Fill më pas, katër vite rresht (1993-1997) kreu detyrën e referentit të arsimit fetar në Muftininë e Bashkësisë Islame të Shkupit. Kësokohe u mor me një varg aktivitetesh të karakterit fetar dhe kombëtar. Veçan me sukses organizoi tribuna të shumta, si në nivel të Muftinisë së Shkupit, ashtu edhe në nivel të Bashkësisë Islame në Maqedoni, nëpërmes të cilave dha një kontribut të çmueshëm në avansimin e vetëdijes fetare dhe kombëtare midis shqiptarëve të kësaj ane. Në këtë kontekst dhe organizimi i tribunës tok me profesor Shaqir ef. Fetahun në lokalet e Teatrit Kombëtar Shqiptar, në temën "Aktualiteti i Islamit në kohën bashkëkohore", nën patronazhin e Bashkësisë Islame, kulmoi në libër të botuar "Mozaiku fetar dhe çështja kombëtare", botuar më 1998 në Shkup.
Shqiptarët e Maqedonisë, veçanërisht shtresa rinore dhe ajo intelektuale, nuk mund të harrojë dot paraqitjet e tij

dinjitoze në masmediat e këtushme elektronike, si në ato private (radio Toska, TV Era, radio Vati), ashtu edhe në ato shtetërore, ku në mënyrë të shkëlqyeshme diti të interpretojë mësimet kur'ano-sunnetike të fesë sonë të ndritur. Do përmendur këtu dhe pjesëmarrjen e tij dinjitoze në shumë debate inter-religjioze me kreun e Kishës Ortodokse Maqedonase në TV dhe tribuna e seminare të ndryshme. Tërë këto aktivitete i bëri me autorizim të kreut të BI (me në krye Reisu-l-Ulemën, Haxhi Sulejman ef. Rexhepi).

Madje në harkun kohor 1997-2005 punoi imam në xhaminë "Isa Beu" të mërgimtarëve shqiptarë në Berlin.

Botoi dhjetëra shkrime në gazetën informative kulturore islame "Hëna e re" - organ ky i BI në Maqedoni. Herë pas here, botoi edhe në gazetat tjera shqipe, si në "Flaka" (Shkup), "Fakti" (botimi në diasporë dhe Shkup), "Koha ditore" (Prishtinë) dhe "Bota sot" (Cyrih). Gjithashtu botoi edhe në revistat: "Familja" (Tiranë) dhe "Dituria Islame" - organ ky i Bashkësisë Islame të Kosovës. Deri më tani ka përkthyer nga boshnjakishtja veprën kapitale "E drejta islame" (Islamsko pravo) të autorit dr. Jusuf Kardavi (botoi BI, Shkup, 1995) dhe si bashkëpërkthyes nga arabishtja veprën "Të vërtetat esenciale të Islamit" (El-Hakaiku-l-Esasijjetu lil-islam) të autorit Abdullah Sead (botoi BI, Shkup, 1994)

Në vitin 2009 botoi veprën kapitale "Xhamia në analet e historisë - Hoxhallarët dhe institucionet islame në shërbim të çështjes kombëtare (botoi "Fondacioni i Rinisë

Islame", Seebach - Cyrih). Më pas botoi veprën tjetër "Fundamentalizmi islamik si fiksion dhe myslimanët antifundamentalistë".
Aktualisht jeton dhe vepron në Berlin.